

MARRËDHËNIA E MEDIAS ME INSTITUCIONET E DREJTËSISË

Manual mbi praktikat dhe standardet
më të mira ndërkombëtare dhe udhëzues
mbi raportimin nga salla e gjyqit



Marrëdhënia e Medias me Institucionet e Drejtësisë

Manual mbi praktikat dhe standardet
më të mira ndërkombëtare dhe udhëzues
mbi raportimin nga salla e gjyqit

Roden HOXHA

Lutfi DERVISHI

Tiranë, 2019

Botues:



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

Tel./fax: ++ 355 4 2229800

E-mail: info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Nisma për Udhëzuesin mbi marrëdhëniet e medias me drejtësinë dhe raportimin nga salla e gjyqit qëndron në thelb të objektivave të Institutit Shqiptar të Medias për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të medias në Shqipëri. Ky Udhëzues u hartua në kuadrin e projektit “Fuqizimi i rolit të medias së pavarur në procesin e reformës në drejtësi në Shqipëri,” i mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqiptarë për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmes këtij dokumenti Instituti mbështet gazetarët të cilët dëshirojnë të kenë njohuri të përditësuara mbi reformën në drejtësi, kuadrin ligjor të përditësuar nga kjo e fundit, rrjetin e institucioneve të prekura dhe të krijuara rishtazi si rezultat i kësaj iniciative, dhe marrëdhëniet profesionale mes tyre dhe këtyre të fundit.

Bashkëpunimi mes gazetarëve dhe institucioneve të drejtësisë është një terren shumë i mirë ku ndërveprimi do të rriste aksesin e lexuesit/shikuesit në fushën e drejtësisë dhe do të përmirësonte klimën demokratike në vend. Në këtë frymë, ky udhëzues ka për qëllim të ofrojë informacion për gazetarët, redaktorët, botuesit, studentët e medias, si dhe për çdo person tjetër të interesuar. I hartuar në formën e një përmbledhjeje mbi objektivat dhe arritjet e reformës në drejtësi, ndjekur nga praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare mbi parimet themelore mbi bashkëveprimin dhe raportimin në sistemin e drejtësisë, manuali ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të lexuesit përmes shqyrtimit të rasteve konkrete të gjykuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kushtet dhe standardet e detyrueshme të vendosura nga kjo e fundit, dhe një prag minimal mbi të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve në vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

Për sa i përket aksesit të medias në gjyqësor dhe institucionet e tjera të drejtësisë, nuk ekziston një model universal që të jetë i gatshëm për t’u përdorur kudo. Për këtë arsye, ky botim nuk përqendrohet

në institucione të veçanta dhe ndërveprimin e ngushtë të tyre me publikun, por trajton një gamë të gjerë çështjesh praktike. Si funksionojnë mekanizmat e marrëdhënies së gjyqësorit me median në vendet e BE dhe më tej? Ky dokument ndalet dhe shqyrton praktikën e marrëdhënies së Gjykatave Federale të SHBA-së dhe Gjykatave Penale të Mbretërisë së Bashkuar me median. Cili është vendi i gazetarisë investigative në gazetarinë e raportimit gjyqësor? Manuali vështron raste konkrete në të cilat të drejtat e gazetarëve hulumtues janë shkelur nga institucionet e gazetarisë dhe standardet e vendosura për mbrojtjen e marrëdhënieve specifike në vendet e Bashkimit Evropian.

Në mbyllje të këtij udhëzuesi vihet në dispozicion një informacion i detajuar mbi format dhe procedurat e bashkëveprimit dhe aksesit të medias me institucionet e reja të drejtësisë, si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe një Manual Praktik mbi raportimin nga salla e gjyqit, i cili përfshin një shpjegim të zgjeruar mbi fjalorin juridik të përdorur nga këto institucione, procedurat specifike për çështje të veçanta dhe të gjitha rregullat dhe udhëzimet për një raportim me standard të lartë profesional dhe etik.

TABELA E PËRMBAJTJES

I. REFORMA NË DREJTËSI DHE INSTITUCIONET E REJA TË DREJTËSISË	9
Hyrje	9
a) Strategjia e Reformës në Drejtësi	10
b) Qëllimi i Ndryshimeve Kushtetuese	12
c) Ndryshimet në Pushtetin Gjyqësor	14
d) Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në kuadër të reformës	14
i. Gjykata Kushtetuese	15
ii. Këshilli i Lartë Gjyqësor	16
iii. Këshilli i Lartë i Prokurorisë	17
iv. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi	18
e) Institucionet e Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë	18
i. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	19
ii. Kolegji i Posaçëm i Apelit	19
iii. Institucioni i Komisionerëve Publikë	20
iv. Strukturat e posaçme antikorruption (SPAK)	21
v. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit	23
II. MEDIA, DREJTËSIA DHE ROLI I TYRE NË DEMOKRACI ...	25
Hyrje	25
a) Marrëdhënia e institucioneve të drejtësisë me median dhe problemet e hasura në praktikë	26
b) Sistemi i drejtësisë dhe zhvillimi i marrëdhënies me publikun	29
c) Institucionet e drejtësisë dhe komunikimi me publikun	30
i. Prokuroria e Përgjithshme	30
ii. Gjykatat e Faktit	32

iii. Gjykata e Lartë	33
iv. Gjykata Kushtetuese	35

III. PARIMET DHE STANDARDET EVROPIANE PËR BASHKËVEPRIMIN DHE RAPORTIMIN NË SISTEMIN E DREJTËSISË 38

Hyrje

- a) Parimet e përgjithshme të ndërveprimit të gjyqësorit me median 40
 - i. Dëgjesa publike para gjykatave kombëtare 42
 - ii. Shpallja publike e aktgjykimeve dhe disponueshmëria e vendimeve gjyqësore 43
 - iii. E drejta e qasjes në informacion publik 44
 - iv. Konventa Evropiane për Qasjen në Dokumente Zyrtare 46
 - v. Miratimi i dy teksteve mbi Median dhe Procedurat Penale 47
- b) Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut 48
 - i. Liria e shtypit 48
 - ii. Publiciteti paragjykses-Ndikimi i mediave në vendimet gjyqësore: prezumimi i pafajësisë dhe influencimi i gjyqësorit 51
 - iii. Prezumimi i pafajësisë 53
 - iv. Mbrojtja e privatësisë 53
- c) Influencimi i gjyqësorit nga media 55
- d) Liria e shprehjes dhe autoriteti e paanshmëria e gjyqësorit 57

IV. GAZETARIA HULUMTUESE DHE MARRËDHËNIA ME DREJTËSINË: MBROJTJA NDAJ NDËRHYJES NË PROFESION NË PRAKTIKËN E BASHKIMIT EVROPIAN ... 60

- a) Mbrojtja e burimeve të lajmit 62
- b) E drejta e gazetarëve për të marrë dhe publikuar dokumente konfidenciale 64
- c) Mbrojtja kundër kërkimit të vendeve të punës dhe vendbanimeve private të gazetarëve dhe kundër sekuestrimit të materialeve 66

V. PRAKTIKAT MË TË MIRA - UDHËZIMET E SHTYPIT PËR GJYQËSORIN	68
Hyrje	68
a) Mediat dhe Gjyqësori në SHBA – Qasja e mediave në Gjykatat Federale	71
b) Mediat dhe Gjyqësori në Mbretërinë e Bashkuar - Udhëzime juridiksionale për të mbështetur aksesin e mediave në gjykata - Gjykatat Penale	77
VI. QASJA NË MEDIA E GJYQËSORIT SHQIPTAR - E DREJTA PËR INFORMIM NË MËNYRË TË SHKURTËR	82
a) Kuadri normativ në Republikën e Shqipërisë për të drejtën e informimit	82
b) Institucionet e krijuara nga reforma në drejtësi dhe marrëdhënia e tyre më median	83
i. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	84
ii. Institucioni i Komisionerit Publik	86
iii. Kolegji i Posaçëm i Apelimit	87
iv. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit	88
VII. MANUAL MBI RAPORTIMIN NGA GJYKATA - UDHËZUES PRAKTIK	89
Hyrje	89
a) Parimet e përgjithshme të raportimit gjyqësor	91
i. Sistemi i drejtësisë	91
ii. Një gjykim i drejtë	92
iii. Sub judice	93
iv. Çfarë mund të raportojmë	94
v. Pse të raportojmë rastet gjyqësore	95
vi. Shpifja dhe informacioni i privilegjuar	96
vii. Raportimi i menjëhershëm i një çështjeje gjyqësore	98
b) Udhëzues praktik për raportimin nga gjykata	99

ANEKS I - Instrumente të mëtejshëm për mbrojtjen e të drejtave të medias ... I I I

REFORMA NË DREJTËSI DHE INSTITUCIONET E REJA TË DREJTËSISË

Hyrje

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar në vitin 1998 dhe është ndryshuar 3 herë deri më sot.¹ Në përgjithësi, gjatë dy dekadave të zbatimit të saj, Kushtetuta ka arritur të sigurojë funksionimin e një shteti demokratik në Shqipëri, ndonëse nuk kanë munguar edhe dështimet. Kështu p.sh. Kushtetuta e 98-ës nuk ka arritur të izolojë sa dhe si duhet institucionet e pavarura nga ndikimi i shumicave politike. Po kështu Kushtetuta nuk ka arritur të sigurojë një mbikëqyrje të vërtetë dhe të efektshme të parlamentit mbi qeverinë. Megjithatë, është e qartë për të gjithë aktorët dhe vëzhguesit e jetës politike dhe institucionale në Shqipëri se dështimi më i spikatur i Kushtetutës së vitit 1998 ka qenë paaftësia e saj për të krijuar një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas.

Përpjekjet e herëpashershme të qeverive të ndryshme, për t'i adresuar këto probleme kanë dështuar në vazhdimësi për sa kohë ndërhyrjet e propozuara ligjore kanë qenë të pjesshme dhe në asnjë rast nuk kanë prekur rregullimet përkatëse kushtetuese. Në kushtet kur këto ndryshime, në shumë raste, kanë përkeqësuar gjendjen juridike dhe politike në vend, në vitin 2014 u pa e arsyeshme të krijohet një komision bipartizan parlamentar që do të rishikonte të gjitha problemet e theksuara të vërejtura në zbatimin e normave kushtetuese ndër vite, por edhe mangësitë e vërejtura nga institucionet ndërkombëtare si Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.²

¹ Ndryshimi i parë i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u bë në vitin 2007 për të zgjatur afatin e qëndrimit në detyrë të autoriteteve të pushtetit vendor. Ndryshimi i dytë, dhe më i rëndësishëm, u bë në vitin 2008 për të ndryshuar mënyrën e zgjedhjes së Presidentit të Republikës, procedurën për votëbesimin e qeverisë dhe afatin e qëndrimit në detyrë të Prokurorit të Përgjithshëm. Ndryshimi i tretë u bë në vitin 2012 për të zbutur imunitetin e funksionarëve të lartë të shtetit nga ndjekja penale.

² Çështja Marini kundër Shqipërisë, nr. 3738/02, 18 Dhjetor 2007 [ECtHR]

Ky komision ka përcaktuar gjithashtu objektivat e reformës në drejtësi duke propozuar ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore për arritjen e këtyre objektivave. Më konkretisht objekti i veprimtarisë së komisionit ka përfshirë:

- Analizimin e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, me qëllim evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe diskutim gjithëpërfshirës me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, subjektet e tjera të interesuara dhe opinionin publik.
- Hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë.
- Propozimin për miratim të një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me ndihmesën dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionin publik.

a) Strategjia e Reformës në Drejtësi

Bazuar në problemet e identifikuar nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë nga ana e Komisionit për Reformën në Drejtësi,³ është hartuar një dokument strategjik me qëllim përcaktimin e objektivave strategjike të reformës në sistemin e drejtësisë dhe identifikimin e ndërhyrjeve të nevojshme kushtetuese dhe ligjore për realizimin e këtyre objektivave. Ky dokument strategjik është pasuar nga një plan veprimi, i cili detajon ndërhyrjet konkrete kushtetuese, ligjore dhe të llojeve të tjera, subjektet që do angazhohen për zbatimin e tyre, si dhe afatet. Synimi i përgjithshëm i procesit të reformës ka qenë krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit, të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, që të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e

³ URL - <http://shtetiweb.org/2015/06/18/analize-e-sistemit-te-drejtësisë-ne-shqipëri/>

qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane.

Një sistem drejtësie me këto tipare është parakusht i domosdoshëm për forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e lirive dhe të drejtave të individit, barazinë e shtetasve përpara ligjit, përparimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ecurinë e procesit të integritimit evropian. Përkundrajt vetëdijes për rëndësinë jetike të një sistemi drejtësie që i përmbush tiparet e sipërpërmendura, është fakt i njohur dhe i pranuar botërisht, i evidentuar në mënyrë të hollësishme edhe në analizën që parapriu hartimin e këtij dokumenti, se sistemi i drejtësisë në Shqipëri ka dështuar pothuaj në të gjithë parametrat e sipërpërmendur.

Analiza e Sistemit të Drejtësisë vuri në dukje se gjendja e tanishme e këtij sistemi është përcaktuar nga veprimi i kombinuar i shumë faktorëve, si: cilësia e dobët e legjislacionit të miratuar gjatë këtyre 25 vjetëve, ku Shqipëria thjesht ka importuar ligje të huaja pa ia nënshtruar ato një procesi përshtatjeje në dritën e nevojave dhe mundësive reale të vendit; prania e lartë e korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe shkalla e ulët e profesionalizmit të funksionarëve të tij, ku dobësia e sistemit të drejtësisë bëhet edhe më e dukshme në kuadrin e procesit të integritimit evropian të vendit; mungesa të thella në njohjen dhe zbatimin e standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, njohjen e direktivave dhe traktateve të BE-së, legjislacionit të zbatueshëm në kuadër të integritimit evropian, jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe paaftësia për t'u orientuar dhe referuar te këto standarde.

Në vijim të qëllimit të përgjithshëm të reformës, kjo strategji ndjek disa synime specifike për reformimin e sistemit të drejtësisë për ta bërë atë: të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi; të paanshëm në funksionimin e tij; të përgjegjshëm, llogaridhënës, me integritet të lartë moral dhe profesional në të gjitha nivelet strukturore të tij; eficient dhe profesional; të besueshëm, transparent dhe të aksesueshëm prej publikut; bashkëpunues në nivel institucional kur ushtrohet pushteti vendimmarrës për emërimin e funksionarëve të lartë të sistemit.

Reforma në sistemin e drejtësisë është e konceptuar mbi 7 shtylla bazë, që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend. Konkretisht këto shtylla janë:

- I. Sistemi i drejtësisë sipas Kushtetutës dhe Gjykata Kushtetuese
- II. Pushteti gjyqësor
- III. Drejtësia penale
- IV. Edukimi ligjor dhe arsimi juridik
- V. Shërbimet ligjore dhe profesionet e lira
- VI. Masat në luftën kundër korrupsionit
- VII. Financimi dhe mbështetja infrastrukturore e sistemit

Këto 7 shtylla kanë qenë edhe pjesët kryesore përbërëse të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, strategjisë për reformën në tërësi dhe ligjeve të cilat dolën nga kjo reformë.⁴

b) Qëllimi i Ndryshimeve Kushtetuese

Qëllimi i amendimeve kushtetuese është rivendosja e ekuilibrave kushtetues për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë sipas parimeve të shtetit të së drejtës dhe në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit të ndërsjellë të pushteteve. Më konkretisht, reforma kushtetuese dhe e Gjykatës Kushtetuese është fokusuar në realizimin e objektivave të mëposhtëm specifike:

Objektivi 1. Ruajtja e ekuilibrave që rrjedhin nga roli i Presidentit të Republikës në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i bashkëpunimit mes institucioneve kushtetuese.

Objektivi 2. Ridimensionimi nga pikëpamja kushtetuese i institucioneve që lidhen me gjyqësorin, si Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, me synim kryesor garantimin e një gjyqësori të pavarur, të paanshëm, efektiv dhe llogaridhënës.

⁴ 1) Ndryshimet Kushtetuese të miratuara nga Kuvendi më 22 korrik 2016;

2) Ligji nr. 84/2016 “Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

3) Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.”

4) Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.”

5) Ligji nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

6) Ligji nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”

Objektivi 3. Garantimi i pavarësisë dhe i efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në këndvështrimin kushtetues

Më konkretisht, ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 synojnë:

- Mirëpërcaktimin e rregullave për zhvillimin e procesit të emërimit të gjyqtarëve kushtetues, duke përfshirë rregullat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidaturave në respektim të pavarësisë, paanshmërisë dhe parimit të luajalitetit kushtetues.
- Vendosjen e kriterëve të qarta kualifikuese për të garantuar një përbërje cilësore të Gjykatës Kushtetuese.
- Shmangjen e politizimit të procesit të emërimit dhe përbërjes së Gjykatës Kushtetuese përmes dispozitave që garantojnë mbështetje të gjerë të kandidaturave në Kuvend, duke përfshirë dhe kontrollin e ndërsjellë të shumicës dhe pakicës parlamentare mbi procesin e votimit, me qëllim balancimin e pushtetit të shumicës parlamentar.
- Garantimin e funksionimit kolegjal të GJK-së dhe shmangjen e qëndrimit të tejzgjatur në detyrë për të ruajtur parimet kushtetuese të pavarësisë dhe paanshmërisë së GJK-së.
- Respektimin e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit kushtetues.
- Rishikimin e dispozitave kushtetuese për të krijuar modalitete dhe afate të qarta për çështje që kanë të bëjnë me shkarkimin dhe mbarimin e mandatit të gjyqtarëve.
- Përfshirjen edhe të gjyqtarëve kushtetues në sistemin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë përmes rregullimit të qartë material dhe procedural të përgjegjësisë disiplinore të tyre, duke parashikuar që sistemi i përgjegjësisë disiplinore të tyre të jetë nën autoritetin e një tribunali të posaçëm disiplinor ose nën autoritetin e vetë Gjykatës Kushtetuese.
- Identifikimin më të saktë të çështjeve që lidhen me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, duke synuar shmangjen e saj si shkallë e katërt gjykimi, si dhe qartësimin e legjitimitetit të subjekteve të kushtëzuara e të pakushtëzuara që iniciojnë çështje për një gjykim kushtetues.

c) Ndryshimet në Pushtetin Gjyqësor

Reforma në gjyqësor adreson të gjitha problemet e evidentuara përmes ndërhyrjeve të nevojshme kushtetuese dhe legislative të organizuara sipas objektivave të mëposhtëm kryesorë:

Objektivi 1: Rritja e aksesit dhe efektivitetit në sistemin gjyqësor nëpërmjet riorganizimit të gjykatave në përputhje me standardet evropiane.

Objektivi 2: Garantimi i pavarësisë dhe efektivitetit të Gjykatës së Lartë.

Objektivi 3: Mirëqeverisja e gjyqësorit në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, efijencës dhe transparencës së tij.

Objektivi 4: Konsolidimi i garancive të statusit të gjyqtarit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e detyrës në përputhje me standardet evropiane.

Objektivi 5: Garantimi i transparencës së pushtetit gjyqësor dhe i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në përputhje me standardet evropiane.

Objektivi 6: Rritja e efijencës së administratës gjyqësore në përputhje me standardet evropiane.

Objektivi 7: Krijimi i një raporti të ri të sistemit tonë gjyqësor me gjykatat evropiane.

Objektivi 8: Rritja e efektshmërisë së sistemit të drejtësisë nëpërmjet zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të arbitrazhit në përputhje me standardet evropiane.

d) Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në kuadër të reformës

Ndryshimet kushtetuese dhe ato ligjore organizative u votuan me unanimitet të plotë nga 140 deputetë, më 22 korrik 2016. Miratimi i këtyre ndryshimeve u pa nga aktorët vendas dhe ndërkombëtarë, me në krye Bashkimin Evropian dhe Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë si hapi i parë i rëndësishëm për përmirësimin radikal të sistemit të drejtësisë dhe rikthimin e besimit të qytetarëve të pushteti gjyqësor. Këto ndryshime

kanë prekur një pjesë substanciale të Kushtetutës, ku bien në sy ndryshimet në sistemin e drejtësisë, me në krye pushtetin gjyqësor dhe Prokurorinë e shtetit, si një nga shtyllat e funksionimit të demokracisë dhe të shtetit ligjor, si dhe një garanci për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit. Përmes ndryshimeve në pjesën e nëntë të Kushtetutës, reforma ka synuar të adresojë problemet në drejtësi përmes rritjes së aksesit dhe efektivitetit në sistemin gjyqësor, riorganizimit të gjykatave në përputhje me standardet evropiane dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe vizibilitetit të aktorëve të ndryshëm në pushtetin gjyqësor.

i. Gjykata Kushtetuese

Në lidhje me Gjykatën Kushtetuese, ndryshimet kryesore të paketës së reformës, për sa i përket efikasitetit dhe llogaridhënies së këtij institucioni, fokusohen në:

- a) garantimin e pavarësisë dhe efektivitetit të Gjykatës, ku përcakton rregulla të reja për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë pranë kësaj gjykate, me formulën e re e cila parashikon zgjedhjen e 1/3 së anëtarëve nga Presidenti i Republikës, 1/3 nga Kuvendi me shumicë të cilësuar prej 3/5 të votave dhe 1/3 nga trupa e Gjykatës së Lartë; (Secili nga këto organe përzgjedh kandidaturat e veta nga një listë prej 3 kandidatësh të vënë në dispozicion nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi).
- b) përfshirjen e gjyqtarëve kushtetues në sistemin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë përmes rregullimit të qartë material dhe procedural të përgjegjësisë disiplinore të tyre;
- c) specifikimin e çështjeve që lidhen me juridiksionin e saj, për të shmangur kthimin e saj në një gjykatë të shkallës së katërt.
- d) zgjerimin e objektivit të padisë (përfshirja e të drejtave themelore në tërësi) të lejueshëm për subjektet ankuese pranë kësaj Gjykate;
- e) kufizimin e vendimmarrjes së Gjykatës për refuzim të shqyrtimit të çështjeve.

Pjesa e nëntë e Kushtetutës ka pësuar ndryshime të shumta dhe për sa i përket administrimit të pushtetit gjyqësor. Këto ndryshime janë pasqyruar dhe në numrin e madh të ligjeve të reja të cilat rregullojnë veprimtarinë e gjyqësorit dhe prokurorive në Republikën e Shqipërisë (shiko më lart). Bazuar edhe në këto ndryshime kushtetuese dhe ligjore, një numër institucionesh ekzistuese kanë dalë jashtë funksionit, dhe një numër organesh kolegjiale të reja janë formuar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së aksesit në drejtësi, rritjen e

besimit publik në sistemin gjyqësor, përmirësimin e imazhit të gjyqësorit dhe garantimin e një sistemi eficient që nuk kompromenton cilësinë e drejtësisë dhe aksesin në drejtësi.

ii. Këshilli i Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor është një institucion i ri, i cili zëvendëson Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në rolin e tij si mbikëqyrës i funksionimit të gjyqësorit shqiptar. Me reformën dhe prezantimin e këtij organi të ri kolegjal, numri i anëtarëve të tij ulet nga 15 në 11, anëtarë me kohë të plotë, me shumicën e tij të përbërë nga profesionistë të pavarur dhe supremimin e pozicioneve pranë këtij organi të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Ministrisë të Drejtësisë. Përveç numrit të anëtarëve, ligji parashikon edhe ndryshimin e procedurës së zgjedhjes së tyre. Nga 11 anëtarë, 6 do të jenë nga radhët e gjyqtarëve (të zgjedhur nga vetë trupa gjyqësore), ndërsa pesë anëtarët e tjerë duhet të jenë nga radhët e avokatëve, pedagogëve të fakulteteve të drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës, si dhe të shoqërisë civile. Për secilën kategori të anëtarëve ligji ka parashikuar në mënyrë të detajuar kriteret që duhet të përmbushin duke filluar nga organizimi i thirrjes të verifikimit të plotësimin të kushteve ligjore, ankimimeve, kuorumit, thirrjen e mbledhjes, procesin e votimit, numërimin e votave e deri tek ankimimet kundër vendimeve të organit përzgjedhës. Zgjedhjen përfundimtare të anëtarëve jo-gjyqtarë e bën Kuvendi sipas një procedure komplekse të detajuar në Kushtetutë dhe në ligjin 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes të Sistemit të Drejtësisë.

Në bazë të nenit 147/a të Kushtetutës, ky organ ka si funksion:

- a) emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- b) vendosjen për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve;
- c) propozimin Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit;
- d) miratimin e rregullave të etikës gjyqësore dhe mbikëqyrjen e respektimit të tyre;
- e) drejtimin dhe përkujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

- f) propozimin dhe administrimin e buxhetit e tij dhe të gjykatave;
- g) informimin e publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor;
- h) ushtrimin e funksioneve të tjera të përcaktuara me ligj.

Kryesimi i organit do të kryhet gjithmonë nga njëri prej anëtarëve jo-gjyqtarë, për të garantuar mungesën e arbitraritetit në vendimmarrjen e tij. Ky organ gjithashtu zgjeron funksionet e tij në administrimin e sistemit gjyqësor dhe ndihmohet në punën e tij nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD).

iii. Këshilli i Lartë i Prokurorisë

Ndryshimet kushtetuese të 2016 kanë parashikuar dhe krijimin e një organi të ri të drejtësisë, atë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili është institucioni që do garantojë pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin, etikën dhe karrierën e prokurorëve. KLP-ja ka disa analogji me KLGJ-në në lidhje me numrin e anëtarëve (11) dhe formimin e tyre (6 prokurorë, 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi). Ndryshimet kanë si qëllim decentralizimin e sistemit aktual të prokurorisë dhe fuqitë dhe privilegjet e larta të lëna në dorë të drejtuesve qendrorë dhe lokalë. Më konkretisht ndryshimet kushtetuese kanë si qëllim:

- a) garantimin e pavarësisë së prokurorëve dhe të zyrës së prokurorisë, si brenda prokurorisë, po ashtu dhe kundrejt aktorëve të tjerë;
- b) rishikimin e kompetencave të hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykatë;
- c) riorganizimin territorial të prokurorisë;
- d) forcimin e kriterëve kushtetuese për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Kuvendi zgjedh tashmë Prokurorin e Përgjithshëm me shumicë të cilësuar (3/5), mes 3 kandidatëve të propozuar nga KLP-ja, për një mandat 7-vjeçar pa të drejtë riemërimi;
- e) diversifikimin e përbërjes së Këshillit të Prokurorisë me anëtarë jashtë organit të Prokurorisë, nga radhët e shoqërisë civile, trupës pedagogjike dhe avokatisë;
- f) pavarësinë buxhetore të institucionit.

KLP ka si funksion kryesor të dhënë nga Kushtetuta në nenin 149/a, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve lidhur me statusin e prokurorëve, rekrutimin, emërimin, transferimin, riemërimin dhe disiplinimin e tyre; propozimin që i bën Kuvendit për kandidatin për Prokuror të Përgjithshëm;

miratimin e rregullave për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre; propozimin dhe administrimin e buxhetit të tij; informimin e publikut dhe Kuvendit mbi gjendjen e prokurorisë; dhe çdo funksion tjetër të caktuar me ligj.

iv. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është një organ ad hoc i cili verifikon kushte ligjore, profesionale dhe morale të kandidatëve për anëtarë të institucioneve të ndryshme të sistemit gjyqësor, duke filluar nga kandidatët për anëtar pranë Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Gjykatës së Lartë, tek kandidatët për anëtarë të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Ky Këshill përbëhet nga 9 anëtarë të përzgjedhur me short, nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ndaj të cilëve nuk është dhënë masë disiplinore, me kryetar, Kryetarin e Gjykatës së Lartë. Anëtarët e KED ushtrojnë detyrën me mandat njëvjeçar, që fillon në datën një janar të çdo viti kalendarik.

e) Institucionet e Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë

Kushtetuta e Shqipërisë, me ndryshimet e reja të miratuara në korrik 2016, parashikoi një rishikim themelor të aktorëve më të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, atë të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kushtetuta, në aneksin e ri të saj dhe ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, kanë parashikuar një rivlerësim të figurës së tyre mbi bazën e tre kritereve:

- 1) Vlerësimi i Pasurisë, ku si procedurë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët detyrohen të dorëzojnë deklaratën e pasurisë, si dhe të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
Kontrolli i pasurisë kryhet, përveçse mbi subjektin e rivlerësimit, edhe mbi bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët madhorë, apo çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit.
- 2) Kontrolli i Figurës ku të gjithë subjektet e rivlerësimit duhet të plotësojnë deklaratën e kontrollit të figurës. Institucionet e rivlerësimit (Komisioni

i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit) dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë SHISH kanë detyrim të verifikojnë nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.

- 3) Vlerësimi i Aftësisë Profesionale, ku organet e vetingut shqyrtojnë aftësitë profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit për 3 vitet e fundit, në bazë të vendimeve të dhëna dhe vlerësimeve të marra nga organet përkatëse, me tre rezultate të mundshme të vlerësimit: i aftë; me mangësi - gjyqtari/prokurori i nënshtrohet një programi ri trajnimi deri në I vit pranë Shkollës së Magjistraturës; dhe i papërshtatshëm - gjyqtari/prokurori ka treguar cilësi të papranueshme në punë, duke rezultuar në shkarkimin e subjektit nga pozicioni i tij dhe përjashtimin nga sistemi i drejtësisë për një periudhë 15-vjeçare.

i. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b, Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 84 /2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregulloreve të tjera të miratuara.

KP është organ kushtetues, i përbërë nga 12 komisionerë, të miratuar në bllok me vendimin nr.82/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Rregulloren e veprimtarisë së KPK-së, si dhe në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar. Bazuar në Ligjin nr. 84/2016, veprimtaria e Komisionit drejtohet nga Kryetari. Komisioni organizohet në 4 trupa gjykuese të përbërë nga 3 anëtarë, të cilët caktohen me short në fillim të çdo procedure rivlerësimi, duke vijuar më pas me procedurën e vlerësimit kalimtar të tre elementeve të sipërpërmendur për çdo subjekt të procedurës së rivlerësimit.

ii. Kolegji i Posaçëm i Apelit

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b, Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 84 /2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, si dhe rregulloreve të tjera të miratuara.

Kolegji e ushtron funksionin si pjesë e Gjykatës Kushtetuese, e cila gjatë kësaj periudhe kalimtare do të funksionojë me dy kolegje. Gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas pikës 3 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Ky kolegj përbëhet nga shtatë gjyqtarë (të miratuar në bllok me vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë) dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimimet kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe Ligjit.

KPA, gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë:

1. shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
2. ankimimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Kolegji gjykon në trupa gjyqëse të përbëra nga 5 gjyqtarë, të cilët caktohen me short për çdo çështje të paraqitur pranë tij, nga subjektet e procesit të rivlerësimit ose Institucioni i Komisionerëve Publikë.

iii. Institucioni i Komisionerëve Publikë

Institucioni i Komisionerëve Publikë, njësoj si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b të Kushtetutës dhe aneksit kushtetues. Mandati i Institucionit të Komisionerëve Publikë është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit të organit, dhe Komisionerët gëzojnë statusin e gjyqtarit të

Gjykatës së Lartë gjatë mandatit të tyre. Ky organ përfaqëson interesin publik gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar, si element kyç i të gjithë procesit të reformës në drejtësi, proces që synon garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi. Ai ka një funksion kushtetues, të pavarur dhe të paanshëm, dhe ushtron kompetencat e tij mbi bazën e parimeve të barazisë para ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Si një ndër organet që kryen procesin e rivlerësimit, referuar nenit 5/1 të Ligjit nr.84/2016, kompetencat e Institucionit të Komisionerëve Publikë janë:

- a) Ushtron ankimim ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ankimim që shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 179/b/5 i Kushtetutës, nenet C, pika 2, F, pika 2, F, pika 7, të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63/1 i Ligjit nr. 84/2016).
- b) Përgatit raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit për moszbatimin e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të paraqitur ankimim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (neni B, germa “c”, i Aneksit të Kushtetutës).
- c) Miraton rregulla për veprimtarinë e institucionit (neni 69/3 i Ligjit nr. 84/2016).

Praktikisht, Institucioni i Komisionerëve Publikë kryen rolin e prokurorit/ avokatit publik në procesin e rivlerësimit kalimtar përpara dhe pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

iv. Strukturat e posaçme antikorruption (SPAK)

Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” është hartuar për të vënë në zbatim ndryshimet kushtetuese të kryera mbi nenin 135, i cili përcakton krijimin e Gjykatës së Posaçme, që gjykon veprat penale të korrupsionit dhe të krimin të organizuar, si dhe shqyrton akuzat penale kundër zyrtarëve të nivelit të lartë në detyrë ose të kaluar (Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, anëtari i Këshillit të Ministrave, Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i

Lartë i Drejtësisë, Kryetari i Bashkisë, deputeti, zëvendësministri, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesit e institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj), si dhe parashikimet e nenit 148 dhe 148/dh mbi krijimin e Prokurorisë së Posaçme, Njësisë së Posaçme Hetimore dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, për ndjekjen penale dhe hetimin e këtyre veprave penale, administrimin dhe kompetencat e tyre, kushtet dhe kriteret shtesë që duhet të përmbushin shtetasit për t'u emëruar, transferuar apo për t'u ngritur në detyrë si gjyqtarë ose punonjës pranë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorë dhe punonjës pranë Prokurorisë së Posaçme, si dhe për t'u punësuar pranë Njësisë së Pavarur Hetimore, si dhe detyrimin e institucioneve të tjera shtetërore për bashkëpunim me këtë strukturë të specializuar.

Qëllimi i krijimit të kësaj strukture (SPAK) është nevoja e pasjes së një strukture të specializuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive çështjet e vështira të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe krimet e kryera nga zyrtarë të rëndësishëm, në mënyrë të pavarur dhe pa asnjë ndikim të papërshtatshëm. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të emëruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi, të pavarur në zhvillimin e hetimeve dhe ndjekjes penale nga çdo prokuror tjetër, duke përfshirë dhe Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesit e tyre. Akuzat penale të ngritura nga kjo prokurori gjykohen pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe Gjykatës së Lartë.

Byroja Kombëtare e Hetimit, gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelet e larta të pushtetit. Ajo ka në përbërjen e saj oficerë të Policisë Gjyqësore, shërbime të integruara me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse, të cilët janë nën drejtimin administrativ të Zëvendësdrejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe nën varësinë procedurale hetimore të Prokurorisë së Posaçme. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas kalimit të një vlerësimi dhe shqyrtimi të hollësishëm të aspekteve financiare dhe profesionale të tyre, dhe pas përfundimit të trajnimit të nevojshëm dhe emërimit në detyrë, shërbejnë për një periudhë mbi shtatë vjet në Byronë Kombëtare të Hetimit, duke iu nënshtruar gjatë kësaj periudhe një shqyrtimi të vazhdueshëm të financave të tyre personale dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të rrethit të

tij familjar dhe social, parashikuar kjo në përjashtimet nga disa të drejta kushtetuese bazike nga individët të cilët vullnetarisht kërkojnë të jenë pjesë e këtyre strukturave.⁵

v. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM) është një operacion monitorues i ngritur për të mbikëqyrur procesin e rivlerësimit kalimtar të anëtarëve të gjyqësorit në Shqipëri. Ky organ me përbërje ekspertësh ndërkombëtarë nuk ka funksione ekzekutive që prekin rivlerësimin aktual të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, çka kryhet nga organet vendore të vetingut dhe nuk financohet nga buxheti i shtetit shqiptar. Funksionimi i ONM-së në kuadër të reformës në drejtësi parashikohet në Nenin B të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, që parashikon skemën për të ashtuquajturin “Vlerësim Tranzitor i Kualifikimit”. Më datë 18 janar 2017, autoritetet shqiptare u kanë paraqitur një kërkesë zyrtare shërbimeve të Komisionit Evropian për praninë e ONM-së, duke e ftuar në mënyrë specifike ONM-në të fillonte operacionet e saj në kuadër të rolit që i jepet nga Kushtetuta.

Sipas këtyre parashikimeve, ONM-ja, e udhëhequr nga Komisioni Evropian, krijohet për të mbikëqyrur rivlerësimin e përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve (‘vetingun’) në vend. Ajo kryesohet nga Komisioni Evropian. Bordi menaxhues kryesohet nga Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit.

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon gjithashtu që ONM-ja përfshin partnerë në kuadrin e procesit të integritetit evropian dhe bashkëpunimit Euro-Atlantik. Veprimtaria e këtij organi mbështetet nga ekspertë të lartë të sistemit gjyqësor të Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Funksionet e ONM-së

- a) ONM-ja mbikëqyr procesin e krijimit të organeve të vetingut, duke dhënë një rekomandim mbi kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Pavarura të Kualifikimit, të Kolegjit të

⁵ Nenet 48 e në vijim të Ligjit Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”

Posaçëm të Apelimit dhe dy posteve të Komisionerëve Publikë. Ky rekomandim është paraqitur përmes Zyrës së Avokatit të Popullit, në vëmendje të Kuvendit. Kjo detyrë, tashmë e përfunduar është kryer me asistencën e katër vëzhguesve afatshkurtër (tre gjyqtarë/prokurorë të lartë nga sistemi gjyqësor i Shteteve Anëtare të BE-së dhe një nga Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara).

- b) Pas krijimit të organeve të vetingut, ONM-ja ka sjellë vëzhgues ndërkombëtarë për të monitoruar kryerjen aktuale të procesit të vetingut, përmes një operacioni afatgjatë që do të zgjasë deri në momentin kur të gjithë anëtarët përkatës të gjyqësorit në Shqipëri t'i jenë nënshtruar procedurës së vlerësimit kalimtar të kualifikimit.

Ajo që duhet theksuar në lidhje me veprimtarinë e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është fakti se ai ka një rol të kufizuar në rekomandimin e kandidatëve për pozicionet e komisionerëve në organet e ndryshme të Rivlerësimit Kalimtar, rekomandimit të Komisionerëve Publikë për apelimin e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe mbikëqyrjes së tërësisë së procedurave të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sistemit shqiptar të drejtësisë.



MEDIA, DREJTËSIA DHE ROLI I TYRE NË DEMOKRACI

Hyrje

Mediat dhe drejtësia janë elemente të rëndësishme për vendet e angazhuara në procesin demokratik, siç është rasti për disa shtete të Evropës Lindore, mes të cilave bën pjesë dhe Shqipëria. Ato janë të dyja të rëndësishme për modernizimin e praktikave demokratike në rastin e vendeve që i kanë mishëruar ato në norma dhe institucione. Marrëdhëniet kontradiktore, por komplementare që mediat mbajnë me gjyqtarët kontribuojnë në disa mënyra për të arritur një tranzicion demokratik ose, në të kundërtën, ato mund të luajnë një rol në dështimin e tij. Të dyja mundësitë mund të zbatohen për të gjitha nivelet institucionale, profesionale, deontologjike ose rregullatore.

Ballafaquar me shumë çështje që drejtësia dhe mediat paraqesin te vendimmarrësit, gjyqtarët dhe operatorët e medias, si dhe audiencat e tyre, duket e vështirë të shmangen pyetjet kryesore që Dominique Wolton ka formuluar në librin e tij *Penser la communication*: “në cilat kushte duhet të shpëtojmë dimensionin e mrekullueshëm të komunikimit, një nga më të lavdërueshmit të shpikur nga njeriu, që nxit dëshirën e tij për të kontaktuar me të tjerët, të shkëmbejë pikëpamjet me ta, kur gjithçka paralajmëron kundër tij në aspektin e interesave? Si mund ta shpëtojmë dimensionin humanist të komunikimit kur elementet e tij instrumentale fitojnë ditën? Cila është marrëdhënia midis idealit të komunikimit, i cili kalon epokën dhe qytetërimet, në atë masë sa ai të bëhet një nga simbolet më të habitshme të njerëzimit, dhe interesave dhe ideologjive me të njëjtin emër?”⁶

Roli i medias dhe drejtësisë përbën një temë debati të vazhdueshëm. Sistemet e medias po ndryshojnë thellësisht strukturat mendore, pikat kulturore të

⁶ Dominique Wolton; *Penser la communication*; Flammarion, 1997, 400 p. Version poche, Champs, Flammarion, 1998, 402 p.

referencës dhe ndjeshmërinë estetike kudo, duke përfshirë edhe rajonin tonë. Kështu, proceset e demokratizimit lejojnë përbrendësimin dhe miratimin e një sërë normash dhe kartash universale në korpusin gjyqësor. Edhe pse mediat kanë një rëndësi strategjike në formulimin e pritjeve, mangësive, frustrimeve dhe dëshirave të njerëzve në zonën e Evropës Juglindore, sistemi ligjor është një pikë vendimtare në krijimin e një shteti ligjor. Ideja e drejtësisë është thelbësisht e natyrshme në marrëdhëniet njerëzore, të cilat duhet të udhëhiqen tërësisht nga parimi i barazisë dhe t'i mundësojë atij të bëhet realitet duke i dhënë secilit person të drejtat që ai ose ajo kanë në parim. Ekziston një përplotësi mes dy profesioneve në vendosjen e praktikave të mira demokratike, pavarësisht nga kufizimet dhe interesat e tyre: media në zbulimin e hijeve të pushtetit dhe përdorimin e aftësisë së saj për ta vënë atë në kontroll të publikut, dhe drejtësia duke zbatuar ligjin dhe dhënien e vendimeve në përputhje me të.

Çdo herë, media dhe drejtësia përballen me një sfidë të trefishtë: e para lidhet me çështjen e besimit dhe kredibilitetit të atyre që veprojnë në dhe përmes medias dhe atyre që kanë fuqinë për të gjykuar dhe që supozohet të jenë kujdestarë të ligjit. E dyta është e natyrshme në kompetencat e këtyre njerëzve dhe në aftësinë e tyre për të siguruar informacion mbi konfliktet që prekin shoqërinë në një mënyrë që përputhet me kodin profesional të etikës në lajme dhe zbatimin e drejtë të ligjit, në kuptimin e mbajtjes së balancës mes interesave të ndryshme brenda shoqërisë dhe rregullimin e tensioneve të saj të brendshme, në rastin e gjyqtarëve. Sfida e tretë përbëhet nga llojet e ndryshme të përpjekjeve për të shfrytëzuar median dhe gjyqësorin nga fuqitë politike, ekonomike dhe ideologjike.

a) Marrëdhënia e institucioneve të drejtësisë me median dhe problemet e hasura në praktikë

Ndërtimi, mbajtja dhe zhvillimi i komunikimit me median konsiderohet si një nga funksionet dhe aspektet parësore të marrëdhënieve me publikun të institucioneve shtetërore, ndër këto dhe gjyqësorit. E karakterizuar si burimi kryesor i informacionit për publikun, media e informon atë rreth punës së qeverisë, por jo vetëm. Kontributi dhe roli kryesor i medias në një shoqëri demokratike mbetet monitorimi i aktiviteteve të institucioneve qeveritare, edhe pse realiteti shqiptar ka treguar se media ka një rol të kufizuar në këtë fushë. Shumë gazetarë, në raporte të ndryshme flasin për fshehjen e

informacionit nga sektorët e marrëdhënieve me publikun në institucionet e drejtësisë, fenomen i cili nuk i ndihmon, por përkundrazi i vendos në një situatë të pafavorshme dhe minon themelet e të drejtës për informacion të publikut. Një situatë e tillë është vërejtur dhe vijon të vërehet dhe për sa i përket marrëdhënies mes gazetarëve dhe specialistëve (personat e ngarkuar për marrëdhëniet me publikun/shtypin) pranë institucioneve të drejtësisë.

Ndër problematikat e listuara nga specialistët e marrëdhënieve me publikun dhe punonjës të institucioneve të drejtësisë në lidhje me median, mund të përfshihen:

1. Mungesa e transparencës. Moskonfirmimi i lajmit. Janë hermetikë.
2. Cenimi i objektivitetit gjatë raportimit të lajmit.
3. Përzgjedhja preferenciale e mediave për dhënien e informacionit.
4. Publikimi i informacionit duke iu referuar burimeve jo zyrtare.
5. Mungesa e personave të aftë dhe profesionistë në zyrat e shtypit.
6. Më të përgjegjshëm gjatë publikimit të lajmeve që mund të cenojnë hetimet.
7. Fshehja e informacioneve dhe ndodhive negative që mund t'i përkasë institucionit përkatës.
8. Informimi i publikut në kohë reale lidhur me zhvillimet e institucionit.
9. Baraspeshimi i magnitudës së informimit kundrejt etikës për mospublikimin e të dhënave që mund të cenojnë lirinë e individit.
10. Nuk organizojnë asnjëherë takime, prezantime apo aktivitete joformale me grupet e gazetarëve. Organizimin e trajnimeve të përbashkëta me gazetarë të medias që mbulojnë sistemin e drejtësisë.
11. Përcjellja e njoftimeve që nuk përmbushin kriteret e njoftimit për shtyp.
12. Shmangia e problematikave për publikimin e të dhënave sensitive.
13. Mungesa e vazhdueshme e komunikimit midis zyrave të shtypit dhe mediave.
14. Të ruajnë parimet për informimin e publikut dhe të shmangin dezinformimin.
15. Nëse ka lajm që ngre vlerat e institucionit, zëdhënësit bëhen miqtë më të mirë të gazetarëve, por nëse do të rrëmosh më thellë nuk i ke në krah, dhe prit kur të të marrin në telefon dhe të të kritikojnë.
16. Nguti për të publikuar të parët një lajm, shpeshherë bëhet faktor për informim të pasaktë, gjë që në një formë apo tjetër forcon perceptimet negative për institucionet e drejtësisë.

17. Ndërrimi i shpeshtë i zëdhënësve, gjë që ndikon në rënien e vrullit të punës, duke mos u treguar në çdo moment korrekt apo të angazhuar për detyrën.
18. Vënia e theksit te ngjarjet negative, publikimi në kanale të ndryshme dhe përsëritja e vazhdueshme mbart rrezikun e minimit të besimit te institucionet e drejtësisë.
19. Komunikojnë me median vetëm kur kanë nevojë, e shikojnë komunikimin në një drejtim.
20. Gazetarët e aktualitetit duhet të kenë njohuri bazike juridike. Një lajm i servirur keq dëmton vetë lajmin, si dhe rrezikon besueshmërinë e medias që e jep.
21. Nuk kanë formimin e duhur shkencor dhe akademik. Janë të ngurtë dhe të pakënaqur për punën që bëjnë. Nuk e njohin kodin e etikës.
22. Në media qarkullojnë lajme të pavërteta ose fryt i fantazisë së gazetarëve. Spekulimi në këtë drejtim është thuajse i pashmangshëm.
23. Vonesa në marrjen e përgjigjeve për kërkesat. Por edhe kur kthejnë përgjigje, e bëjnë duke u përgjigjur për atë çfarë duan.
24. Nëse informacioni i saktë mungon, nevoja e publikut për lajm do të mbushet nga informacione të pakonfirmuara.
25. Në shumë raste nuk japin informacionin e kërkuar, duke shtyrë dhënien e përgjigjes deri në heqjen dorë të gazetarit nga kërkesa.
26. Mungesa e njohurive të disa gazetarëve për të lundruar në faqen e internetit të gjykatës. Përpjekjet për të ndikuar në daljen e lajmit.
27. Në disa raste mediat kanë ndikuar negativisht në procesin e hetimit.
28. Në disa raste kur media kontakton me zyrtarin e MP për të marrë një intervistë nga TITULLARI, zyrtari i MP, e lajmëron atë.
29. Hetimet lidhen me persona të caktuar, është në lojë nderi, reputacioni, emri i mirë publik i tyre, ndaj bërja publike e të dhënave kur hetimet nuk kanë përfunduar cenon këto vlera.
30. Zyra e shtypit nuk merr kompetenca si zyrë shtypi (dhe kjo ndodh kudo). Por më shumë vihet re në sistemin e drejtësisë, ku një zëdhënës/e shtypi nuk merr përsipër të japë një intervistë (jashtë deklaratave për mediat), të jetë zëri institucional i hapësirës që mbulojnë, pa qenë nevoja që gazetarët të rropaten nëpër zyra për të marrë reagime lidhur me tema të ndryshme që trajtojnë.
31. Shumë rrallë ndodh që një lajm i rremë të përgënjeshtrohet, shpesh herë cenohet në mënyrë flagrante prezumimi i pafajësisë. Çdokush është i pafajshëm nëse nuk ka një vendim fajësie të formës së prerë.

Ndërtimi i lajmeve mbi aludime ndikon që publiku të marrë si kriter orientues lajmin e servitur nga media, për shkak të ndikimit që media ka.

32. Zyrat e Shtypit në shumicën e rasteve nuk janë 24 orë në shërbim, kanë mungesë personeli.

b) Sistemi i drejtësisë dhe zhvillimi i marrëdhënies me publikun

Evoluimi i marrëdhënieve me publikun në sistemin e drejtësisë duhet gjithmonë të shihet në një rrafsh me zhvillimet politike dhe sociale, por edhe kulturore në vend. Nisur nga pritshmëritë për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pjesë e të cilës është dhe përafrimi i kuadrit ligjor për të drejtën e informimit me rregulloret dhe direktivat evropiane, si dhe ndërmarrja e një numri të gjerë angazhimesh në reformën në drejtësi, transparenca ndaj publikut dhe hapja e institucioneve për qasjen ndaj informacionit të një natyre publike ka përbërë sfidën kryesore të institucioneve të drejtësisë. Ndër zhvillimet kryesore, me kalimin e viteve, kanë qenë ndryshimet e shumta ligjore mbi aksesin e publikut në të dhënat zyrtare,⁷ duke arritur kulmin me miratimin e Ligjit të 2014 mbi të Drejtën e Informimit, një kuadër ligjor i cili nga shumë autorë dhe specialistë të fushës është parë si një nga ligjet më avangardë të fushës.⁸

Pavarësisht hyrjes në fuqi të këtij ligji, që përbën dhe shtyllën kurrizore të marrëdhënieve me publikun të gjithë institucioneve shtetërore, duke përfshirë këtu organet administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj⁹; shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve¹⁰ apo çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike, marrëdhëniet me publikun të institucioneve të drejtësisë ka qenë dhe ende mbetet e cenuar, duke filluar nga mungesa e personave të kontaktit me publikun, mungesa e marrëdhënies formale mes

⁷ Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

⁸ URL - https://issuu.com/respublicalb/docs/komentar_foi_web

⁹ Neni 2/1/a, Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

¹⁰ Neni 2/1/c, Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

këtyre institucioneve dhe medias, dhe siç do ta shohim më poshtë, në shumë raste, mungesa e një kuadri rregullator të unifikuar mbi këto marrëdhënie.

Modeli i komunikimit me publikun të institucioneve të drejtësisë, si rrjedhojë e mungesës së strategjive për marrëdhëniet me publikun, ka krijuar një format logjikisht jo ideal për të kuptuar procesin e vendimmarrjes, menaxhimit e reputacionit, si dhe orientimet për të marrë informacion.

c) **Institucionet e drejtësisë dhe komunikimi me publikun**

i. Prokuroria e Përgjithshme

Në strukturën organike të Prokurorisë së Përgjithshme, sektori i marrëdhënieve me publikun është i ndarë nga zyra e shtypit me zëdhënësin e medias, pjesë të kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm, ndërsa zyra e marrëdhënieve me publikun, e cila ka qenë nën varësinë e Drejtorisë së Studimeve Kërkimore Ligjore dhe Integritit, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm është hequr si drejtori.¹¹ Si në shumë institucione të drejtësisë, por dhe më gjerë, komunikimi me median drejtohet dhe ndikohet nga titullari i institucionit, duke nxitur kontrollin menaxherial të mesazheve, ndërkohë komunikimi me publikun përbën një praktikë rutinë të nivelit të ulët në institucion. Në përgjigjet dhënë pyetësorit të Këshillit të Evropës dhe Këshillit Konsultativ për Prokurorët Evropianë, në kuadër të Opinioneve Nr. 8 mbi marrëdhëniet e prokurorisë me mediat,¹² Prokuroria e Përgjithshme, pyetjes se kush janë personat përgjegjës për dhënien e informacionit medias, në kuadër të proceseve penale, i është përgjigjur se “*Marrëdhëniet me median janë ndërtuar dhe zbatuar vetëm nga zëdhënësi i Prokurorit të Përgjithshëm...*”, duke shkuar më tej se për çështje specifike “*Është Prokurori i Përgjithshëm ai që urdhëron prokurorët e çështjes në rastet kur lejohet të komunikojnë me mediat*”, kjo në mungesë të një kuadri rregullator mbi marrëdhëniet me mediat.

¹¹ Struktura e mëparshme, gjetur në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme në <http://www.pp.gov.al/web/struktura>, datë 12.11.2013. Struktura e re, gjetur në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme në http://www.pp.gov.al/web/struktura_pp_2019_1449.pdf

¹² Këshilli Konsultativ i Prokurorëve të Evropës (CCPE): Pyetësori për përgatitjen e Opinioneve të CCPE nr. 8 mbi marrëdhëniet ndërmjet prokurorëve dhe mediave. URL -<https://rm.coe.int/consultative-council-of-european-prosecutors-ccpe-questionnaire-for-th/168071c7fe>

Marrëdhëniet ndërmjet mediave dhe prokurorisë nuk rregullohen me ligj të veçantë, por parashikohen nga neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. “1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Secili ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”. Nenet 103 dhe 279/2 të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë rregulla për ndalimin e publikimit të akteve dhe çështjen në cilat raste lejohet publikimi i tyre. Neni 40 i Ligjit 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) përcakton se: “Prokurorëve u ndalohet të bëjnë publike ose t’u japin të dhëna personave të tretë, duke pasur parasysh se kjo mund të dëmtojë rasti në procesin e hetimit ose gjykimin, si dhe nga zbulimi i të dhënave me karakter konfidencial dhe të rezervuar.” I njëjti qëndrim është mbajtur dhe në Ligjin nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 9, në të cilin parashikohet se “...2. Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t’u japë personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar. 3. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.”. Por në të njëjtën kohë, ky ligj, në linjë dhe me Ligjin ‘Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë’, parashikon krijimin e një pozicioni të veçantë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, i cili do të ketë si rol kryesor marrëdhëniet me median dhe publikun. Neni 61 i ligjit parashikon që “Shërbimet për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyren prej tij. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.”

Në të njëjtën kohë drejtuesit e prokurorive përcaktojnë dhe nëpunësin civil përkatës për marrëdhëniet me publikun, si koordinator për të drejtën e informimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për të drejtën e informimit”. Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të këtij ligji ka përcaktuar personat përkatës në një listë shteruese në website-in e saj,¹³ por në pikëpyetje

¹³ Lista e Koordinatorëve për të drejtën e Informimit në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore ndodhet në http://www.pp.gov.al/web/kordinatore_t_27_09_2017_1126_1197.pdf

mbetet efektiviteti i përdorimit të këtij mekanizmi dhe përditësimi i koordinatorëve. Nga eksperiencia e relatorëve të këtij udhëzuesi, kërkesat për informacion përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme përmes rubrikës së posaçme të krijuar në website-in e saj¹⁴ kanë mbetur pa përgjigje.

ii. Gjykatat e Faktit

Në aspektin e zhvillimit strukturor, gjykatat e faktit të Republikës së Shqipërisë kanë një kuadër rregullator më të përparuar se ai i Prokurorisë së Përgjithshme. Zhvillimi i marrëdhënieve me publikun në gjykatë ka një specifikë të veçantë, pasi komunikimi kryhet nëpërmjet vendimit që jep gjykatësi dhe interpretohet, perceptohet dhe “gjykohet” nga sisteme të ndryshme sociale, pjesë e së cilës është edhe media. Ndryshimet ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri, kanë synuar kufizimin e imunitetit të gjyqtarëve, me qëllim përmirësimin e besimit të publikut.¹⁵ Në kuadër të hapjes së informacionit për publikun, digjitalizimi i të dhënave të sistemit gjyqësor është konsideruar si zhvillimi më i rëndësishëm, ku çdo qytetar mund të marrë online 24 orë në 24 informacion të detajuar për çështjet në gjykim, dhe përtej.¹⁶ Në këtë kuadër, programe të ndryshme janë implementuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për të avancuar praktikën e hapjes së këtyre institucioneve drejt publikut dhe medias. Një ndër projektet më afatgjata dhe të frytshme ka qenë dhe krijimi i një portali online të konsoliduar, me informacionin relevant mbi çdo gjykatë në rang vendi. Mes informacionit të përmbajtur në këtë portal, mund të gjendet informacion mbi përbërjen e gjykatave të shkallëve të ndryshme në rang vendi (të faktit dhe administrative), procedurat gjyqësore pranë këtyre gjykatave, adresat dhe personat e kontaktit (por jo gjithmonë, Gjykatës së Lartë i mungon informacioni kontakti i çfarëdo forme); kalendarët e seancave; shortet e çështjeve gjyqësore, publikime të ndryshme, dhe shumë informacione të tjera të nevojshme për palët e interesuara. Pavarësisht kësaj iniciative, edhe ky sistem ka problemet e tij, me mungesë të përditësimit të vazhdueshëm

¹⁴ Faqja e kontaktit gjendet në http://www.pp.gov.al/web/Kontakt_9_1.php

¹⁵ Neni 6 e vijues Ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁶ Në portalin <http://www.gjykata.gov.al/> çdo individ ka të drejtën të ketë akses në faqet specifike të krijuara për Gjykatën e Lartë, çdo gjykatë Apeli, çdo gjykatë të shkallës së parë, e gjykatat administrative, të cilat kanë faqen online në këtë portal. Sistemi i dixhitalizimit transformohet nga një sistem i decentralizuar të dhënash për secilën gjykatë, në një sistem të përqendruar. Ky sistem garanton gjurmimin e çështjes nga momenti i paraqitjes në gjykatë, deri në përfundimin në të gjitha shkallët e gjykimit, përfshi ekzekutimin.

të informacionit, por dhe të informacionit të kontaktit të koordinatorëve për të drejtën e informimit, siç u vu re dhe nga eksperiencia e përpiluesve të këtij raporti në marrëdhëniet me Gjykatën Civile të Shkallës së Parë Tiranë.

Që në fillimet e sistemit pluralist në Shqipëri dhe sistemit të drejtësisë të bazuar në ligje organike dhe themelore të ndërtuar mbi praktikën më të mira evropiane, thembra e Akilit, në vazhdimësi për këto institucione ka qenë papërshtatshmëria e mjeteve për marrëdhëniet me publikun dhe aksesin e këtij të fundit në praktikën e punës së tyre, influencuar kjo dhe nga një paragjykim i arsyeshëm i krijuar nga publiku kundrejt këtyre institucioneve. Siç shpjegon Callison-i “marrësi i mesazhit peshon dhe gjykon besueshmërinë e komunikuesit të mesazhit”, dhe ky mesazh është prekur në vazhdimësi nga mungesa e besueshmërisë së publikut ndaj institucioneve të drejtësisë, për çështje jo të lidhura, por që influencojnë në gjykimin e përgjithshëm mbi to.¹⁷

iii. Gjykata e Lartë

Gjykata e Lartë ka në strukturën e saj një sektor të veçantë të marrëdhënieve me median dhe publikun, sektor i cili në bashkëpunim edhe me sektorë të tjerë, i ofron disa shërbime publikut.

Në këtë kuadër kjo marrëdhënie konsiston në disa forma, me të cilat publiku përballet kur paraqitet pranë Gjykatës së Lartë. Si më poshtë:

- a) Vendosjen e rregullave të pjesëmarrjes së publikut në veprimtaritë e gjykatës (gjyqe, aktivitete, vizita, njohje me procedurat dhe vendimmarrjen, etj.)
- b) Rregullimin e detajuar të procedurave dhe të përgjegjësive brenda gjykatës, në funksion të garantimit të së drejtës për informim dhe marrëdhënies me publikun. (pasqyrim informacioni në faqen zyrtare të gjykatës, pritje me popullin, sqarim dhe kthim përgjigje me postë ose drejtpërdrejt në sportelet e përcaktuara dhe me orar).
- c) Garantimin e së drejtës së publikut për informim në mënyrë uniforme, të barabartë, të drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

¹⁷ Coy Callison, “Do PR Practitioners Have a PR Problem?: The Effect of Associating a Source with Public Relations and Client-Negative News on Audience Perception of Credibility”, *Journal of Public Relations Research* 13(3), 2001, fq. 220

- d) Përcaktimin e procedurave për dhënien e informacionit që përmbajnë dokumentet zyrtare. (Plotësim të formularëve, përgjigje nëpërmjet postës elektronike të gjykatës)

Në këtë kuadër “marrëdhënie me publikun” do të thotë marrëdhënie e dyanshme e gjykatës nga njëra anë dhe e publikut nga ana tjetër, ku gjykata ka për detyrë të informojë publikun me saktësi, profesionalizëm dhe në mënyrë të barabartë mbi veprimtarinë e saj, sipas kufizimeve që përmban ligji. Këtu përfshihet jo vetëm detyrimi për të dhënë informacion me kërkesë të publikut, por edhe detyrimi i gjykatës për të informuar publikun mbi veprimtarinë e saj pa kërkesë.

Sa i takon informacionit, ai ndahet në: informacion me akses “të pakufizuar”, të dhëna që gjenden në dokumentet e gjykatës, që nuk ndalohen nga asnjë ligj për t’u bërë publike; si dhe “informacion me akses të kufizuar” që është e dhëna që gjendet në dokumentet e administruara nga gjykata, dhënia e të cilit për publikun mund të refuzohet. (Por gjithmonë publiku merr një përgjigje mbi arsyet e refuzimit ose jo të kërkesave).

Gjykata dhe Media

Përmirësimi i raporteve me median në drejtim të informimit është një aspekt shumë i rëndësishëm i punës së Gjykatës së Lartë dhe Zyrës së Shtypit në veçanti, për rritjen e besimit të publiku dhe krijimit të një marrëdhënieje sa më korrekte dhe bashkëpunuese me mjetet e informimit publik (medias vizive dhe të shkruar).

Zyra e Shtypit të Gjykatës së Lartë ka një rubrikë të veçantë në faqen në rrjet të kësaj gjykate,¹⁸ ku shfaqen të gjithë njoftimet për median dhe për publikun mbi aktivitetet dhe veprimtarinë e këtij institucioni, në mënyrë të përditësuar.

Përtej kësaj rubrike specifike, por tejet të kufizuar, të vënë në funksion të medias, kjo gjykatë ka vënë në dispozicion të publikut rubrikën e “Programit të Transparencës”¹⁹ i përgatitur në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Lartë,

¹⁸ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Njoftime_9_1.php

¹⁹ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Programi_i_Transparences_10_1.php

nëpërmjet pasqyrimin të detajuar të tij në faqen zyrtare www.gjykataelarte.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Programi i detajuar i transparencës parashikon dhe mundësinë e medias për pjesëmarrje në seancat publike, por pa u ndaluar në detajet e procedurës së paraqitjes së kërkesës apo garantimin e saj. Rregullorja²⁰ parashikon vetëm se “Media e shkruar dhe audiovizuale duhet të kontaktojë me këtë sektor [Sektorit të Marrëdhënieve me Publikut dhe Median] për ushtrimin e veprimtarisë së saj në ambientet e Gjykatës së Lartë. Kontaktet për marrëdhëniet e publikut dhe medias me institucionin e Gjykatës së Lartë janë të përfshira në një rubrikë të veçantë në faqen ueb të saj.”²¹

iv. Gjykata Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, si të gjithë institucionet e tjera të drejtësisë, i nënshtrohet normave ligjore të Ligjit për të drejtën e informimit. Kjo gjykatë operon sipas parimit të transparencës për publikun dhe bashkëpunimit me median në çdo hallkë të procesit vendimmarrës. Në të njëjtën frymë me institucionet e tjera të përmendura në këtë kapitull, as kjo gjykatë nuk ka në vend një procedurë të veçantë për marrëdhënien me mediat, por çdo gazetar i interesuar, mbi kërkesën e tij për marrje informacioni nga kjo e fundit, i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të përfutimit të informacionit publik, të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Në faqen në rrjet të Gjykatës Kushtetuese, seksioni i transparencës²² përbëhet nga një numër rubrikash të cilat vijnë në ndihmë të qytetarit, përfshirë këtu programin e transparencës, regjistrin e kërkesave për informacion, kontaktin e koordinatorit për të drejtën e informimit, informacione të përgjithshme mbi këtë gjykatë, aplikimin online për informacion dhe modalitetet për të kontaktuar gjykatën dhe marrë pjesë në seancat publike.

Në bazë të parashikimeve të kësaj rubrike, hapi i parë për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, është paraqitja e kërkesës me shkrim. Çdo subjekt

²⁰ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Programi_i_Transparences_per_Gjykatën_e_Lartë_2781_1.php

²¹ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Informacione_kontakti_2_1.php

²² http://www.gjk.gov.al/web/Transparenca_1333_1.php

mund ta realizojë këtë veprim duke respektuar elementet formale të saj, sipas parashikimeve të nenit 27 si dhe nenet 71 e 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, ndryshuar me ligjin nr.99, datë 06.10.2016.

Kërkesa depozitohet në Drejtorinë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit të kësaj Gjykate, pa pasur nevojë që të bashkëngjiten dokumente të tjera mbështetëse. Kërkesa mund të dërgohet edhe me postë në adresën e Gjykatës Kushtetuese: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.26, Tiranë. Për çdo informacion tjetër kjo gjykatë ka venë në dispozicion një numër telefoni dhe një adresë email për publikun në faqen e saj në rrjet.²³

Për sa i takon aksesit të publikut në seancat gjyqësore, çdo person ka të drejtë të marrë pjesë në seancat publike, duke respektuar rregullat, rendin dhe solemnitetin e gjykimit.

Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 21 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shqyrton çështjet në seancë plenare publike ose mbi bazë dokumentesh, sipas natyrës së çështjes.

Seancat publike zhvillohen në sallën e gjykimit me praninë e palëve. Personat e thirrur si subjekte procedurale në gjykim, ose personat e tjerë që asistojnë në seancat gjyqësore (publiku, përfaqësuesit e medias, etj.), duhet të njoftojnë paraprakisht pjesëmarrjen e tyre dhe të paraqiten në ambientet e Gjykatës gjysmë ore përpara fillimit të seancës gjyqësore. Pas identifikimit të tyre ata i nënshtrohen kontrollit fizik elektronik nga punonjësi i ruajtjes së sigurisë, pajisen me fletëhyrje dhe shoqërohen prej tij në sallën e gjykimit.

Kjo gjykatë, si shumë institucione të tjera gjyqësore, nuk ka bërë parashikime specifike për marrëdhënien e mediave, veprimtarinë e medias në sallën e gjyqit, prezencën e mjeteve regjistruese audio dhe video dhe transmetimin live/në një moment të dytë, të procedimeve gjyqësore.

Në kundërpërgjigje të problematikave ekzistuese, si dhe rritjen e besimit të publikut, Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin Nr. 96/2014 krijoi komisionin

²³ http://www.gjk.gov.al/web/Kontakt_88_1.php

e posaçëm “Për reformën në sistemin e drejtësisë”, objekt kryesor i punës së të cilit përbën analiza e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë dhe propozimi i masave konkrete për reformën në sistem, duke synuar përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e transparencës ndaj publikut. Shumë prej institucioneve të krijuara përmes kësaj reforme kanë reformuar gjithashtu dhe mënyrën e zhvillimit të marrëdhënieve me publikun, duke filluar nga koordinatorët për të drejtën e informimit të dedikuar për marrëdhëniet me median, deri tek krijimi i pozicioneve të posaçme pranë gjykatave dhe prokurorive si ato të magistratit për median (referencë nenit në ligj dhe funksionit) dhe pozicionin analog pranë prokurorive të rretheve, atë të të Prokurorit për median (shiko më lart).

Për marrëdhëniet me publikun të këtyre institucioneve do të flasim në kapitujt në vijim. Por, përpara se të prekim institucionet e Republikës së Shqipërisë dhe praktikat më të mira vendase për bashkëveprim të medias me to, le të shohim praktikat më të mira ndërkombëtare mbi një numër çështjesh në marrëdhëniet e saj me disa nga organet e drejtësisë.



PARIMET DHE STANDARDET EVROPIANE PËR BASHKËVEPRIMIN DHE RAPORTIMIN NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Hyrje

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është forma më e rëndësishme e shprehjes së lidhjes së Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës me vlerat e demokracisë, të paqes dhe drejtësisë dhe, nëpërmjet tyre, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore e individëve që jetojnë në këto shoqëri.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”) u nënshkrua më 4 nëntor 1950 në Romë. Gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, Konventa ka përparuar si nga interpretimi i dhënë në tekstet e saj nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, por dhe nga puna e vetë Këshillit të Evropës. Këshilli ka miratuar protokollat shtesë,²⁴ të cilët kanë zgjeruar fushën e veprimit të Konventës, rezolutat

²⁴ Protokoll i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 20 mars 1952 (Nuk është ratifikuar nga Zvicra);

Protokoll nr. 2 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, duke i dhënë kompetencave të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që të japin mendime këshillimore - 6 maj 1963 (Zëvendësuar nga Protokoll Nr. 11)

Protokoll nr. 3 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, duke ndryshuar nenet 29, 30 dhe 34 të Konventës - 6 maj 1963 (Zëvendësuar nga Protokoll Nr. 11)

Protokoll nr. 4 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, duke siguruar disa të drejta dhe liri të ndryshme nga ato që tashmë janë përfshirë në Konventë dhe në Protokollin e parë të saj - 16 shtator 1963 (Nuk është nënshkruar nga Zvicra)

Protokoll nr. 5 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, duke ndryshuar nenet 22 dhe 40 të Konventës - 20 janar 1966 (Zëvendësuar nga Protokoll Nr. 11)

Protokoll nr. 6 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në lidhje me Heqjen e Dënimit me Vdekje - 28 prill 1983

Protokoll nr. 7 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 22 nëntor 1984

dhe rekomandimet që kanë zhvilluar dhe u kanë propozuar standardeve të sjelljes Shteteve Anëtare, dhe ka vendosur sanksione për shtetet që nuk i janë përmbajtur frymës së dispozitave të Konventës.

Pothuajse të gjitha shtetet palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë integruar Konventën në legjislacionin e tyre kombëtar.²⁵ Konventa është kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe është e detyrueshme për gjykatat vendase dhe për të gjitha autoritetet publike. Më tej vijon se të gjithë individët në shtetet në fjalë nxjerrin të drejta dhe detyra nga Konventa, kështu që në procedurën kombëtare ato mund të thirren drejtpërdrejt në tekstin dhe jurisprudencën e tyre, të cilat duhet të zbatohen nga gjykatat kombëtare. Për më tepër, autoritetet kombëtare, duke përfshirë këtu gjykatat, duhet t'i japin përparësi Konventës mbi çdo ligj kombëtar që bie ndesh me të dhe jurisprudencën e saj.

Teksti i Konventës nuk mund të lexohet jashtë jurisprudencës së saj. Konventa funksionon sipas sistemit të së drejtës së përbashkët. Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Gjykata”) shpjegojnë dhe interpretojnë tekstin. Ata janë precedentë detyrues, statusi ligjor i të cilave është ai i normave ligjore të detyrueshme. Prandaj, sapo të ratifikohet Konventa, autoritetet kombëtare të të gjitha shteteve nënshkruese, duke

Protokolli nr. 8 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 19 mars 1985 (Zëvendësuar nga Protokolli Nr. 11)

Protokolli nr. 9 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 6 nëntor 1990 (Zëvendësuar nga Protokolli Nr. 11)

Protokolli nr. 10 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut - 25 mars 1992 (Zëvendësuar nga Protokolli Nr. 11)

Protokolli nr. 11 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ristrukturimin e mekanizmit të kontrollit të krijuar në këtë mënyrë - 11 maj 1994

Protokolli nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore - 4 nëntor 2000 (Nuk është nënshkruar nga Zvicra)

Protokolli nr. 13 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, në lidhje me heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat - 3 maj 2002

Protokolli nr. 14bis i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Zëvendësuar nga Protokolli Nr. 14)

Protokolli nr. 14 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, që ndryshon sistemin e kontrollit të Konventës - 13 Maj 2004

Protokollet 15 dhe 16 të Konventës, pavarësisht se janë miratuar më 24 qershor 2013 dhe 2 tetor 2013, respektivisht, ende nuk kanë hyrë në fuqi për shkak të mungesës së ratifikimit të tyre nga një numër i caktuar vendesh.

²⁵ Republika e Shqipërisë ka ratifikuar dhe përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kuadrin e saj ligjor me Ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, botuar në Fletoren Zyrtare FZ. 20-1996.

përfshirë ato që ushtrojnë një sistem të drejtësisë civile (kontinentale) duhet të konsiderojnë gjykimet e Gjykatës si ligj të detyrueshëm. Për këtë arsye ky manual i referohet gjerësisht jurisprudencës së Gjykatës. Në këtë drejtim, duhet të kuptojmë se në ditët e sotme edhe sistemet civile tradicionale ligjore praktikojnë një sistem të përzier civil dhe common law, ku jurisprudencës i jepet një vlerë e barabartë me atë të ligjeve të miratuara dhe kodifikuara nga Parlamenti.

Interpretimi i tekstit të Konventës është dinamik dhe evolutiv, duke e bërë Konventën një instrument të gjallë që duhet të interpretohet në dritën e kushteve sociale dhe ekonomike të ditës. Prandaj, Gjykata është (dhe duhet të jetë) e ndikuar nga zhvillimet dhe standardet e pranuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Skema e përgjithshme e Konventës është se përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të parashtruara në to u takon Shteteve Anëtare. Gjykata është e pranishme për të monitoruar veprimet e shteteve, duke ushtruar fuqinë e rishikimit të vendimeve/veprimtarisë së tyre. Hapësira vendase e vlerësimit në këtë mënyrë shkon krah për krah me mbikëqyrjen evropiane. Një shteti i lejohet një diskrecion i konsiderueshëm në rastet e emergjencave publike që lindin sipas nenit 15²⁶ ose kur ka pak bazë të përbashkët mirëkuptimi ndërmjet Shteteve Palë për çështje sensitive, ndërkohë që liria e veprimit zvogëlohet pothuajse deri në pikën e zhdukjes në fusha të caktuara, siç është mbrojtja e lirisë së shprehjes.

a) **Parimet e përgjithshme të ndërveprimit të gjyqësorit me median**

Informimi i publikut për procedurat gjyqësore është një veprimtari gazetareske që drejtohet nga të drejtat themelore, përkatësisht e drejta për lirinë e shprehjes, duke përfshirë të drejtën për të marrë dhe për të dhënë informacione dhe ide të përcaktuara në nenin 10 të KEDNJ-së,²⁷ detyrimet

²⁶ Neni 15 KEDNJ - Derogimi në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme.

²⁷ Neni 10 KEDNJ - NENI 10 Liria e shprehjes I. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë...

pozitive të shteteve palë sipas nenit 6²⁸ për të siguruar administrimin e drejtë të drejtësisë dhe nevojën për të mbrojtur privatësinë e palëve në procedurat gjyqësore në përputhje me nenin 8 të KEDNJ.²⁹ Me një sy në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe instrumente të tjera relevante të Këshillit të Evropës, kjo pjesë kondenson disa parime kyçe që dalin dhe shqyrtojnë qëllimin e tyre.

Sipas nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, palët shtetërore duhet të garantojnë se “çdokush ka të drejtën e dëgjimit të drejtë dhe publik” dhe se “aktgjykimi shpallet publikisht”. Në përputhje me këtë, Konventa krijon dy koncepte kyçe që synojnë të kontribuojnë në gjykimet e drejta përmes shqyrtimit publik, dmth, Seancave dëgjimore në publik dhe shpalljes publike të aktgjykimeve. Këto parime janë të mishëruara në kuadrin ligjor të Republikës së Shqipërisë, në Kodet e Procedurës Penale dhe atë Civile dhe Administrative.³⁰ Pavarësisht këtyre parashikimeve, në vitet e fundit, me një vendim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjyqësori shqiptar ka bërë disa hapa mbrapa për sa i përket aksesit në vendime të gjykatave të ndryshme dhe transparencës së gjyqësorit, kjo për të mbrojtur privatësinë e palëve në proces.³¹

²⁸ Neni 6 KEDNJ - E drejta për një proces të rregullt I. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë...

²⁹ Neni 8 KEDNJ - E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare I. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

³⁰ Kodi i Procedurës Penale – Dispozita të Përgjithshme, Neni I e vijues.

Kodi i Procedurës Civile - Pjesa e Parë, Pjesa e Përgjithshme, Titulli I - Parimet Themelore të Procesit Gjyqësor.

Kodi i Procedurave Administrative – Pjesa e Parë, Përkufizime dhe parime të përgjithshme.

³¹ Udhëzimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 15, datë 23.12.2011, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.

i. Dëgjesa publike para gjykatave kombëtare

Gjykata Evropiane ka konsideruar, në lidhje me mosmbajtjen e dëgjesave publike në procedurat disiplinore përpara Këshillit Kombëtar të Shoqatës Mjekësore, në rastin Diennet kundër Francës, që “mbajtja e seancave gjyqësore në publik përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin I të Neni 6”.³² Ky parim nënkupton mbajtjen e seancave publike para një gjykate përkatëse.

Megjithatë, Konventa nuk e njeh këtë parim si absolut. Së pari, Gjykata pranon që kjo kërkesë duhet të interpretohet duke pasur parasysh “veçoritë e procedurës të shqyrtuara si tërësi”³³ dhe gjithashtu rrethanat e rastit. Për shembull, në rastin Martinie kundër Francës, ku kërkuesi nuk kishte qenë në gjendje të kërkonte një seancë dëgjimore para Gjykatës Franceze të Auditimit sepse “ligji nuk u dha palëve mundësinë për të paraqitur një kërkesë të tillë, qoftë në shkallë të parë para zyrës rajonale të auditimit ose në ankesë pranë Gjykatës së Auditimit”, Gjykata kujtoi se “regjistrimi e procedurave, qoftë tërësisht ose pjesërisht, në aparat fotografik duhet të përcaktohet rreptësisht nga rrethanat e rastit”. Në këtë rast, Gjykata përsëriti se “rrethanat e jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me natyrën e çështjeve që duhet të vendosen nga gjykata në procedurën në fjalë mund të justifikojnë mbajtjen e dëgjesës publike”.³⁴

Më e rëndësishmja, natyra publike e seancave dëgjimore është subjekt i përjashtimeve të parashikuara shprehimisht në Nenin 6.1 të Konventës. Ky nen parashikon që “shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha ose një pjesë e gjykimit në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve e kërkojnë, ose në masën që është rreptësisht e nevojshme sipas mendimit të Gjykatës Evropiane, në rrethana të veçanta ku publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë”.

Në disa raste, Gjykatës i është dashur të vlerësojë nëse një situatë ishte brenda fushëveprimit të kufizimeve të parashikuara në Konventë. Për shembull, në rastin P dhe B kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata pranoi mungesën e dëgjesave publike në procedurat e kujdestarisë së fëmijëve.

³² Çështja Diennet k. Francës (Shkelje e nenit 6.1 (publikisht), 26 shtator 1995, § 33, ECtHR

³³ Çështja Axen k. Gjermanisë, nr 8273/78, 8 dhjetor 1983, § 28, ECtHR

³⁴ Çështja Martinie k. Francës [GC] - 58675/00, 12 prill 2006, ECtHR

Gjykata konsideroi se “*procedura të tilla janë shembuj parësorë të rasteve kur përjashtimi i shtypit dhe i publikut mund të justifikohet për të mbrojtur privatësinë e fëmijës dhe të palëve, dhe për të shmangur dëmtimin e interesave të drejtësisë*”.³⁵

Gjithashtu, në të njëjtin rast, Gjykata rikujtoi se, edhe në një kontekst të ligjit penal, “*mund të jetë e nevojshme sipas nenit 6 të kufizohet natyra e hapur dhe publike e procedurave, për shembull, për të mbrojtur sigurinë ose privatësinë e dëshmitarëve ose për të nxitur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe mendimit në ndjekjen e drejtësisë*”.

ii. *Shpallja publike e aktgjykimeve dhe disponueshmëria e vendimeve gjyqësore*

Formulimi i nenit 6.1 të Konventës sugjeron që aktgjykimi duhet lexuar në gjykatë të hapur. Megjithatë, Gjykata ka vënë në dukje se për të përcaktuar se cilat forma të publicitetit janë në përputhje me këtë kërkesë, ajo do të interpretohet duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe duke iu referuar qëllimit të nenit 6, dmth, për të siguruar një gjykim të drejtë.³⁶

Edhe pse Neni 6.1 nuk përmend asnjë përjashtim nga kjo kërkesë, Gjykata ka të ngjarë të miratojë përjashtime nga dhënia publike e aktgjykimeve që bien në fushën e kufizimeve të aplikuara për dëgjimet publike të parashikuara në Konventë, p.sh. interesin e të miturve. Më tej, parimi i publicitetit të gjykimeve përbën një çështje praktike, që është disponueshmëria e vendimeve gjyqësore për publikun e gjerë. Në këtë aspekt, duket se nuk rezulton nga teksti i Konventës që aktgjykimet të publikohen në një buletin zyrtar. Megjithatë, Gjykata në Sutter kundër Zvicrës,³⁷ njohu rëndësinë e publikimit në koleksionet zyrtare pasi hapi jurisprudencën në shqyrtimin publik në një masë të caktuar. Gjykata theksoi më tej rëndësinë e publikimit të vendimeve të gjykatës “*duke bërë të mundur që publiku të studiojë mënyrën në të cilën gjykatat në përgjithësi i qasen rasteve të tilla dhe parimeve të zbatuara në vendosjen e tyre*” .

³⁵ Çështja P dhe B k. Mbretërisë së Bashkuar, 36337/97 dhe 35974/97, 24 prill 2001, § 38. Për më shumë detaje, shih Voorhoof D., «Rastet e B. dhe P. kundër Mbretërisë së Bashkuar», IRIS 2001-6 / I, Observatori Audiovizual Evropian, 2001,

³⁶ Çështja Pretto dhe të tjerët k. Italisë, 7984/77, 8 dhjetor 1983, §26, shih gjithashtu B dhe P k. MB § 45.

³⁷ Çështja Sutter k. Zvicrës, 8209/78, 22 shkurt 1984, ECtHR.

Vlen të përmendet se në rastin e procedurave penale, parimi 15 i Rekomandimit (2003)13³⁸ thotë që “gazetarët duhet të lejohen, në baza jodiskriminuese, të bëjnë ose të marrin kopje të aktgjykimeve të shpallura publikisht. Ata duhet të kenë mundësinë të shpërndajnë ose të komunikojnë këtë gjykim te publiku”.

iii. E drejta e qasjes në informacion publik

Përveç çështjes së publikimit dhe disponueshmërisë së vendimeve gjyqësore të diskutuara shkurtimisht më lart, vlen t'i kushtohet vëmendje çështjes më të gjerë të qasjes nga publiku dhe media në informacionin që mbahen nga organet publike, të cilat në parim do të përfshijnë informacion të administruar nga autoritetet gjyqësore. Ky kapitull do të imitohet vetëm për sa i përket këtij informacioni, për sa kohë informacioni publik i përgjithshëm do të shqyrtohet më poshtë, në kapitujt e guidave praktike të marrjes së informacionit nga institucionet zyrtare.

Në jurisprudencën e saj të fundit, Gjykata ka miratuar një përkufizim më të gjerë të nocionit të “*lirisë për të marrë informacionin*” dhe, rrjedhimisht, është drejtuar drejt njohjes së një të drejte për qasje në informacion për çështje me interes publik, nga një organ publik.

Një ndër rastet e para ku ky nocion është zgjeruar dhe zhvilluar më tej ka qenë ai i Társasági a Szabadságjogokért kundër Hungarisë.³⁹ Në këtë rast, aplikanti, një organizatë joqeveritare për të drejtat e njeriut, pretendonte se vendimet e gjykatave hungareze që mohonin qasjen në detajet e ankesës së një deputeti në Gjykatën Kushtetuese, përbënin një shkelje të së drejtës së saj për të pasur qasje në informacion me interes publik. Gjykata Evropiane konstatoi se krijimi i një pengese administrative nga ana e autoriteteve për aksesin legjitim të informacionit për një çështje me rëndësi publike përbënte një shkelje të nenit 10 të Konventës.

Më tej, në vitin 2013, në çështjen Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut kundër Serbisë,⁴⁰ ku një organizatë joqeveritare u ankua për refuzimin e

³⁸ Rekomandimi dhe deklarata e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në fushën e mediave dhe shoqërisë së informacionit Rekomandimi Rec (2003)13 i Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare për ofrimin e informacionit përmes mediave në lidhje me procedurat penale.

³⁹ Çështja Szabadságjogokért k. Hungarisë, 70750/14, 30 prill 2019, ECtHR.

⁴⁰ Çështja Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut k. Serbisë, 48315/06, 25 qershor 2013 ECtHR.

Agjencisë së Inteligjencës së Serbisë për të ofruar informacion faktik në lidhje me përdorimin e masave të mbikëqyrjes elektronike, Gjykata konstatoi se kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e OJQ-së për lirinë e shprehjes. Në një këndvështrim interesant, Gjykata vuri në dukje se nocioni i *“lirisë për të marrë informacion”* parashikuar nga Neni 10 i Konventës përfshin *“të drejtën e qasjes në informacionin publik”*.

Paralelisht me këto gjetje dhe standardet e vëna nga Gjykata Evropiane, miratimi i Konventës Evropiane mbi qasjen në dokumentet zyrtare (ETS 205)¹⁴,⁴¹ paraqiti detyrime pozitive për palët shtetërore për të ofruar informacionin relevant për publikun, duke përfshirë këtu një ndër aktorët kryesorë për informimin e publikut, mediat. Miratuar në qershor 2009, kjo Konventë krijon të drejtën për qasje në dokumente zyrtare dhe të drejtën për të kërkuar qasje pa pasur nevojë që kërkuesi të provojë për autoritetin interes të drejtpërdrejtë ligjor me informacionin e kërkuar (neni 4). Megjithatë, ajo pranon kufizimet e mundshme për *“privatësinë dhe interesat e tjera private legjitime”* dhe gjithashtu *“barazinë e palëve në procedurat gjyqësore dhe administrimin të drejtësisë”*. Së fundmi, Konventa nuk bën dallim ndërmjet mediave dhe individëve të tjerë kur bëhet fjalë për ushtrimin e kësaj të drejte për qasje.

Përveç kësaj, shtojca e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të KiE (2003)¹³ përcakton që *“Gazetarët kanë marrë informacion ligjor në kontekst të procedurave të vazhdueshme penale nga autoritetet gjyqësore ose shërbimet policore, ato autoritete dhe shërbimet duhet t’ia vënë në dispozicion një informacion të tillë, pa diskriminim, të gjithë gazetarëve që bëjnë ose kanë bërë të njëjtën kërkesë. (Parimi 4)*

Në këtë kontekst, Gjykata zakonisht kryen një provë proporcionaliteti (*“domosdoshmëri në një shoqëri demokratike”*) për të përcaktuar nëse *“ndërhyrja”* i përgjigjej një *“nevoje sociale të ngutshme”*, qofshin në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për të justifikuar refuzimin e dhënies së informacionit janë relevante dhe të mjaftueshme.

⁴¹ Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare, Tromsø, 18.VI.2009, URL- <https://rm.coe.int/1680084826>

iv. Konventa Evropiane për Qasjen në Dokumente Zyrtare

Në takimin e 1024bis të datës 27 nëntor 2008, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Konventën e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare. Instrumentet ekzistuese janë Rekomandimi i Këshillit (2002)⁴² mbi qasjen në dokumentet zyrtare dhe Rekomandimi R(81)19⁴³ për aksesin në informacion të mbajtur nga autoritetet publike. Ideja që qëndron pas këtyre instrumenteve është se qasja e publikut në informacionin e qeverisë është thelbësor për ushtrimin e të drejtave themelore, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e sektorit publik dhe pjesëmarrjen e informuar të qytetarëve në procesin demokratik.

Konventa nisët nga premisa se të gjitha dokumentet zyrtare janë, në parim, publike dhe duhet të mbahen në kushte të konfidencialitetit vetëm për të mbrojtur të drejtat e tjera dhe interesat legjitime. E drejta e qasjes ka të bëjë kryesisht me dokumentet e autoriteteve publike me funksione administrative: ato përfshijnë administratën lokale, rajonale dhe kombëtare, por edhe legjislativën, gjyqësorin dhe personat juridikë, të paktën sa u përket detyrave të tyre administrative. Organet publike duhet t'i bëjnë dokumentet zyrtare të disponueshme me iniciativën e tyre, për aq kohë sa kjo është në interes të transparencës dhe nxitjes së efikasitetit në sektorin publik, ose nxitjes së pjesëmarrjes së qytetarëve. Shumë akte kombëtare të lirisë së informimit gjithashtu kërkojnë që organet publike të jenë proaktive.

Kjo Konventë njeh katër lloje refuzimi për dhënien e informacionit. Së pari, qasja mund të refuzohet për shkak se kërkesa mbetet shumë e paqartë për të përcaktuar se cilit dokument i referohet (neni 5 (5) i). Së dyti, një kërkesë mund të refuzohet sepse është dukshëm e paarsyeshme (p.sh., kërkesa të mëdha ose të përsëritura në masë, Neni 5 (5) ii). Së treti, qasja e pjesëshme në një dokument mund të refuzohet nëse kërkon një përpjekje të paarsyeshme për të prodhuar një dokument “të pastër” ose nëse dokumenti bëhet mashtrues ose i pakuptimtë për shkak të lëshimeve. Së katërti dhe e

⁴² Rekomandimi Rec (2002) 2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për aksesin në dokumentet zyrtare. (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 21 shkurt 2002, në mbledhjen e 784 të Përfaqësuesve të Ministrave), URL - <https://rm.coe.int/16804c6fcc>

⁴³ Rekomandim nr (81) 19 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për qasjen në informacionet e mbajtura nga autoritetet publike. (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 25 nëntor 1981 në mbledhjen e 340-të të Përfaqësuesve të Ministrave), URL - <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804f7a6e>

fundit, një kërkesë mund të refuzohet për shkak se një ose më shumë nga të drejtat dhe interesat kundërbalancuese të Nenit. 3 (3) janë në rrezik.

Konventa rendit dymbëdhjetë klasa të gjera të të drejtave dhe interesave të tilla, duke filluar nga siguria kombëtare deri te privatësia, nga interesat komerciale ose të tjera ekonomike (qoftë publike ose private) për sigurinë publike. Këto kategori nuk janë të njëjta me ato të gjetura në, për shembull, Nenin 10 të KEDNJ-së, dhe disa janë fakultative. Por llojet e kufizimit të aksesit duhet të plotësojnë kritere të ngjashme si shkëlja e të drejtave themelore sipas KEDNJ: ato duhet të përcaktohen pikërisht në ligj, të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe të jenë në përpjesëtim me qëllimin e ndjekur.

v. Miratimi i dy teksteve mbi Median dhe Procedurat Penale

Në Evropë, si në kontinentet e tjera, çështja e mbulimit mediatik të procedurave penale është një temë e vazhdueshme e debatit midis atyre që mbështesin lirinë maksimale të informimit për këto procedura dhe atyre që, përkundrazi, besojnë se kjo liri duhet të kufizohet për shkak të të drejtës për t'u konsideruar i pafajshëm, e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për privatësi. Shembuj të shumtë të abuzimeve të llojeve të ndryshme të raportuara në vitet e fundit në vende të ndryshme evropiane, disa prej të cilave kanë pasur pasoja dramatike për palët në këto procedura ose familjet e tyre, dëshmojnë se kjo është një çështje shumë aktuale dhe komplekse.

Pikërisht me këto pyetje dhe shqetësime në mendje Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin Rec (2003) 13⁴⁴ për qeveritë e shteteve anëtare të saj për ofrimin e informacionit përmes mediave në lidhje me procedimet penale. Ky tekst, rezultat i punës prej më shumë se dy vjetësh të Komitetit Drejtues për Mediat Masive (CDMM), liston një numër parimesh që duhen zbatuar nga autoritetet publike (shërbimet policore dhe autoritetet gjyqësore) të përfshira në procedurat penale, për shembull, qasje në sallat e gjyqit dhe gjykimet, në mënyrë që mediat t'ia raportojnë këto procedura publikut, duke respektuar të drejtat e palëve të përfshira.

Rekomandimi është hartuar në dritën e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me Nenet 6 (e drejta për

⁴⁴ Shiko më lart.

gjykim të drejtë), 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 10 (liria e shprehjes dhe informimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo është plotësuar me një Deklaratë⁴⁵ të hartuar për të rikujtuar mediat dhe organizatat profesionale të gazetarisë rreth parimeve të caktuara që duhet të udhëheqin hulumtimet e tyre dhe raportimin e procedurave penale. Këto parime kanë të bëjnë, për shembull, me respektin për dinjitetin, sigurinë dhe të drejtën e privatësisë së viktimave, të dyshuarve, të personave të akuzuar dhe të familjeve të tyre.

b) Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në kontekstin e demokracisë politike efektive dhe respektimit të të drejtave të njeriut të përmendura në Preambulën e Konventës, liria e shprehjes nuk është e rëndësishme vetëm në vetvete, por gjithashtu luan një rol qendror në mbrojtjen e të drejtave të tjera sipas Konventës. Pa një garanci të gjerë të së drejtës së lirisë së shprehjes të mbrojtur nga gjykatat e pavarura dhe të paanshme, nuk ka vend të lirë, nuk ka demokraci. Ky propozim i përgjithshëm është i pamohueshëm.⁴⁶

Liria e shprehjes është një e drejtë në vetvete, si dhe një komponent i të drejtave të tjera të mbrojtura sipas Konventës, të tilla si liria e mbledhjes. Në të njëjtën kohë, liria e shprehjes mund të bjerë në kundërshtim me të drejtat e tjera të mbrojtura nga Konventa, të tilla si e drejta për gjykim të drejtë, respektimi i jetës private, liria e ndërgjegjes dhe e fesë. Kur ndodh një konflikt i tillë, Gjykata vendos një ekuilibër me qëllim që të vendosë përparësinë e një të drejte mbi tjetrën. Bilanci i interesave kontradiktore, njëra prej të cilave është liria e shprehjes, merr parasysh rëndësinë e tjetrës.

Gjykata ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se liria e shprehjes përbën një nga themelet kryesore të një shoqërie demokratike, një nga kushtet themelore për përparimin e saj dhe për vetëpërmbushjen e secilit individ.⁴⁷

⁴⁵ Deklarata mbi dhënien e informacionit përmes mediave në lidhje me procedurat penale (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 10 korrik 2003 në mbledhjen e 848-të të Përfaqësuesve të Ministrave.

⁴⁶ Jochen Abr. Frowein, "Liria e shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", në *Monitor / Inf* (97) 3, Këshilli i Evropës.

⁴⁷ Shiko çështjet Lingens kundër Austrisë, 1986, Sener kundër Turqisë, 2000 Thoma kundër Luksemburgut, 2001, Maronek kundër Sllovakisë, 2001, Dichand dhe të tjerët kundër Austrisë, 2002, etj.

Procesi demokratik politik dhe zhvillimi i çdo qenieje njerëzore janë mundësi për të cilat mbrojtja e lirisë së shprehjes është thelbësore. Si parim, mbrojtja e dhënë nga Neni 10 shtrihet në çdo shprehje pavarësisht nga përmbajtja e saj, e shpërndarë nga çdo individ, grup ose lloj media. I vetmi kufizim i zbatuar është kufizimi i shpërndarjes së ideve që promovojnë racizmin dhe ideologjinë naziste dhe nxisin urrejtjen dhe diskriminimin racial.

Shtetet janë të detyruara të justifikojnë çdo ndërhyrje në çdo lloj shprehjeje. Për të vendosur masën në të cilën duhet mbrojtur një formë e shprehjes, Gjykata shqyrton llojin e shprehjes (politike, tregtare, artistike, etj.), mjetet me të cilat shpërndahet shprehja (personale, media e shkruar, televizioni, etj.), dhe audienca e saj (të rriturit, fëmijët, të gjithë publikun, një grup i veçantë). Edhe “e vërteta” e shprehjes ka një rëndësi të ndryshme sipas këtyre kriterëve. Në marrjen e vendimeve të saj, Gjykata në Strasburg u ka kushtuar vëmendje praktikave kushtetuese kombëtare, duke përfshirë praktikën kushtetuese të Shteteve të Bashkuara, që i siguron mbrojtje të fortë lirisë së shprehjes. Në disa raste, Komisioni⁴⁸ dhe Gjykata i janë referuar Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ose dokumenteve të tjera ndërkombëtare që mbrojnë lirinë e shprehjes. Neni 10 i Konventës është i strukturuar në dy paragrafë. Paragrafi i parë përcakton liritë e mbrojtura. I dyti përcakton rrethanat në të cilat një shtet mund të ndërhyjë në mënyrë legjitime me ushtrimin e lirisë së shprehjes.

i. *Liria e shtypit*

Megjithëse Neni 10 nuk përmend shprehimisht lirinë e shtypit, Gjykata ka zhvilluar një jurisprudencë të gjerë që siguron një grup parimesh dhe rregullash që i japin shtypit një status të veçantë për ushtrimin e lirive që përmban Neni 10. Prandaj ne mendojmë se liria e shtypit meriton komente shitesë në kuadrin e nenit 10. Një argument tjetër për një trajtim të veçantë të lirisë së shtypit është dhënë nga praktikatat kombëtare: në masë të madhe,

⁴⁸ Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut (i krijuar në vitin 1954) është prekursori i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut aktuale. Përpara reformës së implementuar përmes hyrjes në fuqi të Protokollit II të Konventës, ankesat kundër shteteve fillimisht ishin subjekt i një shqyrtimi paraprak nga Komisioni, i cili përcaktonte pranueshmërinë e tyre. Kur një kërkesë deklarohet e pranueshme, Komisioni vendoset në dispozicion të palëve me qëllim ndërmjetësimin për një zgjidhje miqësore. Në rast të pamundësisë së arritjes së një kompromisi, ai hartonte një raport që vërtetonte faktet dhe shprehte një mendim për meritat e çështjes.

viktimat e shkeljes së të drejtës për lirinë e shprehjes nga autoritetet publike janë gazetarë dhe jo individë të tjerë.

Roli i shtypit si vëzhgues politik u theksua së pari nga Gjykata në çështjen *Lingens*.⁴⁹ Në artikujt e gazetave, gazetari kishte kritikuar Kancelarin Federal të Austrisë për një lëvizje të veçantë politike, që përbënte shpalljen e një koalicioni me një parti të udhëhequr nga një person me prirje naziste. Gazetari (*Z. Lingens*) i ishte referuar sjelljes së Kancelarit si “imoral”, “i paditur”, duke demonstruar “oportunizmin më të ulët”.

Pas një padie civile të ngritur nga Kancelari, gjykatat austriake i gjetën këto deklarata si shpifëse dhe vendosën një gjobë për gazetarin. Ndërsa debatohej për çështjen e fajësisë, gjykatat gjithashtu gjetën se gazetari nuk mund të vërtetonte të vërtetën e pretendimeve të tij. Gjykata Evropiane konstatoi se qasja e gjykatave kombëtare ishte e gabuar, pasi opinionet (gjykimet e vlerësimit) nuk mund të demonstrohen dhe nuk janë të pranueshme për t’u faktuar. Duke parë bazën e dënimit të gazetarit Gjykata theksoi rëndësinë e lirisë së shtypit në debatin politik.

Në të njëjtin vendim, Gjykata argumentoi se liria e shtypit i siguron publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe formuar një mendim për idetë dhe qëndrimet e udhëheqësve politikë dhe rrjedhimisht, lirinë e debatit politik, si themeli i një shoqërie demokratike.

Liria e shtypit gëzon gjithashtu një status të veçantë kur çështjet e tjera të interesit publik janë në rrezik. Në çështjen *Thorgeirson*,⁵⁰ aplikanti (*Z. Thorgeirson*) kishte bërë akuza në shtyp kundër brutalitetit të përhapur të policisë në Islandë. Ai iu referua oficerëve të policisë si “kafshë në uniformë” dhe “individë të reduktuar në një moshë mendore të një fëmije, si rezultat i metodave të dhunshme që policët dhe “truprojat” mësojnë dhe përdorin me spontanitet brutal” dhe përshkruan forcën policore që mbron veten nga “ngacmimi, falsifikimi, veprimet e paligjshme, besëtytnitë, veprimet e nxituara dhe paaftësia”.

Në nivelin vendas, *Thorgeirson* u ndoq penalisht dhe u gjobit për shpifje. Gjykata Evropiane gjeti se ankuesi ngriti çështjen e brutalitetit të policisë në vendin e tij dhe se ... është detyrë e shtypit për të dhënë informacion dhe

⁴⁹ Çështja *Lingens* k. Austrisë, 9815/82, 8 korrik 1986, ECtHR.

⁵⁰ Çështja *Thorgeir Thorgeirson* k. Islandës, 13778/88, 25 qershor 1992, ECtHR.

ide për çështje me interes publik. Gjykata më tej tha se nuk ka asnjë arsye të përcaktuar në jurisprudencën e saj për të bërë dallimin... mes diskutimeve politike dhe diskutimit të çështjeve të tjera me interes publik, dhe se vendime të tilla që penalizojnë gazetarët në zhvillimin e punës së tyre, pengojnë dhe kufizojnë mundësinë e ngritjes së debateve mbi çështje të interesit publik.

Nga sa më sipër është tejet e qartë që Gjykata siguron lirinë e shtypit me një mbrojtje të fortë kur çështjet e interesit publik, përveç atyre politike, debatohen publikisht.

ii. *Publiciteti paragjykses-Ndikimi i mediave në vendimet gjyqësore: prezumimi i pafajësisë dhe influencimi i gjyqësorit*

Media konsiderohet si një nga shtyllat e demokracisë. Ajo luan një rol jetësor në formimin e mendimit të shoqërisë dhe është në gjendje të ndryshojë pikëpamjen e plotë përmes së cilës publiku percepton ngjarje të ndryshme. Në një strukturë demokratike duhet të ketë pjesëmarrje aktive të njerëzve në të gjitha çështjet e komunitetit dhe shtetit. Është e drejta e tyre të mbahen të informuar për jetën aktuale politike shoqërore, ekonomike dhe kulturore, si dhe çështjet e rëndësishme të ditës në mënyrë që t'u mundësohet atyre të marrin në konsideratë formimin e mendimit të gjerë mbi bazë të të cilit po trajtohen dhe administrohen nga qeveria dhe funksionarët e tyre. Për të arritur këtë objektiv, qytetarët kanë nevojë për një parashtrim të qartë dhe të sigurtë të ngjarjeve, në mënyrë që ata të mund të formojnë mendimin e tyre dhe të ofrojnë komentet dhe pikëpamjet e tyre për çështje të tilla, si dhe të zgjedhin rrugët si të veprojnë në të ardhmen.

Në këto kushte, media luan një rol kryesor, një detyrim, por dhe e drejtë legjitime për të qenë transmetues i informacionit të qytetari, pa ndërhyrje nga palë të treta. Ky rol dhe kjo e drejtë shpesh, dhe sidomos në çështje të ndërthurura me drejtësinë, me rolin dhe funksionet e gjyqësorit, vendos në balancë të drejtën e informimit të publikut me të drejtën e privatësisë dhe të drejta të tjera të individit të lidhura me procesin ligjor pranë institucioneve të drejtësisë.

Këtu duhet të kemi parasysh se gjyqtarët, në një kuptim të gjerë, janë të hapur ndaj ndikimit të mediave si çdo njeri tjetër, por betimi dhe trajnimi gjyqësor i bëjnë ata të vetëdijshëm për detyrimin e tyre për të lënë mënjanë mendimet personale kur marrin çështjet në shqyrtim. Ky detyrim zbatohet

në mënyrë të barabartë ndaj opinioneve që ata kanë parë të shprehura në media, jo vetëm për shkak se çështje të tilla janë ligjërisht të parëndësishme, por për shkak se ato janë pothuajse të pandryshueshme në bazë të një njohurie jo të plotë dhe të papërshtatshme të fakteve.

Pyetja “A ndikojnë mediat te gjyqtarët?” është një pyetje shumë e gjerë për të merituar trajtim të përciptë. Çfarëdo që mund të ketë qenë pozicioni në të kaluarën, gjyqtari modern - në çfarëdo niveli - është një anëtar inteligjent, i interesuar dhe i informuar i shoqërisë, i cili lexon gazetat dhe shikon televizionin si çdo njeri tjetër, në mënyrë që, në një kuptim të gjerë, njohuritë e tij për gjendjen njerëzore dhe atë që po ndodh në botë janë të ndikueshme nga media, siç ndodh me gjithkënd tjetër.

Pyetja “A ndikojnë mediat te gjyqtarët?”, duhet parë në kuptim të parë drejtuar çështjes nëse vendimet e gjyqtarëve në mënyrë të vetëdijshme apo jo, ndikohen nga pikëpamjet e komentuesve të medias, dhe në veçanti nëse këto vendime mund të jenë të motivuara nga shqetësimi i gjyqtarit që vendimet e tij apo të saj mund të lavdërohen ose sulmohen në media. Gjykatësit, të cilët janë krijesa njerëzore, pa dyshim janë të kënaqur nëse vendimet e tyre janë subjekt i miratimit, shprehur publikisht. Po kështu, ata mund të ndihen të frustruar, madje edhe të ofenduar, nëse vendimet e tyre kritikohen (sidomos kur kritika bazohet në njohuri jo të plota ose në keqkuptim të fakteve dhe çështjeve).

Por, duke u zhvendosur nga përgjithësimet te rastet e veçanta, tema e ndikimit të medias mund të trajtohet më së miri duke nxjerrë në pah dy dallime: së pari, midis ligjit që zbatohet në gjykatat penale dhe vendimeve të gjyqtarëve në gjykatat civile; së dyti, ndërmjet të drejtës materiale siç zbatohet në raste individuale dhe në një front më të gjerë, procedurave të ndjekura, duke përfshirë, në veçanti, dëgjimin e çështjeve në gjykatë të hapur. Sa i përket ligjit penal, mund të thuhet me besim se, kur vendos nëse është provuar apo jo fajësia e një të pandehuri, asnjë gjyqtar ose magjistrat nuk vendos bazuar në influencat e publikut apo medias. Baza e vetme e verdiktit janë dhe do të mbeten faktet individuale të çështjes dhe elementët përbërës të vërtetimit të fajësisë së të pandehurit. Raste të përfolura për influencë nga ana e medias në vendimmarrjen penale të gjyqësorit shqiptar nuk ekzistojnë.

Për sa i përket fushës së vendimeve civile, përsëri ndoshta është me vend të bëhet dallimi ndërmjet dy kategorive çështjesh. E para mund të konsiderohet

si puna e zakonshme e përditshme e gjykatave civile, si në shkallë të parë ashtu edhe në apel, në fushën e kontratave dhe mosmarrëveshjeve të korporatave, rasteve të aksidenteve industriale dhe rasteve të punësimit në të cilat ligji është i qartë dhe interesi i shtypit lidhet vetëm me ato raste ku përfshihen individë të famshëm, faktet janë veçanërisht sensacionale ose të pazakonshme ose shpërblimi i dëmeve të dhëna nga gjykata krahasohet në mënyrë të pafavorshme me nivelin e shpërblimit të dhënë në një fushë të ndryshme të ligjit ose për shkak të ndonjë kufizimi ligjor (krahasim i gabuar i çështjeve të pangjashme). Përsëri, në raste të tilla, mund të thuhet me plotësi se gjyqësori është tërësisht i pandikuar nga opinioni publik.

Nga ana tjetër, ka raste që ngrenë pika interesante dhe më herët të pavendosura të cilat mund të mos tërheqin vëmendjen e shtypit në shkallën e parë, por ta bëjnë këtë ndërsa vazhdojnë në apel. Kjo ndodh zakonisht ku çështjet përfshijnë pyetje mbi “të drejtat e njeriut”, një temë që frymëzon emocione të ndryshme. Gjithashtu, sigurisht interes i lartë vërehet në rastet kur të drejtat ose interesat e vetë shtypit ndikohen negativisht, sidomos në shtrirjen e kohëve të fundit të rasteve që përfshijnë të drejtën për privatësi nga ana e personave të famshëm apo funksionarëve publikë dhe detyrën e shtypit kundrejt lexuesit. Por shembuj të tjerë që mund të ngjallin interes të shtuar në media, që mund të çojë dhe në një influencim të ndërgjegjshëm ose jo të gjyqësorit në vendimmarrjen e tij janë dhe rastet që përfshijnë çështje të vështira morale dhe etike.

Rastet kur gjyqësori në vendimmarrjen e tij është ndikuar nga opinioni publik dhe media në veçanti janë tejet të pakta, për të mos thënë inekzistente, ose të paraportuara. Më poshtë do të shohim një numër rastesh në juridiksionin evropian, në të cilat influenca e medias mbi gjyqësorin ka shkaktuar probleme për nëpunësit e drejtësisë, aktorët e ndryshëm apo dhe vetë palët në proceset e ndryshme gjyqësore.

iii. *Prezumimi i pafajësisë*

Sipas KEDNJ-së, prezumimi i pafajësisë është një element themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë. Neni 6.2 i KEDNJ thekson se “*kushdo që akuzohet për një vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajtor sipas ligjit*”. Prandaj, raportimi mbi procedurat penale në vazhdim nuk duhet të paragjykojë këtë të drejtë themelore të të dyshuarit ose të akuzuarit. Parimi 2 i Rekomandimit Rec (2003) 13 përfshin gjithashtu një

kërkesë të tillë. Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë është një pjesë integrale e së drejtës për një gjykim të drejtë. Prandaj, mendimet dhe informatat në lidhje me procedurat e vazhdueshme penale duhet të komunikohen ose shpërndahen vetëm përmes mediave, nëse kjo nuk paragjykon prezumimin e pafajësisë së të dyshuarit ose të akuzuarit”.

Për shembull, në *Du Roy dhe Malaurie kundër Francës*,⁵¹ Gjykata vuri në pah se “gazetarët që raportojnë për procedurat penale që zhvillohen në atë moment, duhet pa dyshim të sigurojnë që ata të mos kalojnë kufijtë e vendosur në interes të administrimit të duhur të drejtësisë dhe të respektojnë të drejtën e të akuzuarit për t’u konsideruar i pafajshëm”.

Për më tepër, në *Tourancheau dhe July kundër Francës*,⁵² ankuesit (gazetarët) ishin dënuar nga gjykatat kombëtare pasi kishin botuar një artikull që riprodhonte ekstrakte nga deklaratat e bëra në kontekstin e një hetimi penal përpara mbajtjes së seancës gjyqësore. Gjykatat kombëtare kishin theksuar në veçanti pasojat e dëmshme të publikimit të nenit për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të dy të dyshuarve të rinj dhe për të drejtën e tyre për t’u konsideruar i pafajshëm. Prandaj, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të të drejtës së gazetarëve për liri të fjalës dhe transmetimit të informacionit.

iv. Mbrojtja e privatësisë

Në *Egeland dhe Hanseid kundër Norvegjisë*,⁵³ Gjykata vlerësoi kufizimet mbi publikimin nga shtypi të fotografive që iu bënë një prej të akuzuarve në një rast të njohur penal në Norvegji pa pëlqimin e tij, teksa largohej nga ambientet e gjykatës, pasi kishte marrë pjesë në shpalljen e vendimit të kësaj të fundit. Gjykata Evropiane konstatoi se sipas KEDNJ-së “duke ndaluar marrjen dhe publikimin e fotografive të B në rrugën nga ndërtesa e gjykatës në një makinë të policisë në pritje, Shteti përgjegjës veprroi brenda hapësirës së vlerësimit të tij në vlerësimin e nevojës për të mbrojtur privatësinë e të pandehurës dhe të administrimit të drejtë të drejtësisë. [Gjykata] është e bindur se kufizimet mbi të drejtën e redaksive për lirinë e shprehjes [...], u mbështetën në arsye të cilat ishin relevante dhe të mjaftueshme dhe ishin proporcionale me qëllimet legjitime të zbatuara”.

⁵¹ Çështja *Du Roy dhe Malaurie k. Francës*, 34000/96, 3 janar 2001, ECtHR.

⁵² Çështja *Tourancheau dhe July kundër Francës*, 53886/00, 24 nëntor 2005, ECtHR.

⁵³ Çështja *Egeland dhe Hanseid kundër Norvegjisë*, 34438/04, 16 korrik 2009, ECtHR.

Mbrojtja e privatësisë në kontekstin e procedurave penale në vazhdimësi është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i mbuluar nga Rekomandimi i mësipërm, i cili thekson se “dhënia e informacionit për të dyshuarit, të akuzuarit, personat e dënuar ose palët e tjera në procedimet penale duhet të respektojë të drejtën e tyre për mbrojtjen e privatësisë në përputhje me nenin 8 të Konventës. “*Theks i veçantë i vihet nevojës për mbrojtje të palëve që janë të mitur ose persona të pambrojtur, si dhe viktimave dhe familjeve të tyre* (Parimi 8).

c) **Influencimi i gjyqësorit nga media**

Një ndër vendimet më të njohura të Gjykatës Evropiane mbi ndikimin e medias në rezultatin e një procesi gjyqësor është ai Abdulla Ali kundër Mbretërisë së Bashkuar,⁵⁴ në të cilin kërkuesi, z. Abdulla Ahmed Ali, një shtetas britanik, i cili ankohej pranë GJEDNJ-së se për shkak të mbulimit të gjerë nga ana e mediave në një këndvështrim negativ të procedimeve penale kundër tij për komplot terrorist për të shkaktuar shpërthime në avionë me anë të bombave të lëngshme, vendimet pasardhëse të gjykatave kishin qenë të ndikuara nga kjo e fundit dhe ishin të padrejta.

Pas një gjyqi të parë në rastin e zotit Ali, i cili kishte rezultuar në dënimin e tij për një akuzë për konspiracion për vrasje, kishte pasur mbulim të gjerë mediatik, duke përfshirë raportimin mbi fakte që asnjëherë nuk ishin paraqitur para jurisë dënuese. Një rigjykim u urdhërua më pas lidhur me akuzën më specifike të konspiracionit për vrasje me anë të shpërthimit të mjeteve eksplozive në avionin që ishte në fluturim (mbi të cilin juria në gjyqin e parë nuk ishte në gjendje të merrte një vendim unanim) dhe Ali argumentoi se ishte e pamundur që rigjykimi të ishte i drejtë, duke pasur parasysh ndikimin e publicitetit negativ. Argumenti i tij u refuzua nga gjyqtari në rigjykim, dhe ai u dënua në rigjykim nga burgim i përjetshëm në dënim minimal prej 40 vjetësh.

Në shqyrtimin e kërkuarit pranë GJEDNJ-së, kjo e fundit shqyrtoi një numër elementesh të nevojshme për të gjykuar nëse mbulimi mediatik i fakteve të çështjes së tij kishin pasur një impakt në jurinë dhe gjyqtarin e çështjes. Gjykata kujtoi se ishte e rrallë që publiciteti para gjyqimit të bënte

⁵⁴ Çështja Abdulla Ali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 30971/12, 30 qershor 2015, ECtHR.

të pamundur që aplikanti të gjykohej drejt në të ardhmen, në përgjithësi mjafton që të ketë një periudhë të përshtatshme kohe ndërmjet komenteve paragjyquese në media dhe procedurave pasuese penale, së bashku me udhëzimet e përshtatshme për jurinë. Së pari, Gjykata shqyrtoi kuadrin ligjor në fuqi për të siguruar një gjykim të drejtë në rast të një publiciteti negativ dhe gjeti se kuadri ligjor anglez ofronte udhëzimet e përshtatshme, gjë që i mundësoi gjykatësit të ndërmarrë hapa të ndryshme gjatë procesit gjyqësor për të siguruar drejtësinë e gjykimit.

Gjykata pranoi se materiali i botuar në këtë rast ishte dëmtues ndaj z. Ali dhe vazhdoi të shqyrtojë nëse hapat e marra nga gjyqtari i rigjykimit ishin të mjaftueshme për të siguruar drejtësinë në rigjykimin e tij. Gjykata ishte e bindur se gjyqtari kishte pasur kujdes të nënvizonte rëndësinë e paanshmërisë gjatë përzgjedhjes së jurisë dhe se, sapo ishte zgjedhur juria, ai kishte dhënë udhëzime të qarta, gjatë gjithë gjyqit, gjatë mbledhjes së tij dhe çdo mbrëmje pasi juria ishte mbledhur për të vendosur mbi verdiktin. Z. Ali nuk ka kundërshtuar përzgjedhjen e anëtarëve të jurisë apo përmbajtjen e udhëzimeve gjyqësore.

Gjykata gjithashtu ishte e kënaqur me arsyet e dhëna nga gjyqtari në rigjykim për refuzimin e kërkesës për një qëndrim në procedurë dhe nga Gjykata e Apelit për hedhjen poshtë të ankesës. Ajo vuri në dukje se kur filloi publikimi i materialit paragjyques, vendimi për të vazhduar rigjykimin nuk ishte dhënë ende. Çdo anëtar i publikut që ishte njohur me raportet nuk kishte dijeni në atë kohë se ata do të përfshiheshin në rigjykimin pasues. Gjyqtari i procedurës kishte shqyrtuar nëse kishte kaluar kohë e mjaftueshme për të lejuar që raportet të humbitnin vlerën dhe të binin në harresë, duke shqyrtuar me kujdes përmbajtjen e çdo rasti të raportimit në të cilin ishte tërhequr vëmendja e tij dhe kishte njohur nevojën për drejtime të kujdesshme të jurisë.

Nuk kishte asgjë në rrethanat e rastit që të sugjeronte se juria nuk mund të mbështetej në ndjekjen e udhëzimeve të gjyqtarit për të gjykuar çështjen vetëm mbi provat e dëguara në gjykatë. Fakti që juria më pas dha gjykime të diferencuara në lidhje me të pandehurit e shumëfishtë në procedurën e rigjykimit, mbështeti përfundimin e gjyqtarit se juria mund të dallonte dhe të shpërfillte raportet e mëparshme të medias dhe, si pasojë, të vendoste rastin në mënyrë të drejtë në bazën e provave të shqyrtuara në gjykatë. Gjykata arriti në përfundimin se nuk ishte provuar që mbulimi negativ në media

kishte ndikuar mbi jurinë deri aty sa të dëmtonte rezultatin e procedurës duke e bërë të padrejtë gjykimin e zotit Ali, dhe si pasojë nuk kishte pasur shkelje të të drejtave të tij.

d) Liria e shprehjes dhe autoriteti e paanshmëria e gjyqësorit

Jurisprudenca e Gjykatës sipas këtij kreu tregon se ndonëse drejtësia gëzon një mbrojtje të veçantë, ajo nuk funksionon në vakum dhe pyetjet rreth administrimit të drejtësisë mund të jenë pjesë e debatit publik.

Në çështjen *Sunday Times*,⁵⁵ qeveria justifikoi urdhrat kundër botimit të një artikulli gazete nisur nga interesi për të mbrojtur paanshmërinë e gjyqësorit dhe ruajtjen e besimit të publikut në autoritetet gjyqësore. Pas përdorimit të “thalidomidit”, qetësues, ndërmjet viteve 1959 dhe 1962, shumë fëmijë lindën me keqformime të rënda. Droga është prodhuar dhe shitur nga *Distillers Company Ltd*, e cila e tërhoqi atë nga tregu në vitin 1961. Prindërit paditën kompaninë, duke kërkuar dëmet civile; negociatat midis palëve vazhduan për shumë vite. Transaksionet e palëve duhet të miratoheshin nga gjykatat. Të gjitha gazetat, përfshirë *The Sunday Times*, e mbuluan këtë çështje gjerësisht. Në vitin 1971, palët filluan negociatat për të ngritur një fond bamirësie për fëmijët me keqformime. Në shtator të vitit 1972 *The Sunday Times* botoi një artikull me titull “*Fëmijët tanë thalidide: një shkak për turp kombëtar*”, duke kritikuar kompaninë për shumën e reduktuar të parave të paguara për viktimat dhe për shumën e vogël që kompania synonte të vinte në fondin e bamirësisë. *Sunday Times* njoftoi se do të përshkruante, në një artikull të ardhshëm, rrethanat e tragjedisë.

Me kërkesë të kompanisë, Prokurori i Përgjithshëm kërkoi nga gjykata që të lëshonte një urdhëresë kundër gazetës, duke argumentuar se publikimi i artikullit të paralajmëruar do të pengonte drejtësinë. Urdhri u dha dhe *The Sunday Times* u ndalua të botohej. Përpara Gjykatës Evropiane, *The Sunday Times* pretendoi një shkelje të nenit 10. Qeveria e arsyetoi urdhrin me nevojën për të ruajtur “autoritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit”, pasi rastet e thalidomidit ishin ende në shqyrtim nga gjykatat. Gjykata tha se “ka pranim të përgjithshëm të faktit se gjykatat nuk mund të veprojnë në vakum.

⁵⁵ Çështja *Sunday Times* kundër Mbretërisë së Bashkuar, Series A, No. 30, 26 prill 1979, ECtHR.

Përderisa ata janë forumi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kjo nuk do të thotë që nuk mund të ketë diskutime paraprake të mosmarrëveshjeve diku tjetër, qoftë në revista të specializuara, në shtypin e përgjithshëm apo në mesin e publikut në përgjithësi. Për më tepër, ndërsa mediat masive nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e vendosur në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, është detyrë e tyre që të japin informacion dhe ide në lidhje me çështjet që vijnë përpara gjykatave ashtu si në fushat e tjera me interes publik. Jo vetëm që mediat kanë detyrën e dhënies së informacionit dhe ideve të tilla, publiku gjithashtu ka të drejtë t'i pranojë ato”.

Në rrethanat e veçanta të rastit, Gjykata vërejtë se “fatkeqësia e talidomidës” ishte një çështje e shqetësimit të padiskutueshëm publik. Përveç kësaj, familjet e përfshira në tragjedi dhe publiku në përgjithësi kishin të drejtë të informoheshin për të gjitha faktet e kësaj çështjeje. Gjykata arriti në përfundimin se urdhri i dhënë kundër gazetës “nuk korrespondonte me një nevojë sociale mjaft të ngutshme për të tejkaluar interesin publik në lirinë e shprehjes brenda kuptimit të Konventës”.

Në rastin e De Haes dhe Gijssels,⁵⁶ aplikantët, dy gazetarë, raportuan mbi një çështje të pazgjidhur nga gjykata. Në pesë artikuj, ata kritikuan ashpër gjyqtarët e një gjykate apeli, të cilët kishin vendosur në rastin e divorcit që dy fëmijët e familjes së divorcuar të jetonin me babanë e tyre. Babai, një noter i njohur, më parë ishte akuzuar nga ish-bashkëshortja e tij dhe prindërit e saj për abuzimin seksual të dy fëmijëve. Në kohën e divorcit, hetimi kundër noterit u mbyll pa aktakuzë.

Tre gjyqtarë dhe një prokuror paditën dy gazetarët dhe gazetën, duke kërkuar dëmshpërblim civil për deklarata shpifëse. Gjykatat civile gjetën se të dy gazetarët kishin hedhur dyshime të forta mbi paanësinë e gjyqtarëve duke shkruar se ata kishin vendosur qëllimisht gabimisht për shkak të marrëdhënieve të tyre të ngushta politike me noterin. Gazetarët u detyruan të paguajnë dëmet civile (një shumë simbolike) dhe të publikojnë gjykimin në gjashtë gazeta me shpenzimet e tyre.

Gjykata ka pranuar se anëtarët e gjyqësorit duhet të gëzojnë besimin e publikut dhe prandaj ata duhet të mbrohen nga sulmet shkatërruese pa ndonjë bazë faktike. Për më tepër, nisur nga fakti që ata kanë detyrë gjykimin,

⁵⁶ Çështja De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës, 7/1996/626/809, 24 shkurt 1997, ECtHR.

gyqtarët nuk mund t'i përgjigjen publikisht sulmeve të ndryshme, siç për shembull e kanë këtë mundësi politikanët. Gjykata më pas shqyrtoi artikujt dhe vuri në dukje se ishin dhënë shumë detaje, duke përfshirë mendimet e ekspertëve, duke dëshmuar se gazetarët kishin kryer kërkime serioze përpara se të informonin publikun për këtë rast. Artikujt ishin pjesë e një debati të madh publik mbi incestin dhe mënyrën se si drejtësia e trajtoi atë. Duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës së publikut për t'u informuar për një çështje me interes publik, Gjykata vendosi që vendimi i gjykatave kombëtare nuk ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike” dhe se për këtë arsye ishte shkelur Neni 10.

Në parim, shpifja kundër një gjyqtari nga shtypi bëhet si pjesë e një debati për mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose në kontekstin e dyshimit të pavarësisë apo paanësisë së gjyqtarëve. Çështje të tilla janë gjithmonë të rëndësishme për publikun dhe nuk duhen lënë jashtë debatit publik, veçanërisht në një vend që përjeton kalimin në një gjyqësor të pavarur dhe efektiv. Kjo është arsyeja pse gjykatat kombëtare duhet të çmojnë vlerat dhe interesat e përfshira në rastin kur gjyqtarët ose aktorët e tjerë gjyqësorë kritikohen. Gjykatat duhet të balancojnë nderin e gjyqtarit në fjalë kundër lirisë së shtypit për të raportuar për çështje me interes publik dhe për të vendosur përparësinë në një shoqëri demokratike.

Sigurisht, aty ku kritika ka për qëllim kryesisht fyerjen ose shpifjen e anëtarëve të gjyqësorit pa kontribuar në debatin publik mbi administrimin e drejtësisë, mbrojtja e ofruar për lirinë e shprehjes mund të jetë më e ngushtë.

Ndër çështje të tjera të cilat janë me interes për t'u shqyrtuar për sa i përket marrëdhënies së gjyqësorit me median mund të përmendim *Touran Chau dhe July kundër Francës (affaire Libération)*,⁵⁷ *B. dhe P. kundër Mbretërisë së Bashkuar*,⁵⁸ *Canard Enchaîné kundër Francës*,⁵⁹ dhe *T. kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe V. kundër Mbretërisë së Bashkuar*.⁶⁰

⁵⁷ Çështja *Touran Chau dhe July kundër Francës*, 53886/00, 24 nëntor 2005, ECtHR.

⁵⁸ *Shiko më lart.*

⁵⁹ Çështja *Fressoz dhe Roire kundër Francës*, 29183/95, 21 janar 1999, ECtHR.

⁶⁰ *T. dhe V. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 24888/94, 16 dhjetor 1999, ECtHR.

IV

GAZETARIA HULUMTUESE DHE MARRËDHËNIA ME DREJTËSINË: MBROJTJA NDAJ NDËRHYRJES NË PROFESION NË PRAKTIKËN E BASHKIMIT EVROPIAN

Liria e shprehjes dhe e informacionit, së bashku me lirinë e mediave, kontribuojnë ndjeshëm në formimin e opinionit publik, duke u mundësuar njerëzve të bëjnë zgjedhje të informuara në vendimet e tyre politike dhe ekonomike. Për këtë arsye, liria e shprehjes dhe liria e medias janë thelbësore për demokracinë, e cila është një nga vlerat themelore të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare, mbi të cilat themelohet Bashkimi Evropian (neni 2 TEU).⁶¹ Përveç kësaj, në dhënien e informacionit mbi performancën e autoriteteve publike, media gjithashtu luan një rol të rëndësishëm si «mbikëqyrës» i pushtetit publik, për të cilin ato duhet të jenë të lirë nga çdo ndikim dominant politik ose shtetëror.⁶² Liria e medias ka një karakter të dyfishtë. Nga njëra anë ajo ofron njerëz aktivë në gazetari me një të drejtë individuale për të informuar dhe shprehur mendime. Kjo zonë e mbrojtur për punë gazetareske pa ndonjë ndërhyrje të jashtme si një liri negative përbën një liri gazetareske nga diçka ose dikush. Nga ana tjetër, liria e medias i jep kësaj garanci të përshtatshme si një institucion unik në procesin demokratik. Kjo liri pozitive është thelbësore për vetëqeverisjen e gazetarit.⁶³

⁶¹ Neni 2 i Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon që Bashkimi është i bazuar në vlerat e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që i përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave.

⁶² Shiko p.sh., Potcheva, “Press freedom in the EU. Legal framework and challenges”, 2015, URL - <http://www.europarl.europa.eu/EPRS/EPRS-Briefing-554214-Press-freedom-in-the-EU-FINAL.pdf>, faqe. 2.

⁶³ Shiko p.sh., Koltay, “The Meaning of Freedom of the Press”, URL - http://hunmedialaw.org/dokumentum/166/Freedom_of_the_Press_final.pdf, faqe. 2.

Karakterit thelbësor i lirisë së medias për funksionimin demokratik të shoqërisë, çka e bën atë një vlerë themelore kushtetuese, çon në kërkesa shumë të larta para se të vendosen kufizime për lirinë e mediave nga autoritetet publike. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se liria e medias ka prevalencë automatike mbi interesa të tjera konfliktuale, si p.sh. e drejta për privatësi ose mbrojtja e të dhënave. Përkundrazi, çdo interes kontradiktor duhet të jetë i balancuar duke lejuar shpalosjen sa më të madhe të lirisë së medias dhe të drejtave të tjera konfliktuale dhe interesave legjitime, gjithnjë duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias për demokracinë.

Gjithsesi funksioni demokratik i lirisë së medias nuk do të thotë se vetëm botimet që merren me çështjet politike mbrohen me ligj. Përkundrazi, çdo produkt gazetaresk e gëzon këtë mbrojtje, duke përfshirë edhe “shtypin tabloid”. Sidoqoftë, sa më i lartë kontributi i produktit gazetaresk në formimin e opinionit publik për çështje me rëndësi për shoqërinë, aq më e madhe është pesha që i atribuohet lirisë së shtypit përkundrejt interesave të tjera legjitime.⁶⁴ Një debat mbi çështjet e interesit publik në një shoqëri demokratike presupozon ekzistencën e mendimeve të ndryshme që shprehen për opsione të ndryshme konkurruese politike, ndërmjet të cilave qytetarët mund të zgjedhin lirisht. Prandaj liria e medias duhet të karakterizohet nga pluralizmi ideologjik, kulturor, social dhe politik. Sa më pluralist peizazhi i medias dhe sa më të larmishme pikëpamjet që ofrohen në komunikim, aq më i madh është efekti legjitimues i medias në procesin politik. Në këtë drejtim, ndërsa pluralizmi i medias kuptohet si pavarësi e numrit të kompanive mediatike - liria e shtypit lidhet me mungesën e monopolit shtetëror ose medias shtetërore nga kontrolli privat - duke shmangur kështu përqendrimin e medias nën pronësinë e një grupi të vogël interesash.⁶⁵ Përveç lirisë «negative» ose «mbrojtës» kundër ndikimit të shtetit, disa prej të cilave do t'i shikojmë më poshtë, një element thelbësor për lirinë e medias është dhe imponimi i një detyrimi pozitiv ndaj autoriteteve publike për të promovuar dhe garantuar këtë liri, dhe për ta mbrojtur atë nga kufizime të pajustificuara dhe jo proporcionale jo vetëm kundrejt organeve publike, por edhe në marrëdhëniet horizontale midis lojtarëve privatë.

⁶⁴ Potcheva, më lart.

⁶⁵ Shiko Calderaro & Dobрева, “European Union Competences in respect of media pluralism and media Freedom”, RSCAS PP 2013/01, 2013, faqe. 11.

a) Mbrojtja e burimeve të lajmit

Në vendimin e saj të datës 27 mars 1996,⁶⁶ Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me një shumicë prej 11 ndaj 7 anëtarësh, arriti në përfundimin se një urdhër që i kërkonte një gazetari britanik të zbulojë identitetin e burimit të tij dhe gjoba e imponuar për shkak të refuzimit, përbënin shkelje të lirisë së shprehjes dhe informacionit, siç mbrohet me nenin 10 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Në vitin 1990, William Goodwin, një gazetar për “The Engineer”, u gjet fajtor nga Dhoma e Lordëve (UK) për Shpërfillje të Gjykatës, sepse ai nuk pranoi të zbulonte identitetin e një personi (zbulimi i burimit) që më parë i referonte informacione financiare të nxjerra nga një raport konfidencial mbi planet financiare të një kompanie private. Sipas Dhomës së Lordëve, marrja e informacionit për burimin nga kjo gjykatë ishte e domosdoshme, për shkak të mundësisë së dëmtimit të interesave të kompanisë private, nëse informacioni i përfshirë në planin e tyre financiar do të shpërndahej, ndërkohë që negociatat e tyre të rifinancimit ishin ende në vazhdim. Urdhri për dhënien e informacioneve shpjeguese u vlerësua të jetë në përputhje me nenin 10 të Ligjit kundër Shpërfilljes së Gjykatës, të vitit 1981, pasi zbulimi i informacionit nga ana e gazetarit u konsiderua i nevojshëm në interes të drejtësisë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, megjithatë, ishte e mendimit se urdhri i zbulimit i dhënë nga Dhoma e Lordëve ishte në kundërshtim me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithëse urdhri për zbulimin dhe gjoba e imponuar për refuzimin e zbulimit të burimit të tij ishin “*të përcaktuara me ligj*” dhe kishin një qëllim legjitim (“*mbrojtja e të drejtave të të tjerëve*”), ndërhyrja nga gjykatat angleze në lirinë e shprehjes dhe informacionit nuk u konsiderua si e nevojshme në një shoqëri demokratike. Shumica e Gjykatës dhe madje edhe gjyqtarët të cilët dhanë mendim pakice në vendim theksuan me forcë parimin se “*mbrojtja e burimeve të gazetarisë është një nga kushtet themelore për lirinë e shtypit*” dhe se “*pa një mbrojtje të tillë, burimet mund të pengohen nga ndihma e shtypit në informimin e publik për çështje me interes publik*”. Në gjykimin e saj, Gjykata theksoi se pa mbrojtje

⁶⁶ Çështja Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar, 27 mars 1996, Raportime të gjykimeve dhe vendimeve 1996-II.

të burimeve të gazetareve “*roli vital i mbikëqyrjes publike të shtypit mund të dëmtohet dhe aftësia e shtypit për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme mund të ndikohet negativisht*”. Siç vuri në dukje GJEDNJ: “Si shtesë, kufizimet në konfidencialitetin e burimeve gazetareske kërkojnë shqyrtimin më të kujdesshëm nga Gjykata”.

Në dy vendime të vitit 2007, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut më tej nënvizoi rëndësinë e të drejtës së gazetareve për të mos zbuluar e burimet e tyre të informacionit, kjo bazuar në të drejtat e dhëna nga Neni 10 i Konventës. Çështja Voskuil kundër Holandës⁶⁷ kishte në themel akuzat e Z. Voskuil se atij i ishte mohuar e drejta të mos zbulonte burimin e tij për dy artikuj që kishte shkruar për gazetën “Sp!” dhe se ai u ndalua për më shumë se dy javë në një orvatje për ta detyruar atë të bënte një gjë të tillë. Z. Voskuil ishte ftuar të paraqitej si dëshmitar për mbrojtjen në procedurat e ankesave që përfshinin tre persona të akuzuar për trafik armësh. Gjykata urdhëroi gazetarin që të zbulojë identitetin e një burimi, në interes të të akuzuarve dhe integritetit të autoriteteve policore dhe gjyqësore. Z. Voskuil përdori të drejtën e tij për të heshtur (*zwijgrecht*) dhe, më pas, gjykata urdhëroi ndalimin e menjëhershëm të tij.

Në Strasburg, Z. Voskuil u ankua për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit, sipas nenit 10 të Konventës. Gjykata Evropiane kujtoi se mbrojtja e burimeve të gazetareve është një nga kushtet themelore për lirinë e shtypit, siç pasqyrohet në instrumente të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë Rekomandimin e Këshillit të Evropës Nr. R (2000) 7. Pa një mbrojtje të tillë, burimet mund të ngurrojnë t’i vijnë në ndihmë shtypit në informimin e publikut për çështje me interes publik, për rrjedhojë roli i rëndësishëm i mbikëqyrjes publike të shtypit mund të dëmtohet. Urdhri për të zbuluar një burim mund të justifikohet vetëm nga një kërkesë e domosdoshme në interes të publikut. Gjykata gjeti se interesi i qeverisë për të njohur identitetin e burimit të gazetarit nuk ishte i mjaftueshëm për të anashkaluar interesin e gazetareve për ta fshehur atë.

Në çështjen Tillack kundër Belgjikës,⁶⁸ gazetari H.M. Tillack u ankua për një shkelje, nga autoritetet belge, të së drejtës së tij për mbrojtjen e burimeve. Tillack, një gazetar që punonte në Bruksel për revistën javore “Stern”, dyshohej se i kishte dhënë rryshfet prej 8000 euro një nëpunësi civil, në

⁶⁷ Çështja Voskuil kundër Hollandës, 64752/01, nëntor 2007, ECtHR

⁶⁸ Tillack kundër Belgjikës, 20477/05, 27 nëntor 2007, ECtHR.

këmbim të informacionit konfidencial lidhur me hetimet që po zhvilloheshin në institucionet evropiane. Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit, OLAF hapi një hetim për të identifikuar informatorin e Tillack. Pasi hetimi nga OLAF nuk arriti të zbulojë zyrtarin nga i cili rrodhi informacioni, autoritetet gjyqësore belge kërkuan të hapin një hetim për një shkelje të supozuar të besimit profesional dhe ryshfetit që përfshin një nëpunës civil. Më 19 mars 2004, shtëpia dhe vendi i punës i Tillack u kontrolluan dhe pothuajse të gjitha letrat dhe mjetet e tij të punës u konfiskuan dhe u vunë nën sekuestro. GJEDNJ-ja theksoi se e drejta e gazetarit për të mos zbuluar burimet e tij nuk mund të konsiderohej thjesht privilegj, që jepej ose që hiqej në varësi të ligjshmërisë ose paligjshmërisë së burimeve të tyre, por ishte pjesë e së drejtës për informacion dhe duhet të trajtohej me kujdes të madh.

Një forcim i mëtejshëm procedural i mbrojtjes së burimeve konfidenciale është arritur në shqyrtimin e çështjes Sanoma kundër Holandës.⁶⁹ Në këtë vendim të 14 shtatorit 2010, 17 gjyqtarët e Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut arritën njëzëri në përfundimin se urdhri për dorëzimin e CD-ROM me fotografi që zotëronte kryeredaktori i një reviste javore të prokurori publik i Holandës, ishte një shkelje e të drejtave të gazetarëve për të mbrojtur burimet e tyre. Ajo vuri në dukje se urdhrat për të zbuluar burimet potencialisht kishin një ndikim të dëmshëm, jo vetëm për burimin, identiteti i të cilit mund të zbulohej, por edhe për gazetën apo botimin kundër të cilit u ngrit urdhri, reputacioni i të cilës mund të ndikohet negativisht në sytë e publikut apo dhe burimeve potenciale në të ardhmen, të cilët mund të kenë nevojë për mbrojtjen e anonimitetit të tyre. Në thelb, Dhoma e Madhe ishte e mendimit se e drejta për të mbrojtur burimet e gazetarisë duhet të ruhet me garanci të mjaftueshme procedurale, përfshirë garancinë e shqyrtimit paraprak nga një gjyqtar ose një organ vendimmarrës i pavarur dhe i paanshëm, përpara se policia ose prokurori të kenë akses në informata që mund të zbulojnë burime të tilla.

b) E drejta e gazetarëve për të marrë dhe publikuar dokumente konfidenciale

Në një gjykim të vitit 1999, Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së vendosi në favor të mbrojtjes së gazetarëve dhe theksoi rëndësinë e lirisë së shtypit dhe rolin e saj jetësor në një shoqëri demokratike. Rasti ka të bëjë me aspekte

⁶⁹ Sanoma Uitgevers B.V. kundër Holandës [GC], 38224/03, 14 shtator 2010, ECtHR.

të rëndësishme që lidhen me kufijtë e lirisë së gazetarisë në raportimin e çështjeve me interes të përgjithshëm. Aplikantët u dënuan në Francë për botimin e një artikulli në gazetën satirike “Le Canard enchaîné”. Artikulli dhe dokumentet që përmbante treguan se drejtori menaxhues i Peugeot, Z. Calvet kishte pasur një rritje të konsiderueshme page ndërkohë që njëherësh ai refuzoi kërkesat e punëtorëve për rritje page. Z. Fressoz, drejtori i botimeve të revistës në atë kohë dhe Z. Roire, gazetari që shkroi artikullin, u dënuan për marrjen dhe botimin e fotokopjeve të përfuara nëpërmjet një shkeljeje të besimit profesional nga një zyrtar tatimor i paidentifikuar. Të dy ata pohuan se këto dënime shkelin lirinë e tyre të shprehjes, të mbrojtur nga Neni 10 i Konventës Evropiane.

Gjykata theksoi se në parim gazetarët nuk mund të lirohen nga detyra për t’u bindur ligjit të zakonshëm penal, me arsyetimin se Neni 10 u siguron atyre mbrojtjen e lirisë së shprehjes. Sidoqoftë, në rrethana të veçanta interesi i publikut për t’u informuar dhe roli jetësor i shtypit mund të justifikojnë publikimin e dokumenteve që përfshihen në detyrimin e sekretit profesional. Duke marrë parasysh faktin se artikulli ka kontribuar në një debat publik mbi një çështje me interes të përgjithshëm, informacioni mbi pagën e Z. Calvet si kreu i një kompanie të madhe industriale nuk ka të bëjë me jetën e tij private dhe se informacioni ishte tashmë i njohur për një numër të madh njerëzish, Gjykata ishte e mendimit se nuk kishte kërkesa thelbësore për ruajtjen e informacionit si konfidencial. Ishte e vërtetë se bindja bazohej në publikimin e dokumenteve për të cilat ishte ndaluar zbulimi, por informacioni që përmbanin nuk ishte konfidencial.

Gjykata theksoi se në thelb Neni 10 i Konventës “*ja lë në dorë gazetarit që të vendosë nëse është e nevojshme të riprodhohen këto dokumente për të siguruar besueshmërinë. Ai mbron të drejtat e gazetarëve për të zbuluar informacione mbi çështjet e interesit të përgjithshëm me kusht që ata të veprojnë në mirëbesim dhe mbi bazën e saktë të fakteve dhe të ofrojnë informacione “të besueshme dhe të sakta” në përputhje me etikën e gazetarisë*” (paragrafi 54).⁷⁰ Sipas mendimit të Gjykatës, publikimi i informacioneve tatimore ishte i rëndësishëm jo vetëm për çështjen, por edhe për besueshmërinë e informacionit të dhënë, ndërsa njëkohësisht gazetari kishte vepruar në përputhje me standardet që rregullonin profesionin e tij si gazetar. Konkluzioni përfundimtar dhe unanim i Gjykatës, i vendosur në Dhomën e Madhe, ishte që nuk kishte pasur një

⁷⁰ Shiko çështjen FRESSOZ dhe Roire më lart.

marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet qëllimit legjitim të ndjekur nga dënimi i gazetarit dhe mjeteve të vendosura për të arritur këtë qëllim, duke pasur parasysh interesin që një shoqëri demokratike kishte në sigurimin dhe ruajtjen e lirisë së shtypit.⁷¹

c) **Mbrojtja kundër kërkimit të vendeve të punës dhe vendbanimeve private të gazetarëve dhe kundër sekuestrimit të materialeve**

Në Belgjikë, në vitin 1995 u kryen kërkime në lidhje me ndjekjen penale të anëtarëve të policisë së shtetit dhe gjyqësorit për shkelje të besimit profesional pas rrjedhjeve të informacioneve të klasifikuara në disa çështje shumë të ndjeshme penale (vrasja e udhëheqësit të partisë socialiste, hetimet në lidhje me korrupsionin industrial, financiar dhe politik). Katër gazetarë belgë iu drejtuan GJEDNJ-së, duke pretenduar (ndër të tjera) se kërkimet dhe konfiskimet nga autoritetet gjyqësore në zyrat e gazetave, shtëpitë e tyre dhe zyrat qendrore të transmetuesit televiziv publik në frëngjisht “RTBF”, përbënin një shkelje të lirisë së tyre të shprehjes të mbrojtur nga neni 10 dhe shkelje të së drejtës së tyre për privatësi sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane, në gjykimin e saj të datës 15 korrik 2003,⁷² arriti në përfundimin se kërkimet dhe sekuestrimet shkelin mbrojtjen e burimeve gazetareske të garantuara me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të drejtën për privatësi.

Gjykata u pajtua me mendimin se ndërhyrjet nga autoritetet gjyqësore belge bazoheshin në ligj dhe synonin të parandalonin zbulimin e informacionit të marrë në besim dhe të ruanin autoritetin dhe paanësinë e gjyqësorit. Gjykata konsideroi se kërkimet dhe konfiskimet, të cilat kishin për qëllim mbledhjen e informacionit që mund të çonte në identifikimin e zyrtarëve të policisë ose anëtarëve të gjyqësorit, që kishin dhënë informacion konfidencial, ishin në sferën e mbrojtjes së burimeve gazetareske. Gjykata theksoi shkallën e gjerë të kërkimeve që ishin kryer, ndërkohë që në asnjë fazë nuk ishte pretenduar se aplikantët kishin shkruar artikuj që përmbajnë informata sekrete për

⁷¹ Shiko Voorhoof, European Court of Human Rights: First Judgments on Freedom of Expression and Information after Reorganisation of the Court, në: Voorhoof D. et al dhe McGonagle T. (Ed. Sup.), Freedom of Expression, the Media and Journalists: Case-law of the European Court of Human Rights, IRIS Themes, European Audiovisual Observatory, Strasbourg, 2015, faqe. 53.

⁷² Çështja Ernst dhe të Tjerë kundër Belgjikës, 33400/96, 15 korrik 2003, ECtHR.

rastet. Gjykata po ashtu ngriti pyetjen nëse mund të ishin përdorur mjete të tjera për të identifikuar përgjegjësit për shkeljet e besimit dhe në veçanti, mori parasysh faktin se punonjësit e policisë të përfshirë në kryerjen e kërkimeve kishin kompetenca shumë të gjera hetimore. Gjykata konstatoi se autoritetet belge nuk kishin treguar se kërkimet dhe konfiskimet në një shkallë kaq të gjerë kishin qenë në përpjesëtim të arsyeshëm me qëllimet legjitime të ndjekura, duke arritur në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Gjykata, për arsye analoge, gjithashtu gjeti një shkelje të së drejtës së privatësisë të mbrojtur nga neni 8 i Konventës.

Këto raste, pavarësisht se janë të ngritura mbi elemente dhe ndodhi specifike për secilin, me kalimin e kohës kanë krijuar një trup të konsoliduar parimesh themelore mbi të cilat janë ngritur rregullat gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve, veçanërisht për sa i përket aktivitetit profesional të gazetarëve hulumtues, fusha e veprimtarisë së të cilëve i vendos ata shpesh herë në rrezik të shkeljes së të drejtave të tyre, por dhe të drejtave të subjekteve të shkrimeve të tyre dhe burimeve të informacioneve shpesh here në natyrë konfidenciale, pa praninë e të cilëve puna e gazetarit si qen roje i aktivitetit të institucioneve shtetërore, por jo vetëm, do të kufizohej në një masë të gjerë.

Këtu duhet të saktësojmë që, pavarësisht se rastet e cituara në këtë kapitull, apo dhe kapitujt paraardhës, janë vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me palë shtete të tjera anëtare, dhe vendime analoge nuk janë dhënë për Republikën e Shqipërisë, ato janë të detyrueshme për autoritetet shqiptare, si Palë e Lartë Kontraktuese në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe drejtpërdrejt të zbatueshme si jurisprudencë me fuqi ligjore detyruese për gjykatat e të gjitha shkallëve të Republikës së Shqipërisë. Një listë e dokumenteve të tjerë për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve në fushën e të drejtës evropiane, të detyrueshme dhe për autoritetet shqiptare, mund ta gjeni në aneksin e raportit.



PRAKTIKAT MË TË MIRA - UDHËZIMET E SHTYPIT PËR GJYQËSORIN

Hyrje

Në disa vende të Evropës (Belgjikë, Holandë, Austri, Hungari, Bullgari, Lituani, Norvegji, Rumani, Spanjë, Turqi) ka një formë rregullimi (ndonjëherë të quajtur udhëzime për shtyp ose protokolle komunikimi) për marrëdhëniet ndërmjet gjykatës dhe medias. Në disa vende këto marrëdhënie rregullohen me ligj (për shembull Ligji Holandez mbi Administrimin e Drejtësisë).

Udhëzuesit për mediat sqarojnë se çfarë presioni mund të pritët nga stafi i gjykatave dhe se si gjykatat duhet të informojnë shtypin para, gjatë dhe pas procedimeve gjyqësore. Udhëzuesit për mediat lejojnë gjykatësit dhe prokurorët të njohin rolet dhe kufijtë e komunikimit të tyre, ndërsa gazetarët të dinë se çfarë mund të kërkojnë dhe presin nga gjyqësori. Udhëzuesit për mediat janë një instrument që ndihmon në promovimin e qëllimit për të siguruar zbulimin e plotë dhe të saktë të të dhënave publikut mbi çështjet ligjore, përmes përfaqësimit objektiv dhe të paanshëm të fakteve relevante. Përderisa nuk rrezikojnë pavarësinë e gjyqësorit, udhëzuesit për mediat kanë një efekt të brendshëm detyrues për gjykatat dhe gjykatësit individualë. Kjo sjell unitet në marrëdhëniet me shtypin dhe një shembull të qartë se si të veprohet në rastet e pyetjeve specifike të shtruar në raste të veçanta.

Në këtë pikë duhet të hidhet dritë mbi një ndryshim themelor mes udhëzuesit për gjyqësorin dhe prokurorisë. Arsyet për këtë janë qëllimet e ndryshme të këtyre institucioneve dhe momentet që këto i komunikojnë publikut. Për këtë arsye në shumë vende ekzistojnë udhëzues të veçantë për median. Këta udhëzues marrin në konsideratë natyrën specifike të zyrave ligjore të përfshira dhe fazën aktuale të procedurave për çdo çështje që mund të tërheqë interesin e mediave. Merren parasysh, për shembull, shkallët e ndryshme të konfidencialitetit që ekzistojnë gjatë hetimit, ndërsa

gjykimi është në pritje, plus rolet e ndryshme ligjore të zyrës hetuese dhe zyrës së gjykimit. Zyra e prokurorisë është përgjegjëse për dhënien e informacioneve shpjeguese gjatë fazës hetimore, zyrat gjyqësore nga ana tjetër p.sh. gjyqtarët/magjistratët e shtypit marrin përsipër këtë rol në fillim të fazës së procesit pasardhës derisa të shpallet aktgjykimi.

Udhëzuesit për mediat në shumë vende (p.sh. Holandë) janë pjesë e një plani strategjik kombëtar dhe pjesë e legjislacionit të brendshëm, me një cikël planifikimi dhe raportimi mbi komunikimin me mediat dhe shoqërinë. Ato zbatohen në nivel kombëtar, në mënyrë që gjyqtarët të dinë se çfarë mund të bëjnë kur mediat dhe publiku dëshirojnë të kenë dijeni mbi çështje të ndryshme. Udhëzuesit për mediat janë detyrues dhe shihen si një përmbledhje e praktikave më të mira për të gjithë gjyqtarët në të gjitha gjykatat e vendit. Disa vende konsiderojnë se udhëzuesit për mediat mund të zbatohen më mirë me anë të ligjit, duke parashikuar sanksione në rast të shkeljeve. Në Angli dhe Uells gjykatat kanë fuqinë për të përcaktuar penalizime kur ka mospërfillje të urdhrave të gjykatës, rregulla të cilat u lejojnë gjykatave të rregullojnë sjelljen e shtypit për shembull, nëse shtypi shkel një urdhër të gjykatës që parandalon publicitetin në një rast të ndjeshëm apo të fshehtë.

Pyetja në lidhje me mundësinë e sigurimit të sanksioneve në rast të shkeljes së udhëzimeve provohet të jetë shumë delikate në funksion të parimit themelor të lirisë së fjalës. Por mund të ketë sanksione specifike për shkeljen e udhëzimeve brenda gjykatës.⁷³ Në këtë rast duhet të jetë specifike dhe të theksohet në udhëzimet. Shembujt e sanksioneve mund të jenë: tërheqja e përkohshme e akreditimit, ndalimi i përkohshëm i informacionit, mohimi i përkohshëm i qasjes në sallën e gjyqit (kryetari i trupit gjykues mund ta vendosë këtë mbi autoritetin e tij gjatë seancës), mohimi i përkohshëm i kopjes së aktgjykimit, humbja e besimit dhe rrjedhimisht një qasje më e vështirë në informacion, etj. Nuk shihen të jenë vënë në praktikë sanksione të rënda për raste të thyerjes së udhëzimeve të gjykatës.

Sanksionimi i çdo sjelljeje që nuk përputhet me ato të përcaktuara në udhëzuesit për mediat mund të trajtohet gjithashtu në nivel disiplinor

⁷³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë ka në brendësinë e tij parashikime ligjore të cilat rregullojnë solemnitetin dhe mbarëvajtjen e seancave gjyqësore, në të cilin parashikohen penalitete financiare, si për palët në gjykim, prokurorët, avokatët, të pandehurit, ekspertët, etj., po ashtu dhe për publikun vëzhgues i cili thyen këto rregulla dhe nuk ndjek urdhrat e kryesuesit të trupës gjyqësore. Neni 341 KPP. Parashikime analoge ka në brendësi edhe të Kodit të Procedurës Civile, Neni 168 KPC.

brenda kategorisë së caktuar profesionale duke parashtruar ankesë kundër profesionistëve (p.sh. kodin etik për gazetarët). Forma e udhëzuesve për mediat duhet të shihet si një protokoll i detyrueshëm moral që është bërë në konsultim me të gjitha palët (mediat, gjykatësit e shtypit, zëdhënësit e prokurorisë, përfaqësuesit e shoqatës së avokatëve). Prandaj udhëzuesit për mediat duhet të jenë të qartë dhe me interpretim strikt. Për të formuluar parimet e udhëzuesit për mediat, organet përfaqësuese të kategorive përkatëse profesionale - magistratë, avokatë dhe gazetarë - gjithashtu duhet të përfshihen në një mënyrë që i pajis ata me përgjegjësi etike. Disa vende e shohin këtë si një detyrë për Këshillat e Gjyqësorit ose Administratën e Gjykatës.

Përmbajtja e këtyre udhëzuesve për mediat duhet të përfshijë:

- një referencë ndaj kodeve etike të Gjyqësorit dhe medias dhe rekomandimeve ndërkombëtare (europiane);
- një shpjegim për rolin dhe funksionin e gjyqësorit, fazat e ndryshme procedurale të të gjitha llojeve të rasteve dhe rolin dhe funksionin e zëdhënësve / gjyqtarëve të shtypit / këshilltarëve të komunikimit në secilën fazë;
- ndalimet ligjore dhe rregullat e sjelljes së mediave në gjykata dhe sallat e gjykimit, por edhe mundësitë për të ekspozuar / mohuar / kundërshtuar me shpejtësi lajmet apo deklaratat e lëshuara në media të cilat janë të rreme, konfuze ose të rrezikshme të paqarta;
- përkufizimi i mediave;
- kufijtë e informimit të Gjyqësorit gjatë fazave të ndryshme të një çështjeje dhe cili aktor brenda Gjyqësorit është përgjegjës, dhe si mund të komunikojë me median;
- e drejta e mediave se si të marrin informacion dhe në cilin informacion mund të kenë akses;
- cilat rregulla zbatohen për regjistrimin audio ose video dhe përdorimin e telefonave celularë dhe mediave sociale në sallat e gjyqit dhe në ambientet e gjykatave, prokurorisë, si dhe në ambiente të tjera të institucioneve të drejtësisë;
- Udhëzuesit për mediat gjithashtu duhet të bëjnë dallimin mes informacionit për mediat dhe publikun dhe informacionet për lajmet dhe programet dokumentare.

Udhëzuesit për mediat duhet të rishikohen dhe përditësohen rregullisht. Duhet të ekzistojë një platformë kombëtare për shkëmbimin e përvojave

me zëdhënësit dhe përfaqësuesit e mediave. Një kërkesë të rregullt që mund të lindë dhe të kontrollojë rezultatet e marrëveshjeve të mëparshme për të zbatuar përvojën praktike për të përmirësuar kapacitetin e tyre për të rregulluar çështjen, në mënyrë që të përmirësojnë gradualisht aftësinë e tyre në përgjigje të zhvillimit të vazhdueshëm të mjeteve të reja të komunikimit.

Në këtë kuadër, do të ishte me shumë dobi krijimi i një sistemi rrjeti të gjyqtarëve të shtypit dhe zyrtarëve të shtypit / këshilltarëve të komunikimit në nivel kombëtar, rrjet i cili duhet të koordinojë shqyrtimin e udhëzimeve në mënyrë që të përditësohet rregullisht. Më tej, mund të jetë shumë e dobishme për frymëzimin të ideve dhe për krahasimin e standardeve të vëna nga institucione të ndryshme. Prej gati një dekade, në Belgjikë, është krijuar një platformë kombëtare për të gjithë gjyqtarët dhe zëdhënësit e shtypit për prokurorinë. Qëllimi i kësaj platforme është të sigurojë kontakte të lehta dhe joformale ndërmjet këtyre zëdhënësve, të shqyrtojë udhëzimet ekzistuese, të përpunojë një shkëmbim të rregullt të përvojave ndërmjet të gjithë palëve të interesuara (p.sh., media dhe shoqata e avokatëve) dhe të krijojë një zyrë të zëdhënësit kombëtar.

Në vijim të këtij kapitulli do të shqyrtojmë disa shembuj të praktikave më të mira të udhëzuesve për mediat të vendosura, për qartësimin e metodave dhe kushteve të kontaktit mes profesionistëve të medias dhe sistemit të drejtësisë. Këto shembuj përfshijnë një përmbledhje të manualeve që përshkruajnë marrëdhëniet e gazetarëve me gjykatat federale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe udhëzuesin për gjykatat penale në Mbretërinë e Bashkuar për bashkëpunimin me median. Ndërkohë që njëri nga manualët tregon se si media të ketë akses pranë autoriteteve të drejtësisë, i dyti është udhëzues për administratën gjyqësore dhe aksesin që kjo e fundit mund t'i japë medias dhe profesionistëve të fushës.

a) **Mediat dhe Gjyqësori në SHBA – Qasja e mediave në Gjykatat Federale**

Gjyqtarët federalë dhe gazetarët që i mbulojnë ata kanë një qëllim të rëndësishëm: Ata duan që publiku të marrë informacione të sakta dhe të kuptueshme për gjykatat federale dhe punën e tyre. Mediat kryejnë një rol të rëndësishëm dhe të mbrojtur kushtetues duke informuar dhe edukuar publikun. Mediat gjithashtu i shërbejnë një roli të respektuar nga koha si

mbikëqyrësi i publikut mbi institucionet qeveritare, duke përfshirë këtu gjykatat. Po ashtu, gjykatat i nënshtrohen një mbrojtje specifike ligjore që u mundëson gazetarëve të kryejnë punët e tyre. Udhëzuesi i Gazetarëve për Gjykatat Federale synon të ndihmojë gazetarët që mbulojnë gjykatat e apelit, të Qarqeve dhe të falimentimit - rastet, njerëzit dhe procesin. Gjithashtu ofron informata themelore për gazetarët që shkruajnë për sistemin e gjykatave federale në tërësi. Udhëzuesi nuk diskuton Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara për shkak të natyrës së çështjeve pranë saj dhe rregullave të veçanta të zbatuara.

Pavarësisht zbatimit të tyre të përgjithshëm, parashikimet e mëposhtme nuk përbëjnë një deklaratë të politikës së Konferencës Gjyqësore të Shteteve të Bashkuara, dhe si të tilla nuk janë të detyrueshme për asnjë gjykatë federale ose gjyqtarët dhe punonjësit e saj. Gjykatat individuale kanë qasje të ndryshme në marrëdhëniet me mediat. Si praktikë e përgjithshme, gazetarët duhet të njihen me zakonet, praktikat dhe rregullat e gjykatave rajonale dhe kombëtare që mbulojnë. Ndërsa disa rregulla dhe statute qeverisin të gjitha gjykatat federale, qarqet dhe rrethet kanë autonomi të konsiderueshme për të përcaktuar rregullat dhe praktikat lokale.

Gjykatat federale janë institucione publike, dhe me përjashtime të rralla, anëtarët e mediave dhe publikut mund të hyjnë në çdo gjykatë dhe sallë gjyqi. Megjithatë, nëse raportohet për një rast të profilit të lartë ose delikat, gjyqësori ka dallime të theksuara për sa i përket aksesit në informacion nga degët e tjera të qeverisë federale, të cilat shpesh ndikojnë në përvojën e një gazetari.

Gazetarët nuk kanë nevojë për diplomë juridike për të mbuluar gjykatat federale, por është thelbësore që të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të përkthejnë për lexuesit/shikuesit zhargonin ligjor dhe procedurat. Për këtë arsye Gjykatat federale kanë krijuar një fjalor specifik për termat ligjore, i cili mund të gjendet në faqen uscourts.gov/glossary.

Gjykatësit federalë i përmbahen udhëzimeve strikte të etikës dhe përjashtohen nga rastet që përbëjnë një konflikt interesi ose në të cilin paanshmëria e tyre mund të diskutohet në mënyrë të arsyeshme. Rastet u caktohen gjyqtarëve rastësisht në gjykatat e apelit, të rretheve dhe të falimentimit për të siguruar drejtësi dhe integritet. Në përputhje me rregullat e etikës, gjyqtarët federalë

nuk japin intervista për rastet ende në shqyrtim. Gjyqtarët “flasin” nëpërmjet komenteve të bëra në gjykatë të hapur ose përmes vendimeve me shkrim. Reporterët duhet të mbështeten në procedurat zyrtare të rasteve si burimi parësor i informacionit. Gjyqtarët, stafi i gjykatës dhe gjykatësit nuk mund të diskutojnë rastet në shqyrtim. Zyra e sekretarit zakonisht është pika e kontaktit e gjykatës me mediat.

Gazetarët kanë të ngjarë të ndeshen me katër kategori gjyqtarësh federalë. Gjyqtarët e gjykatave të qarkut, të cilët mbikëqyrin shumicën e gjykimeve federale dhe gjyqtarët e gjykatave të apelit, të cilët i dëgjojnë rastet e apelit panel, emërohen për jetë sipas nenit III të Kushtetutës të Shteteve të Bashkuara. Ata shpesh referohen si “gjyqtarë të nenit III”. Gjyqtarët e magistraturës trajtojnë shumë procedura gjyqësore në gjykatë të rrethit, ndërsa gjykatësit e falimentimit trajtojnë ekskluzivisht rastet e falimentimit. Gjyqtarët e magistraturës dhe falimentimit kanë kushte të caktuara, por mund të rremërohen.

Sipas Kodit të Sjelljes për Gjyqtarët e Shteteve të Bashkuara (<http://www.uscourts.gov/judges-judgeships/code-conduct-united-states-judges>), të gjithë gjyqtarët duhet të “shmangin komentin publik mbi meritat e veprimeve në pritje ose të pashmangshme”, në rastet para tyre ose në apel. Mos i ngacmoni gjykatësit, asistentët e tyre gjyqësorë dhe ligjëruesit, me pyetje në lidhje me një rast.

Shumë gjyqtarë marrin pjesë në programet e shoqatave të avokatisë dhe ngjarje të tjera publike, dhe ju mund të prezantoheni në situata të tilla. Disa gjyqtarë gjithashtu do të flasin në mënyrë joformale për gazetarët për çështje që nuk kanë të bëjnë me çështjet e tyre. Nëse jeni i ri për mbulimin e një gjykate federale, është e përshtatshme të thërritni dhomat e gjyqtarëve dhe të kërkonin nëse mund të prezantoni veten. Profilet e gjyqtarëve të sapoemëruar, gjyqtarëve të rinj, dhe tregimet rreth projekteve të gjykatës dhe inovacioneve nuk janë të pazakonshme. Gjyqtarët mund të flasin me gazetarët për këto histori, por nuk janë të detyruar ta bëjnë këtë. Disa gjyqtarë federalë gjithashtu mund të diskutojnë aspektet procedurale të një rasti, ndërsa të tjerët refuzojnë të intervistohen nga gazetarët për pothuajse çdo temë. Informatat biografike për shumë gjyqtarë mund të gjenden në faqen e internetit të gjykatës. Biografitë e shkurtra të çdo gjyqtari të Nenit III mund të gjenden në <https://www.fjc.gov/history/judges>.

Qasja e medias në gjykatë dhe dokumentet zyrtare

Gazetarët kanë qasje të njëjtë në gjykata dhe arkivat gjyqësore si anëtarë të tjerë të publikut. Ky akses udhëhiqet nga një përzierje e ligjeve federale, të politikave federale gjyqësore dhe të rregullave dhe praktikave lokale të gjykatave lokale ose të qarkut.

Shumica e dokumenteve gjyqësore janë parashtruar në mënyrë elektronike në gjykatat e apelit, të rretheve dhe të falimentimit dhe janë të disponueshme nëpërmjet shërbimit të qasjes publike në regjistrin elektronik të gjykatave, më mirë i njohur si PACER (www.pacer.gov). Dokumentet PACER gjithashtu mund të lexohen pa asnjë kosto nga një terminal publik në zyrat kancelarisë së gjykatave.

Anëtarët e publikut duhet të kalojnë përmes një detektor metali dhe të bien dakord për çdo kontroll shtesë të kërkuar nga oficerët e sigurimit të gjykatës për të hyrë në një gjykatë federale. Disa gjykata lejojnë hyrjen e përsheptuar të gazetarëve me letra kredenciale të njohura. Nëpunësi i gjykatës mund t'ju tregojë nëse kjo procedurë është në dispozicion. Shumica e procedurave gjyqësore janë të hapura për publikun. Gazetarët nuk duhet të kalojnë nga galeria publike (salla e gjerë e gjyqit) në “pusin” e sallës së gjyqit, e cila përgjithësisht shënohet me parrakë hekuri, pa lejen e gjykatësit ose të punonjësit të gjykatës. Në të gjithë ambientet e gjykatës, gazetarët duhet t'i binden kufizimeve dhe udhëzimeve të postuara nga oficerët e sigurimit të gjykatave. Mosrespektimi i rregullave të gjykatës mund të sjellë sanksione.

Seancat e mbyllura

Procedura të caktuara janë gjithmonë të mbyllura për publikun dhe mediat. Sipas rregullave, vetëm një dëshmitar, avokatë për qeverinë dhe reporteri i gjykatës mund të jenë të pranishëm kur një juri e madhe është mbledhur dhe mbledhjet e saj si dhe takimet e avokatit-klientit ndodhin në mënyrë private. Këto rregulla janë të përvijuara për të mbrojtur integritetin e procesit dhe për të ruajtur të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Procedurat që kanë të bëjnë me informacionin e klasifikuar, sekretet tregtare dhe hetimet në vijim shpesh janë të mbyllura. Gjyqtarët gjithashtu mund të takohen privatisht me avokatët në zyrën e tyre.

Shumica e seancave të paraburgimit janë të hapura për publikun, por secila palë mund të kërkojë nga gjykatësi që të mbyllë disa procedura. Organizatat e medias mund të zgjedhin të paraqesin një mocion kundërshtues në këto raste.

Regjistrimi dhe transmetimi nga salla e gjyqit

Përdorimi i kamerave në sallat e gjykatave federale udhëhiqet nga Konferenca Gjyqësore e Shteteve të Bashkuara dhe Rregullat Federale të Procedurës Penale. Në raste të veçanta, siç janë investimet, natyralizimet ose procedurat e tjera ceremoniale, gjyqtari mund të lejojë publikun dhe mediat të bëjnë fotografi dhe të kryejnë regjistrime video dhe audio brenda një gjykate. Dhe sipas rregullave lokale, Gjykatat e Apelit të Qarkut të Dytë dhe të Nëntë shqyrtojnë kërkesat e mediave për të regjistruar ose transmetuar një procedurë të apelit. Udhëzimet janë në dispozicion në faqet e internetit të gjykatave përkatëse. Përtej këtyre përjashtimeve të kufizuara, mediat nuk mund të fotografojnë ose të regjistrojnë në video ose audio procedura gjyqësore të drejtpërdrejta federale.

Gjykatat e apelit mund të sigurojnë regjistrime audio ose video të seancave dëgjimore të apelit dhe rregullat janë në dispozicion në faqen e internetit të secilës gjykatë qarku. Faqja e internetit e Gjykatës së Rrjetit të Nëntë siguron live streaming video të argumenteve verbale. Përveç kësaj, tri gjykata të qarkut të nëntë - Gjykata e Rrethit për Qarkun e Kalifornisë Veriore, Gjykata e Qarkut në Guam dhe Gjykata e Qarkut për Qarkun Perëndimor të Uashingtonit - sigurojnë video të regjistruara nga gjykata për disa gjykime civile. Disa procedura gjyqësore të qarkut dhe të falimentimit përdorin regjistrimin audio në vend të një gazetari të gjykatës dhe ato regjistrime janë në dispozicion të publikut kundrejt një pagese. Gjyqtari gjithashtu mund të lejojë regjistrimin e videos dhe audios në gjykata për qëllime sigurie dhe për qëllime të tjera të administratës gjyqësore, por këto regjistrime nuk janë në dispozicion të publikut.

Është e rëndësishme të theksohet se ndalimi i regjistrimit përfshin përdorimin e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike personale, madje edhe në gjykata ku publiku lejohet të mbajë pajisje të tilla. Gazetarët nuk duhet të regjistrojnë ose të fotografojnë veprimtarinë e gjykimit, qoftë në sallën e gjyqit, ose në zonat ku ka audio ose video të mbyllur. Shkelja e këtij

rregulli mund të sjellë sanksione të rënda gjyqësore. Sipas rregullave lokale, gjykatat mund të caktojnë zona larg sallës së gjykimit ku kamerat mund të përdoren për intervista dhe raportime televizive. Këto zona zakonisht janë jashtë gjykatës, brenda ose vetëm jashtë pronës së gjykatës federale.

Pajisjet elektronike

Qarqet dhe rrethet vendosin rregulla vendore nëse publiku dhe media mund të sjellin pajisjet e lëvizshme të komunikimit elektronik (si telefonat celularë, laptopë dhe tableta) në gjykatat e tyre, si dhe ku dhe nëse pajisjet e tilla mund të përdoren. Edhe nëse një gjykatë përgjithësisht lejon pajisje elektronike, gjykatësit individualë ende mund t'i ndalojnë ato brenda sallave të gjykimit. Gjyqtarët gjithashtu mund të kufizojnë aplikacionet që mund të përdoren në pajisje të tilla. Për shembull, edhe nëse pajisjet lejohen nga rregullat gjyqësore, një gjyqtar mund të ndalojë blogimin e drejtpërdrejtë ose përdorimin e aplikacioneve të mediave sociale në sallën e gjyqit.

Dokumentet e vulosura dhe seancat e mbyllura

Disa dokumente zakonisht nuk janë në dispozicion të publikut. Siç është theksuar në Politikat e Privatësisë për Dosjet Elektronike të Rasteve (<http://www.uscourts.gov/rules-policies/judicial-policies/privacy-policy-electronic-casefiles>), këto përfshijnë thirrje të padeklaruara ose urdhërarreste; raportet e dorëzimit të parave dhe të prezantimit; të dhënat për të mitur; dokumente që përmbajnë informata për juristët; dhe dosje të ndryshme, të tilla si të dhënat e shpenzimeve, që mund të zbulojnë strategjitë e mbrojtjes së avokatëve të caktuar nga gjykata.

Në rrethana të caktuara, gjyqtarët kanë autoritetin për të vulosur (heqjen e dokumenteve nga domeni publik) dokumente shtesë ose për të mbyllur seancat që zakonisht do të ishin publike. Arsyet mund të përfshijnë mbrojtjen e viktimave dhe informatorëve bashkëpunues, dhe shmangien e lëshimit të informacionit që mund të kompromentojë një hetim penal në vijim, ose të drejta për një proces të rregullt, për të pandehurit.

Disa shembuj:

1. Gjykatat ndonjëherë vulosin dokumente që përmbajnë materiale të ndjeshme, të tilla si informacionet e klasifikuara që prekin sigurinë kombëtare ose informacion që përfshin sekrete tregtare.

2. Dokumentet e çështjeve penale dhe transkriptet e dëgjimit nganjëherë janë vulosur për të mbrojtur dëshmitarët bashkëpunues nga hakmarrja.
3. Rregullat Federale të Procedurës Civile parashikojnë urdhra mbrojtës gjatë zbulimit për të mbrojtur një palë ose person nga bezdisja, sikleti, presioni, apo barra ose shpenzime të panevojshme.

Gjykatat e falimentimit janë publike, por sipas rregullave federale të procedurës së falimentimit, gjykata mund të refuzojë informacione të caktuara komerciale, çdo “çështje skandaloze ose shpifëse”, ose informacione që mund të krijojnë një rrezik të panevojshëm për vjedhjen e identitetit ose lëndime të tjera. Në përgjithësi, kur një palë në një çështje kërkon vulosjen e një dokumenti të caktuar ose mbylljen e një seance për publikun, një rekord i kërkesës mund të gjendet në PACER.

Palët civile mund t’u kërkojnë gjykatësve të lëshojnë një urdhër mbrojtës që ndalon palët që të zbulojnë çdo informacion ose materiale të mbledhura gjatë fazës së zbulimit të fakteve. Dokumentet e depozitimit shpesh mbesin në paraburgim të avokatëve, dhe mediat nuk kanë të drejtën e qasjes në materialet e zbulimit që nuk janë paraqitur në gjykatë. Kur një çështje zgjidhet përmes ndërmjetësimit jashtë sallës së gjyqit, ky fakt zakonisht është i dukshëm nga arkiva publike. Megjithatë, kushtet e zgjidhjes dhe të dhënat e zbulimit të fakteve mund të mbeten konfidenciale.

b) Mediat dhe Gjyqësori në Mbretërinë e Bashkuar - Udhëzime juridiksionale për të mbështetur aksesin e mediave në gjykata - Gjykatat Penale

Për shkak të rëndësisë së proceseve gjyqësore me natyrë penale dhe interesit të shtuar të publikut mbi çështjet e ndryshme të cilat mund të jenë duke u gjykuar në këtë juridiksion, Konferenca Gjyqësore e Mbretërisë së Bashkuar ka përpiluar një rregullore të detajuar mbi rregullat e aksesit të medias në gjykatat penale të vendit dhe marrëdhënien e tyre me gjykatën dhe nëpunësit e saj. Megjithëse gazetarët shpesh janë në gjykatë për të raportuar mbi procedurat e veçanta, punonjësit e gjykatës mund të kontaktohen edhe jashtë seancës për të verifikuar faktet në lidhje me një rast që është dëguar ose për të marrë detaje për një rast të veçantë pas ngjarjes. Ju mund të lëshoni informata faktike që thuhet ose lexohen në gjykatë të hapur, të

përfshira në një dokument gjyqësor që është i hapur për inspektim publik, ose vendoset në një buletin njoftimi publik.

Informacioni lirshëm i aksesueshëm nga media mbi çështje specifike gjyqësore përfshin:

- a) data e seancës dëgjimore në publik, përveçse kur një palë nuk është dashur të njoftohet për atë datë;
- b) secila vepër e pretenduar dhe çdo kërkesë e pranuar;
- c) vendimi i gjykatës për shqyrtimin e çështjes në publik, duke përfshirë edhe vendimin mbi pranimin, dërgimin ose transferimin e çështjes në një gjykatë tjetër;
- d) nëse çështja është në apel;
- e) rezultatet e një procedure gjyqësore dhe nëse kjo e fundit është apeluar;
- f) identitetin e prokurorit, të pandehurit, përfaqësuesit e palëve, duke përfshirë adresat e tyre, si dhe gjyqtarin, magistratin ose magistratët, ose këshilltarin juridik të gjyqtarëve, i cili ka marrë vendimi në seancë publike.

Përtej këtij informacioni, medias i vihen në dispozicion dhe detajet për çdo kufizim të raportimit ose qasjes të urdhëruar nga Gjykata.

Zbulimi i adresave të të pandehurve në media

Krahas këtyre informacioneve, ka pasur një praktikë të gjatë të gjykatave që vënë në dispozicion të mediave adresat e të pandehurve (edhe pse jo publikut) edhe kur nuk lexohet kjo adresë në gjykatë të hapur, për të siguruar identifikimin e saktë të atyre që janë përfshirë në procedurat penale. Në raste të rralla, një gjyqtar mund të lëshojë një urdhër të veçantë që adresa e të pandehurit nuk mund të zbulohet në media. Në rast se, për shembull, zbulimi i adresës së të pandehurit do ta ekspozonte të pandehurin ndaj një rreziku të vërtetë dhe të menjëhershëm për jetën e tij/saj. Informacionet që gjenden në precedentët e policisë, raportet e para-dënimit ose raportet mjekësore dhe psikiatrike nuk mund t'i jepen mediave apo publikut. Këto dokumente mund të përdoren vetëm për të verifikuar një adresë në një dokument tjetër.

Parimi i përgjithshëm, siç përcaktohet në Udhëzimet e Praktikës Penale, është që përfaqësuesit e akredituar të medias duhet të sigurohen me dokumente

dhe informacione, nëse nuk ka ndonjë arsye të fortë për të mbrojtur të drejtat ose interesat legjitime të të tjerëve dhe / ose nëse kërkesa nuk vendos një barrë të panevojshme për gjykatën. Mbetet përgjegjësi e medias (ose çdo marrësi tjetër të informacionit ose dokumenteve) për t'u siguruar që ato të jenë në përputhje me të gjitha kufizimet siç janë kufizimet e raportimit, sipas ligjit.

Udhëzime mbi kufizimet e raportimit

Vendosja e kufizimeve të raportimit përcakton se cilat kufizime mund të vendosen nga një gjykatë penale dhe duhet të shërbejnë si një udhëzues për stafin e gjykatës kur ka paqartësi se cilat kufizime mund të zbatohen dhe si duhet të menaxhohen dhe administrohen.

Kur gjykata ka kompetencë për të vendosur një kufizim në raportimin e ngjarjeve në një dëgjim publik, ose në aksesin publik në një dëgjim tjetër publik, ose ka të drejtë të refuzojë informacionin për publikun gjatë një seance publike, gjykata mund ta bëjë këtë pas aplikimit nga një palë ose me nismën e saj (kryesisht). Pala që kërkon kufizimin e imponuar aplikon pranë gjykatës për të marrë një kufizim të tillë, njofton çdo palë tjetër dhe çdo person tjetër në të njëjtën kohë që i drejtohet gjykatës. Në kërkesën për kufizim të informacionit të shpërndarë për publikun dhe mediat specifikohen termat e propozuar, sa kohë kërkohet të zgjasë kufizimi, çfarë kompetence ka gjykata për të dhënë një urdhër të tillë, dhe pse një urdhër i tillë është i nevojshëm.

Nëse kërkesa është që gjykimi të kryhet në seancë të mbyllur, zyrtarët e gjykatës duhet të paraqesin një njoftim për kërkesën në një vend shpalljeje të dukshëm në afërsi të sallës së gjyqit dhe të njoftojnë mediat lidhur me ndonjë udhëzim tjetër administrativ të dhënë nga kancelari i gjykatës. Mediave duhet t'u lejohej një mundësi, nëse ato dëshirojnë, të bëjnë përfaqësime në gjykatë për një kufizim diskrecional të raportimit që gjykata po mendon të bëjë ose që kërkohet të bëjë.

Gjykatat e të rinjve/miturve

Mediat kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të raportojnë mbi procedurat në gjykatën e të rinjve. Ndryshe nga anëtarët e publikut, mediave nuk u nevojitet leje për të marrë pjesë, megjithatë është e arsyeshme të kërkohet

identifikimi nga një gazetar apo përfaqësues i medias para se t'u jepet atyre mundësia për të hyrë në sallën e gjyqit (kjo mund të jetë një letër identifikimi si gazetar në Mbretërinë e Bashkuar ose një letër nga redaktori).

Ekzistojnë kufizime automatike të raportimit që zbatohen për të mbrojtur identitetin e të miturve nën moshën 18 vjeç në procedurat e mëposhtme:

- procedurat në gjykatën e të rinjve;
- procedurat për apel nga gjykata e të rinjve;
- procedurat në gjykatën e magistraturës që kanë të bëjnë me shkeljen, revokimin ose ndryshimin e një Urdhri për Rehabilitimin Rinor (që ndodh kur autori i veprës ka mbushur moshën 18 vjeç);
- procedurat për apelim nga gjykata e magistraturës në lidhje me një Urdhër për Rehabilitim Rinor. Megjithatë, gjykata mund të heqë ose ndryshojë kufizime të tilla me urdhër të vetin.

Për mediat, në këto raste mund të jepet vetëm informacioni i mëposhtëm:

1. rezultati i çështjes;
2. emri dhe adresa e të pandehurit (në shumicën e rasteve gazetarët tashmë e dinë), por duhet rikujtuar se këto detaje nuk mund të publikohen;
3. mosha, duke përfshirë datën e lindjes të regjistruar në dosjen e gjykatës;

Si rregull, në të njëjtat kushte si dhe në rastet e shkeljes së vendimit të gjykatës për kufizim të raportimit, përgjegjësia për atë që botohet gjithmonë varet nga organizata e medias, e cila dhe i nënshtrohet penaliteteve eventuale në raste shkeljesh.

Neni 45 i Aktit për të Drejtat e të Rinjve dhe Provat Penale të 1999, lejon një gjykatë të ndalojë publikimin që do të identifikonte një të ri të përfshirë në ndonjë procedurë tjetër penale. Gjykata mund të udhëzojë që:

- asnjë raportim mbi procedurën nuk duhet të zbulojë emrin, adresën, shkollën ose vendin e punës, ose të përfshijë ndonjë hollësi që do të çonte në identifikimin e çdo fëmije ose të riu të përfshirë në procedurë, qoftë si person ose që u është nënshtruar procedurave ose si dëshmitar në të; dhe
- asnjë fotografi (ose videoregjistrim) nuk duhet të publikohet ose të përfshijë figurën e ndonjë fëmije apo të riu të përfshirë në procedurë.

Këto janë rregulla të përgjithshme të zbatueshme në procedurat penale në Mbretërinë e Bashkuar, për sa i përket shumë aspekteve të mbulimit të seancave gjyqësore nga përfaqësues të medias. Në të njëjtën linjë, edhe në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë një numër udhëzimesh mbi sjelljen e profesionistëve të medias dhe publikut të gjerë në sallën e gjyqit apo procedurat e ndryshme pranë institucionit procedues apo gjyqësues. Megjithatë, ndryshe nga praktika angleze dhe ajo amerikane, në vendin tonë nuk ekziston një udhëzues gjithëpërfshirës për sjelljen e gazetarëve apo publikut në këto procedura. Rregullat janë të shpërndara në një shumësi tekstesh dhe të paqarta për publikun. Ato mund të gjenden në Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, Udhëzime të nxjerra nga vetë gjykatat dhe urdhra të gjykatësit kryesues të trupës gjyqësore, e cila shqyrton një çështje specifike.

Rastet e pakta kur është përpiluar një udhëzues i konsoliduar mbi të drejtat dhe kufizimet e publikut dhe medias në marrëdhëniet me institucionet e drejtësisë janë Udhëzuesit e Marrëdhënies me Mediat të publikuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit⁷⁴, Kolegji i Posaçëm i Apelit⁷⁵ dhe Institucioni i Komisionerëve Publikë,⁷⁶ që të tre institucione të ngritura në kuadër të reformës në drejtësi, rregullore të cilat do t'i shqyrtojmë më poshtë në këtë udhëzues.

⁷⁴ <http://kpk.al/wp-content/uploads/2018/03/GUIDA-PER-MEDIAT.pdf>

⁷⁵ <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/06/Rregullore-p%C3%ABr-marr%C3%ABdh%C3%ABniet-me-mediat.pdf>

⁷⁶ <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/Rregullore-p%C3%ABr-median-l.pdf>

VI

QASJA NË MEDIA E GJYQËSORIT SHQIPTAR - E DREJTA PËR INFORMIM SHKURTIMISHT

a) **Kuadri normativ në Republikën e Shqipërisë për të drejtën e informimit**

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është përfshirë një nen i posaçëm, Neni 23, mbi të drejtën e informimit: posaçërisht mbi informimin për veprimtarinë e administratës publike. Në këtë nen thuhet:

1. *E drejta e informimit është e garantuar.*
2. *Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.*
3. *Cilitdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.*

E drejta e informimit sipas Kushtetutës është e rregulluar në dy aspekte: e drejta për t'u informuar në lidhje me veprimtarinë e organeve shtetërore si dhe informimi mbi të dhënat vetjake të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Ajo u garantohet të gjithë personave pa asnjë lloj dallimi dhe pavarësisht nga seksi, raca, feja, bindjet politike, prejardhja shoqërore, etj., duke shmangur kështu çdo lloj diskriminimi.⁷⁷

Kjo frymë e përcaktuar në Kushtetutë është shprehur qartë në legjislacionin specifik të miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë në Ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe Ligjin I 19/2014 “Për të drejtën e informimit” të shtatorit 2014, i cili ka përmirësuar shumë aspekte të ligjit paraardhës dhe ka krijuar procedura efektive për aksesin e qytetarëve në të dhënat me karakter publik, dhe rrit më tej transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve qendrore dhe vendore.

⁷⁷ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë – E drejta për mbrojtje nga diskriminimi.

Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka për qëllim të garantojë të drejtën e qytetarëve për t’u njohur me informacionin me karakter publik, të vënë në dispozicion nga autoritetet publike. Ky ligj përcakton rregullat e posaçme për rregullimin e marrëdhënies së institucioneve publike me qytetarët në kuadrin e dhënies së informacionit që konsiderohet publik, duke lehtësuar aksesin e këtyre të fundit në këtë informacion dhe nxitjen e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Përtej detyrimit të institucioneve publike që një numër i madh dokumentesh dhe informacioni publik të publikohet pa nevojën e paraqitjes së një kërkesë nga ana e qytetarit,⁷⁸ neni 3 i ligjit, paragrafi 1, parashikon që çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë arsyet, përveç kufizimeve të përcaktuara nga ligji në nenin 17 të tij, në raste kur shkelet e drejta për jetë private e një subjekti të së drejtës; kur preken sekretet tregtare; të drejtat e autorit dhe patentat, por pa u kufizuar në këto raste, gjithmonë duke shqyrtuar proporcionalitetin e të drejtës së individit për informim me të drejtat konkurruese të sipërpërmendura.

b) Institucionet e krijuara nga reforma në drejtësi dhe marrëdhënia e tyre me median

Në parim dhe në praktikë, në bazë të legjislacionit në fuqi, çdo institucion i drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë këtu gjykatat e faktit, ato administrative, penale, Gjykatën Kushtetuese, institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këshillat e rinj drejtues të gjyqësorit dhe prokurorisë dhe prokuroritë e të gjitha niveleve, kanë një detyrim kushtetues dhe ligjor për të ofruar informacion me karakter publik për qytetarët e interesuar, në bazë të nenit 3 të Ligjit për të drejtën e informimit, për sa kohë këto janë institucione kushtetuese të financuara nga buxheti i shtetit.⁷⁹

Në kushtet kur një numër i madh i këtyre institucioneve nuk kanë vendosur në vend një rregullore ose praktikë të mirëfilltë për marrëdhëniet e organit me median, procedurat e përcaktuara në ligjin për të drejtën e informimit mbeten i vetmi mjet efektiv për akses në informacionin publik

⁷⁸ Neni 7, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” - Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

⁷⁹ Neni 2/1/a, Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” – Përkufizime.

të disponueshëm nga këto institucione. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në faqen e tij në rrjet,⁸⁰ ka vendosur në dispozicion të publikut programin e tij të transparencës, regjistrin për regjistrimin e kërkesave për të drejtën e informimit, si dhe një formular tip që i përcillet këtij institucioni. Të njëjtat hapa janë ndërmarrë dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në faqen e tij.⁸¹

I njëjti format i aksesit në informacion është përdorur dhe nga gjykata të shkallëve të ndryshme, Gjykata Kushtetuese apo Prokuroria e Përgjithshme, duke mos përcaktuar një procedurë të veçantë apo të përsheptuar për aksesin e medias pranë këtyre institucioneve.

Pavarësisht kësaj qasjeje të standardizuar nga institucionet e drejtësisë kundrejt të drejtës për akses në dokumente zyrtare, duke kërkuar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve të drejtësisë kundrejt qytetarit dhe duke i kushtuar një vëmendje të veçantë medias dhe rolit të saj opinionformues dhe për tejçimin e informacionit te qytetari, organet e reja të drejtësisë për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, duke u bazuar dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare në këtë fushë, kanë vendosur rregullore specifike për marrëdhëniet e institucionit me median, të cilat janë vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre online, duke krijuar më tej dhe pozicionin specifik të Koordinatorit për Marrëdhënien me Median, një risi në marrëdhëniet e institucioneve publike me gazetarët dhe median në tërësi.

i. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur në dispozicion të medias një rregullore të detajuar mbi marrëdhëniet me këtë institucion, kontaktet e referencës për kërkesën e informacionit,⁸² rregullat e ndryshme për qasjen pranë ambienteve të këtij institucioni dhe marrjen pjesë në dëgjesat publike.⁸³

Një nga parimet themelore të shprehura në këtë rregullore është fakti se KPK do të kryejë çdo veprim të mundshëm për të lejuar gazetarin të kryejë detyrën e tij. Kjo qasje është parashikuar që në nenin I të kësaj rregulloreje.

⁸⁰ Njoftimet e këtij organi mund të gjenden në <http://www.kld.al/njoftime>

⁸¹ Njoftimet e këtij organi mund të gjenden në <http://klp.al/index.php/programi-i-transparences/>

⁸² URL - <http://kpk.al/media-form/>

⁸³ Shiko më lart rregulloren e KPK për marrëdhëniet me mediat.

Për të lehtësuar kontaktet me mediat dhe që shpërndarja e informacioneve për ta të kryhet në mënyrën e duhur, kjo e fundit ka parashikuar në strukturën e saj, përveç koordinatorit për të drejtën e informimit, koordinatorin për mediat, në interes të një procesi rivlerësimi sa më të hapur, transparent dhe në përputhje me ligjin. Të dhënat e kontaktit për koordinatorin për mediat në KPK mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit. Gjithashtu, në këtë faqe, në mënyrë periodike jepen të dhëna konkrete dhe të përditësuara në lidhje me procesin e rivlerësimit, njoftimet për seancat publike, aktorët e ndryshëm dhe rezultatet e procedurave pranë këtij institucioni.

Koordinatori gjithashtu u mundëson mediave informacione teknike për seancat dëgjimore që po zhvillohen, si dhe për ato në vijim. Informacioni mbi seancat dëgjimore vihet në dispozicion të mediave jo më herët se një javë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore përkatëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të KPK-së, dhe koordinatori për mediat mund të japë informacione mbi çështje faktike që kanë lidhje me këtë seancë. Duhet të nënvizohet fakti se dokumentet procedurale, pjesë e dosjes, nuk vihen në dispozicion për njohje dhe nuk publikohen, për shkak të ruajtjes së privatësisë së gjyqtarit apo prokurorit, subjektit të rivlerësimit dhe sekretit hetimor. Këto dokumente mund të njihen vetëm nga pala ose palët në proces, nga zyrtarët e institucioneve përkatëse të rivlerësimit dhe nga Vëzhguesit Ndërkombëtarë.

Seancat Dëgjimore

Për sa i përket seancave dëgjimore, ato janë publike dhe mund të ndiqen nga gazetarët. Gjatë seancave, gazetarëve luten të mbajnë telefonat me zë të shuar, dhe u lejohet të dërgojnë vetëm mesazhe në format teksti nga celularët e tyre. Gjithsesi, në çdo moment, kryesuesi i trupës gjyquese mund ta kufizojë apo ta ndalojë një komunikim të tillë, nëse ai do të pengojë hetimin apo zhvillimin e rregullt të procesit të seancës.

Gjatë zhvillimit të seancave ndalohet rreptësisht kryerja e regjistrimeve me zë apo edhe me figure. Ky ndalim gjen zbatim edhe për sa i përket regjistrimeve që mediat kërkojnë të kryejnë në zonat publike të ndërtesës së KPK-së, përveç rasteve kur një kërkesë për të kryer regjistrime është miratuar nga koordinatori për mediat në KPK, i cili mund të vendosë kushte për dhënien e lejes nga ana e KPK-së.

Përpara zhvillimit të seancës dëgjimore, në një moment të rënë dakord me koordinatorin për mediat, gazetarëve u jepet mundësia të bëjnë fotografi. Për sa i përket xhirimeve pamore, ato lejohen vetëm nga një pozicion fiks në sallën e seancës, që përcaktohet paraprakisht nga koordinatori për mediat ose pas konsultimit me të. Nëse gazetarëve u jepet leje nga ana e KPK-së dhe kur t'u jepet kjo leje, gazetarëve u lejohet të bëjnë regjistrime (pamore) të hyrjes zyrtare të trupës në sallën e zhvillimit të seancës dëgjimore dhe në çeljen e seancës dëgjimore nga ana e kryesuesit të trupës gjyquese. Më pas fiken kamerat dhe mikrofonat dhe këto mjete hiqen nga salla e zhvillimit të seancës.

Mund të regjistrohen vetëm pjesëmarrësit profesionistë në seancë dëgjimore (për shembull anëtarët e trupës gjyquese të KPK-së dhe sekretari, Vëzhguesi Ndërkombëtar, punonjësit e Gardës së Republikës). Nuk lejohet të regjistrohen as me zë dhe as me figurë subjekti i rivlerësimit, përfaqësuesi i tij, dëshmitarët, publiku, si dhe asnjë pjesëmarrës joprofesionist në seancë. Me përjashtim të regjistrimeve të parashikuara më sipër, nuk lejohet të kryhen regjistrime të tjera me zë apo me figurë në mjediset e institucionit.

ii. *Institucioni i Komisionerit Publik*

Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP), për të mundësuar kushte të përshtatshme për gazetarët dhe ekipet e xhirimit në funksion të ushtrimit të misionit të tyre për informimin e publikut, në të njëjtën frymë edhe me institucionet e tjera të reformës në drejtësi ka emëruar një person të veçantë me funksionin specifik të koordinatorit për median, me të cilin mund të kontaktohet përmes telefonit ose email-it, të vënë në dispozicion në faqen zyrtare të këtij institucioni.⁸⁴

Në bazë të rregullores për marrëdhëniet me median, të miratuar nga ky institucion, gazetarët e ngarkuar të ndjekin veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë, do të akreditohen me konfirmimin e institucioneve mediatike që përfaqësojnë, duke krijuar në këtë mënyrë njëkohësisht një siguri për sa i përket cilësisë së raportimit të veprimtarisë së institucionit, por edhe duke krijuar ndalesa të panevojshme për profesionistë të medias, të cilët nuk janë të akredituar pranë një media të themeluar apo të mirënjohur.

⁸⁴ URL - <http://www.kpa.al/kontakt/>

Informimi i medias për seancë publike në Kolegjin e Apelimit, për shqyrtimin e ankimeve të Komisionerëve Publikë, kryhet nga koordinatori i medias. Pas njoftimit të datës së përcaktuar për një seancë specifike, koordinatori i medias informon më tej gazetarët, me kërkesë të tyre, mbi aspektet faktike të seancës. Në faqen zyrtare të internetit publikohen të gjitha vendimet e Institucionit të Komisionerëve Publikë për të ushtruar ose jo ankimim për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

iii. Kolegji i Posaçëm i Apelimit

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për shkak të ngjashmërive në procedurat e ndjekura në veprimtarinë e tij me ato të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka krijuar dhe miratuar një rregullore të detajuar mbi marrëdhëniet me median, një rregullore kjo që pasqyron solemnitetin e seancave dhe rëndësinë e nevojshme procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në një numër procedurash, ky institucion pasqyron dhe procedurat e ndjekura nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për shkak dhe të vetë natyrës së përafërt të tyre. Gjatë seancave të hapura për publikun, gazetarët lejohen të dërgojnë mesazhe të shkruara (SMS) nga pajisjet e tyre mobile gjatë seancës gjyqësore, duke limituar opsionin e mesazheve vokale apo telefonatave gjatë tyre. Ky komunikim gjithmonë mund të kufizohet gjithashtu me vendim të kryesuesit të seancës.

Njësoj si në ambientet e KPK-së, regjistrimet audio dhe video ndalohen rreptësisht të kryhen, përtej ambienteve të seancës dëgjimore. Gazetarët që dëshirojnë të bëjnë regjistrime audio (audiovizuale) duhet të kërkojnë leje paraprake nga Koordinatorin për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë të paktën 72 orë përpara orës së caktuar për mbajtjen e seancës gjyqësore. Koordinatorin për Median përcakton kushtet për të cilat jepet leja.

Rregullat për pjesëmarrjen dhe regjistrimin gjatë seancave dëgjimore janë të njëjta me ato të zbatuara nga KPK-ja. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të një subjekti të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, mediat audio (vizuale) lejohen të bëjnë regjistrimin e shpalljes publike të vendimit, vendim i cili më pas do të bëhet publik dhe në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

iv. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit

Siç e kemi parë dhe më lart, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit është një operacion monitorues i ngritur për të mbikëqyrur procesin e vetingut të anëtarëve të gjyqësorit në Shqipëri. ONM-ja nuk ka funksione ekzekutive që prekin rivlerësimin aktual të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, gjë që kryhet nga organet vendore të vetingut.

Pika e parë dhe e vetme e kontaktit të këtij operacioni në Shqipëri është Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Duke qenë se ky operacion nuk ka një seli të mirëfilltë në Shqipëri, mënyra e komunikimit me të është e limituar përmes email-it, ose telefonatave pranë Delegacionit të BE-së.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ka një kuti postare funksionale (NEAR-IMO-INFO@ec.europa.eu), ku mediat dhe qytetarët mund të paraqesin pyetjet e tyre. Pasi pyetjet e parashtruara nga media pranohen nga ky institucion, dërguesit marrin një konfirmim mbi dorëzimin e suksesshëm të kërkesës së tyre për informacion.

Paralelisht, nëse është e rëndësishme, pyetjet u dërgohen së pari shërbimeve të përkthimit të ONM-së dhe më pas u dorëzohen Vëzhguesve Ndërkombëtarë të ONM-së në Tiranë, për komente të mundshme. Në përfundim të procedurës së përgjigjes së kërkesave të gazetarëve, Bordi i ONM-së informohet për përgjigjen, përpara se ajo t'i përcillet këtyre të fundit.

VII

MANUAL MBI RAPORTIMIN NGA GJYKATA - UDHËZUES PRAKTIK

Hyrje

Nëse njerëzit e zakonshëm që i nënshtrohen ligjit duhet të mendojnë se shoqëria e tyre është mjaft e fortë për t'i mbrojtur ata nga kriminelët, atëherë ata duhet të kenë një sistem të zbatimit të ligjit që t'i bëjë të ndihen të sigurt. Kjo do të thotë se ata duhet t'i besojnë policisë për të arrestuar kriminelët; dhe ata duhet t'i besojnë gjykatave për të ndëshkuar njerëzit që e thyejnë ligjin, për të liruar njerëzit që i binden ligjit dhe për të ditur dallimin midis tyre.

Me fjalë të tjera, shoqëria duhet të besojë se policia dhe gjykatat janë efektive, të drejta dhe të qëndrueshme. Le të shqyrtojmë secilën nga këto pika.

Efektive: Policia duhet të ketë gatishmërinë dhe aftësinë për të arrestuar njerëzit kur kanë kryer krime dhe për të siguruar ndëshkueshmërinë e fajtorëve.

E drejtë: Policia duhet të pyesë njerëzit, sepse ata besojnë se mund të ndihmojnë me hetimet dhe të arrestojnë njerëzit vetëm kur ka arsye për të besuar se kanë shkelur ligjin. Nëse njerëzit besojnë se policia arreston dikë, pa arsye të fortë, atëherë ata nuk do të kenë besim te policia. Në mënyrë të ngjashme, nëse gjykatat dënojnë ose lirojnë njerëzit vetëm për shkak se janë të bukur apo të shëmtuar, të pasur apo të varfër, ose janë nga e njëjta krahinë e gjykatësit, atëherë njerëzit nuk do të kenë besim në gjykata. Vetëm nëse policia dhe gjykatat veprojnë në mënyrë të drejtë, shoqëria do të ketë besim tek to.

E qëndrueshme: Nëse një gjykatës javën e kaluar dënoi me tre vjet burg dikë për vjedhjen e 1,000,000.00 Lekëve, dhe këtë javë po ai gjen dikë tjetër

fajtor për vjedhjen e 1,000,000.00 Lekëve, atëherë shoqëria do të presë që edhe ky i fundit të dënohet me tre vjet burg. Nëse ka faktorë të tjerë, sigurisht, dënimi mund të jetë i ndryshëm - një njeri mund të ketë kryer një vepër për herë të parë, ndërsa tjetri është burgosur për vjedhjen e parave më parë. Por nëse rrethanat janë pak a shumë të njëjta, shoqëria do të presë që dënimi të jetë pak a shumë i njëjtë.

Nëse gjykatat nuk janë konsistente, atëherë nuk ka gjasa që shoqëria të ndihet e sigurt për aftësinë e gjykatave për ta mbrojtur atë siç duhet.

Shoqëria ka nevojë që gazetarët të marrin pjesë në procedurat e gjykatave dhe të raportojnë saktësisht se çfarë ndodh në to - kush akuzohet për çfarë, çfarë provash ka sjellë prokuroria dhe mbrojtja, cili është vendimi i gjykatës dhe kështu me radhë. Besimi i shoqërisë në sistemin ligjor varet nga shkalla e informimit të njerëzve për atë që po ndodh. Kjo është pjesë e punës së gazetarit dhe është një çështje jetësore. Është një punë që duhet kryer me përgjegjësi.

Një nga arsytet për ndëshkimin e atyre që shkelin ligjin është edhe parandalimi/frikësimi i të tjerëve që të mos veprojnë në të njëjtën mënyrë. Një gjë e tillë nuk mund të kryhet nëse njerëzit nuk e dinë se çfarë ndëshkimi u është dhënë shkelësve të ligjit. Në disa vende sot (dhe në shumë vende në të kaluarën) vrasës dhe kriminelë me damkë janë ekzekutuar në publik dhe kriminelët e tjerë mund të rriheshin në publik (një praktikë që ende vijon në disa vende të botës si Arabia Saudite, Republika Islamike e Iranit, Republika Islamike e Egjiptit, etj.). Kjo është një mënyrë për t'i dhënë mundësi shoqërisë të njohë mënyrën se si ndëshkohen shkelësit e ligjit dhe kjo metodë, e cila aktualisht konsiderohet si barbare vepron si një pengesë ose parandalues për krimet e ardhme. Megjithatë, shumica e vendeve në ditët e sotme preferojnë të përdorin gazetatat, radiot dhe televizionet për t'i bërë me dije njerëzit se çfarë iu ndodh atyre që shkelin ligjin.

Gazetarët duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në publikimin e punës së policisë dhe gjykatave, në mënyrë që shoqëria të dijë se çfarë ndodh me shkelësit e ligjit. Kjo ndihmon në mbarëvajtjen e shoqërisë. Nëse njerëzit besojnë se mund ta thyjnë ligjin dhe të largohen, ata kanë më shumë gjasa të thyjnë ligjin. Nëse njerëzit besojnë se policia dhe gjykatat janë aq arbitrare sa njerëzit e pafajshëm ka shumë mundësi të dënohen si persona

fajtorë, atëherë ata kanë më shumë gjasa të shkelin ligjin. Vetëm nëse njerëzit besojnë se ata që respektojnë ligjin mbrohen nga ligji dhe shkelësit e ligjit ndëshkohen, do të nxiten të veprojnë në përputhje me ligjin. Pra, funksionimi i mirë i shoqërisë varet pjesërisht nga njerëzit që informohen për atë që ndodh në gjykata.

Ekziston një tjetër arsye e shëndoshë përse gazetatat dhe stacionet e transmetimit duhet të dërgojnë gazetarë në gjykatë, përtej detyrës sociale që kryejnë. Në gjykatë ka qindra histori lajmesh tejet interesante. Pothuajse çdo rast që paraqitet në gjykatë ka shumë dramë njerëzore brenda. Ka vrasje, përdhunime dhe sulme, vjedhje, plaçkitje, premtime të shkelura, kontestime të tokës dhe kontrata të prishura. Secili nga këto raste, i shkruar në mënyrën e duhur, mund të japë një histori interesante dhe njëherësh të informojë publikun për punën e gjykatave. Çdo redaktor duhet të mendojë shumë seriozisht për të atashuar një gazetar të përhershëm në gjykata, në rast se kanë staf të mjaftueshëm.

a) Parimet e përgjithshme të raportimit gjyqësor

Ky kapitull ka në qendër të tij raportimin gjyqësor dhe ligjor nga ana e gazetarëve të terrenit dhe kronikës. Ai shqyrton pse është e rëndësishme që çështjet gjyqësore të raportohen dhe ky proces të kryhet në mënyrë të sigurt, të rregullt dhe të duhur. Më tej do të shohim si mund të shkruajmë dhe paraqesim raporte që të jenë të sakta, të drejta dhe interesante për lexuesin/shikuesin.

i. Sistemi i drejtësisë

Është mjaft e rëndësishme që gjithkujt t'i rezervohet një gjykim i drejtë, nëse akuzohet se ka bërë diçka të gabuar ose ka lënduar një person tjetër në një mënyrë a një tjetër.

Kush nuk ka bërë asgjë të keqe s'ka pse të ketë frikë se do të dënohet nëse akuzohet, ndoshta gabimisht, ose nëse dikush merr masa ligjore kundër tyre në një çështje civile. Ata duhet të kenë sigurinë se do të shpallen të pafajshëm nga akuzat. Përndryshe, të gjithë njerëzit do të jetojnë në frikë nga ligji, në vend që të kenë ndjesinë se ligji shërben për t'i mbrojtur ata.

Gjykata është vendi ku shoqëria punëson njerëz të trajnuar posaçërisht për të vendosur nëse një person vërtet ka bërë diçka të gabuar.

Nëse është kryer një krim, policia duhet ta gjejë personin përgjegjës; por nuk është punë e policisë që ta dënojë atë person. Kjo është punë e gjykatave dhe përpara se të ndëshkohen dikë, këto të fundit duhet të binden përtej çdo dyshimi të mundshëm se policia ka arrestuar personin e duhur - atë që ka kryer krimin.

Në një gjykim, prokuroria paraqet provat që e bën gjykatën të besojë se i pandehuri është personi fajtor, dhe i pandehuri (ose avokati i tij) paraqet dëshmi në përpjekje për të treguar se policia/prokuroria e ka gabim. Kur gjykata i ka dëgjuar të gjitha provat, juria (nëse ka) ose gjyqtari (nëse nuk ka juri) vendos nëse i pandehuri është fajtor ose i pafajshëm.⁸⁵

Në këtë kapitull ne synojmë të përqendrohemi në procedurat penale dhe jo në të drejtën civile. Kjo sepse proceset kriminale përgjithësisht janë më të thjeshta dhe më të zakonshme në shoqërinë e përditshme, ndërsa procedurat civile shpesh janë shumë të specializuara, të ndërlikuara dhe më pak të zakonshme. Por shumica e parimeve që mbulojnë rastet penale gjithashtu zbatohen edhe për çështjet civile.

ii. *Një gjykim i drejtë*

Nisur nga rëndësia e faktit që të gjithë të kenë një gjykim të drejtë, duhet bërë çmos që asgjë të mos ndërhyjë në një gjykim të drejtë. Kjo do të thotë se gazetarët që punojnë në shumë sisteme juridike - veçanërisht ata

⁸⁵ Historikisht ka pasur një ndryshim themelor në aplikimin e drejtësisë në sistemin kontinental (Evropa Kontinentale dhe shumica e vendeve të tjera të botës) dhe atë common law (Mbretëri e Bashkuar, Irlandë, Shtete të Bashkuara dhe Shtete te Commonwealth – praktikisht vende të cilat në një moment ose në një tjetër kanë qenë nën perandorinë britanike ose protektoratin e saj, si dhe shtete të cilat kanë pasur një influencë të fortë nga sistemi ligjor britanik). Dallimi kryesor midis dy sistemeve është se në vendet të cilat zbatojnë sistemin common law, jurisprudencë - në formën e opinionëve të publikuara juridike - është me rëndësi parësore, ndërsa në sistemet e të drejtës civile (kontinentale) mbizotërojnë statutet e kodifikuara. Por këto ndarje nuk janë aq të qarta sa kanë qenë më parë ose mund të duken. Në fakt, shumë vende përdorin një përzierje të karakteristikave të dy sistemeve. Shqipëria gjithashtu, pavarësisht aderimit në sistemin e të drejtës civile, continental, ka tipare të theksuara të sistemit common law, për shkak të fuqisë ligjore të jurisprudencës së krijuar nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, por dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat kanë karakter urdhërues për çështje me specifika të përafërta me çështjet e shqyrtuara dhe vendosura nga këto gjykata.

të *common law* - zakonisht nuk lejohen të publikojnë ose transmetojnë gjëra apo fakte të caktuara gjatë procedurave gjyqësore, nga momenti kur dikush do të akuzohet për një vepër penale deri në momentin kur gjykata përfundon shqyrtimin e çështjes.

iii. *Sub judice*

Nga momenti kur dikush akuzohet për një vepër penale, deri në momentin kur gjykata përfundon procedurat shqyrtuese, rasti konsiderohet nën shqyrtim gjyqësor/*sub judice*.

Në praktikë, *sub judice* normalisht fillon kur personi arrestohet, akuzohet ose lëshohet një urdhër për arrestimin e tyre dhe përfundon kur gjyqtari ose juria japin një vendim. Në rastet civile, *sub judice* zakonisht fillon kur në gjykatë paraqitet padia e palës dhe përfundon me vendimin e kësaj të fundit.

Sub judice është një frazë latine që nënkupton “nën gjykimin”. Ndërkohë që një çështje është *sub judice*, gazetarët janë rreptësisht të kufizuar në atë që ata mund të shkruajnë/raportojnë. Kjo për t’u siguruar që ata nuk ndërhyjnë në punën e gjykatës për t’i dhënë të pandehurit një gjykim të drejtë.

Është detyra e gjykatave dhe vetëm e tyre të vendosin nëse personi i akuzuar në fakt ka kryer krimin. Askush nuk duhet të gjykohet dhe të dënohet nga reporterët/gazetarët e kronikës, në kolonat e një gazete apo mbi valët e ajrit.

Natyrisht, është gjithashtu e rëndësishme për shoqërinë që gazetarët (dhe njerëzit e tjerë) të kenë të drejtë të flasin për faktet e jetës dhe këtë e kemi parë dhe më sipër në kapitullin mbi të drejtën e opinionit të lirë dhe lirisë së medias, por do të flasim më gjatë për këtë edhe në vijim të këtij kapitulli. Por, kur ndeshen dy të drejta të rëndësishme, njëra duhet të kufizohet në interes të tjetrës.

Për shembull, çdokush ka të drejtë të udhëtojë nga një qytet në tjetrin. Megjithatë, për shkak se njerëzit që jetojnë përgjatë rrugës kanë të drejtë të ecin në mënyrë të sigurt në drejtim të shtëpive të tyre, shpejtësia e lëvizjes mund të jetë e kufizuar. Dhe për shkak se udhëtarët në anën tjetër kanë gjithashtu të drejtat e tyre, ju mund të kufizoheni në drejtimin vetëm një anë të rrugës. Në të njëjtën mënyrë, e drejta për të folur lirisht për

një procedurë kriminale është e kufizuar për të mbrojtur të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë.

iv. Çfarë mund të raportojmë

Kur është kryer një krim, gazetarët duhet t'u tregojnë njerëzve për këtë. Këta mund të flasin me ata që e kanë parë krimin, ose pronat e të cilëve janë vjedhur ose dëmtuar, dhe citojnë gjërat që këta kanë për të thënë.

Megjithatë, sapo policia të ketë arrestuar dikë që, sipas tyre, është përgjegjës për atë krim dhe po e akuzojnë për atë vepër penale, atëherë gazetarët janë të kufizuar në atë që mund të raportojnë për krimin. Ju mund të raportoni faktin se ka ndodhur krimi, se dikush po akuzohet dhe çfarëdo fakti, i cili nuk ka të ngjarë të kundërshtohet në gjykatë. Nëse një njeri është akuzuar për hyrjen e paligjshme një dyqan dhe vjedhjen e 50,000.00 Lekë në para, dhe mallra në vlerën 250,000.00 Lekë, atëherë duhet të raportojmë faktin se ai është akuzuar. Ne mund të shkruajmë:

Një burrë është akuzuar për vjedhje, pas hyrjes së paligjshme në supermarketin X në fundjavë.

Aleko Hoxha, 28 vjeç, nga Tirana, është akuzuar për vjedhjen e 50,000.00 Lekë në para dhe mallra në vlerën 250,000.00 Lekë nga dyqani, natën e datës 25 korrik.

Është e rëndësishme të theksohet se ne nuk thamë se Hoxha në të vërtetë ka kryer krimin - ky nuk është një fakt. Është detyrë e gjykatave të vendosin nëse ai e ka kryer atë apo jo. Gjithçka që kemi thënë është se Hoxha është akuzuar për krimin - ky është një fakt - dhe se ka pasur një hyrje me forcë në një supermarket në fundjavë - ky është gjithashtu një fakt.

Çdo gjë që gazetarët publikojnë rreth detajeve të krimit ose vuajtjes së viktimave, pasi dikush është akuzuar, mund të ndërhyjë në punën e gjykatës. Duke qenë se gjyqtarët e çështjes janë qenie njerëzore që jetojnë në të njëjtin komunitet me gazetarët, viktimat dhe të pandehurin, këta të fundit ndikohen nga ajo që lexojnë dhe shikojnë. Nëse tregimet e trishta se si vuajtën viktimat vazhdojnë të publikohen deri në ditën e gjykimit, trupa gjyqësore mund të ndihet e hidhëruar dhe e zemëruar ndaj personit të akuzuar. Kjo do ta vështirësojë dhënien e një gjykimi të drejtë.

Shpeshherë, gjyqtarëve nuk u pëlqen që rastet të komentoohen ose të botohet sfondi i ngjarjes, deri në përfundim të çështjes. Pra, nga momenti që dikush akuzohet për një krim - ose, më saktë, nga koha kur policia informon se dikush është gati të akuzohet për një krim - rasti është *sub judice*. Prej këtij momenti, derisa të përfundojë çështja gjyqësore, nuk duhet të shkruani asgjë për krimin, përveç të dhënave që dalin gjatë kohës që po zhvillohet çështja gjyqësore.

v. Pse të raportojmë rastet gjyqësore

Gjykatat ekzistojnë për të vepruar në emër të njerëzve të zakonshëm, prandaj është e rëndësishme që ato të kryejnë punën e tyre në vështrimin e qartë të publikut të gjerë.

Është një parim jetësor që Drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, por duhet të shihet që bëhet. Me fjalë të tjera, gjykatat duhet të bëjnë gjënë e duhur, dhe publiku duhet të shohë dhe të kuptojë se ata e bëjnë këtë.

Për këtë arsye, çdo anëtar i publikut mund të marrë pjesë në çdo çështje gjyqësore, me përjashtim të disa rasteve specifike.⁸⁶

Gazetarët janë anëtarë të publikut, dhe po kështu lexuesit apo dëgjuesit/shikuesit që ata përfaqësojnë. Për këtë arsye, gazetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në rastet gjyqësore dhe detyrën për të qenë atje kur është e mundur në emër të lexuesve dhe dëgjuesve të tyre që nuk mund të jenë të pranishëm. Gazetarëve të kronikës mund t'u caktohet një vend i veçantë në sallën e gjyqit për t'u ulur, i quajtur një galeri shtypi. Në thelb, megjithatë, nuk ka dallim midis reporterit të gjykatës dhe çdo anëtari tjetër të publikut në sallën e gjyqit.

Ekzistojnë tri arsye kryesore përse gazetarët raportojnë çështjet gjyqësore: të inkurajojë besimin e publikut në ligj, të ndihmojë ligjin të parandalojë krimet e ardhshme dhe të vjelë histori goditëse për lajmet e tyre.

⁸⁶ Nenet 339 dhe 340 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

vi. *Shpifja dhe informacioni i privilegjuar*

Ne kemi parë se është në interes të shoqërisë që gjithçka që ndodh në gjykatë të raportohet - akuzat, emri i të pandehurit dhe të gjitha dëshmitë, si dhe aktgjykimi dhe dënimi.

Megjithatë, ekziston një vepër penale e quajtur shpifje, që ndalon njerëzit të thonë gjëra të pavërteta dhe të paqena për njerëzit e tjerë që do të dëmtojnë reputacionin e tyre. A nuk është ky shqetësim për gazetarin e gjykatës?

Supozoni se një gazetar i gjykatës ka shënuar gjithçka që prokurori kishte për të thënë dhe gjithçka që dëshmitarët e prokurorisë kishin për të thënë për të pandehurin; dhe supozoni se gazetari i gjykatës ka bërë punën e tij dhe ka shkruar një raport që s'është publikuar. Ka të ngjarë që të gjitha informacionet e publikuara do të dëmtojnë reputacionin e të pandehurit.

Tani supozo se, në fund të gjykimit, i pandehuri lirohet – dmth, ai ka dalë i pafajshëm. A mund të padisë ai tani prokurorin dhe të gjithë dëshmitarët për shpifje? A mund të padisë gazetarin për shpifje? Në fund të fundit, ajo që u tha dhe shkrua ishte e dëmshme për reputacionin e tij dhe tani duket qartë se nuk ishte e vërtetë. Përgjigjja, natyrisht, është se ai nuk mund t'i padisë për shpifje. Po të ndodhte kështu, atëherë do të ishte e pamundur që gjykatat të bënin punën e tyre. Për të lejuar gjykatat të bëjnë punën e tyre, çdo gjë që thuhet në gjykatë si pjesë e një seance, mbrohet si informacion i privilegjuar, i cili nuk mund të përdoret kundër palës akuzuese në proces potencialisht të hapur nga ish i pandehuri.

Megjithatë, lajmi i mirë për gazetarët e gjykatave është se privilegji mbron edhe persona të tjerë përveç avokatëve dhe dëshmitarëve. Gjithashtu mbron një raport lajmesh për procedurat gjyqësore, për sa kohë që është i drejtë, i saktë dhe pa qëllim të dukshëm negativ kundrejt të pandehurit. Në shumë sisteme ligjore, kjo mbrojtje e veçantë për raportimin e rasteve quhet privilegj i kualifikuar, sepse ka disa kushte apo kualifikime që duhen plotësuar për t'u quajtur i tillë.

Është interesante të theksohet se imuniteti i cilësuar është miku më i mirë i gazetarit të gjykatës. Kufizimet e vendosura për atë që ne mund të raportojmë për një rast nën shqyrtim mund të duket si një vështirësi;

rreziku i shpifjes mund të duket i frikshëm, por privilegji kthen gjithçka në ekuilibër. Gazetarit të gjykatës mund t'i duhet të presë për të treguar historinë e plotë, por kur vjen koha, gjithçka mund të raportohet plotësisht, pa asnjë frikë nga shpifja.

Le të shikojmë tani tre kushtet që një lajm/raportim duhet të përmbushë në mënyrë që të mbrohet nga imuniteti i cilësuar.

1. *Duhet të jetë i drejtë*

Nëse prova është dhënë nga prokuroria dhe mbrojtja, raporti duhet të përmbajë të dyja palët. Nuk është e nevojshme të raportohet çdo fjalë e thënë, por në raport duhet të ruhet ekuilibri i përgjithshëm i çështjes gjyqësore. Për shembull, nëse parashtrimi i rastit nga prokuroria ka marrë dy herë më shumë kohë se sa parashtrimi i mbrojtjes, ju mund të pasqyroni në raportin tuaj në mënyrë të drejtë dy të tretat e provave të prokurorisë dhe vetëm një të tretën provave të mbrojtjes.

Është thelbësore që një gazetë apo stacion transmetimi që fillon të raportojë një çështje gjyqësore, të vazhdojë ta bëjë këtë çdo ditë deri në përfundim të saj. Përndryshe, raportimi i rastit në tërësi nuk mund të jetë i drejtë dhe pastaj do të humbasë mbrojtjen e privilegjit.

2. *Duhet të jetë i saktë*

Është thelbësore që gazetarët e gjykatave të mos bëjnë gabime. Ajo që thotë dëshmitari mund të citohet, por citimi duhet të jetë i saktë. Gazetarët e gjykatave kanë nevojë për një stenografi të mirë. Çdo pasaktësi e rëndësishme do të lërë të gjithë raportin e pambrojtur nga privilegji.

3. *Nuk duhet të veprohet me keqdashje*

Nëse arsyeja që publikoni ose transmetoni një raport gjyqësor është të dëmtoni të pandehurin - domethënë jeni duke bërë keq - atëherë mund të humbni mbrojtjen e privilegjit.

Kjo nuk është diçka për të cilën ju duhet të shqetësoheni shumë shpesh. Ju do të raportoni rastet gjyqësore mbi meritat e tyre, ditë pas dite dhe javë pas jave. Ju do të raportoni për arsyet që kemi diskutuar tashmë - për të informuar lexuesit apo dëgjuesit për atë që po ndodh në gjykata. Normalisht nuk do të ketë keqdashje ndaj askujt të përfshirë në asnjë procedurë.

Problem mund të paraqiste fakti nëse i pandehuri është armik/konkurrent i njohur i juaji ose pronarit ose redaktorit të gazetës, radios ose televizionit. Në këtë rast, duhet të jeni shumë të kujdesshëm për të trajtuar çështjen në të njëjtën mënyrë që do të trajtoni ndonjë rast tjetër të ngjashëm. Nëse publikoni çdo fjalë të provave të prokurorisë, në faqen e parë dhe personi më vonë lirohet, ai mund të orvatet t'ju padisë për shpifje. Nëse ai mund të vërtetojë se raportimi kishte keqdashje në mënyrën e trajtimit të rastit, do të humbisni mbrojtjen e privilegjit.

vii. Raportimi i menjëhershëm i një çështjeje gjyqësore

Koncepti i raportimit të menjëhershëm të një lajmi do të thotë publikimi i tij në numrin e ardhshëm të gazetës ose buletinit të ardhshëm të lajmeve, ose siç ndodh më rëndom në shoqërinë e sotme, drejtpërdrejt në televizionet informative 24/7.

Në disa sisteme ligjore, siç është Britania e Madhe, në momentin që publikoni ose transmetoni një raport gjyqësor në mënyrë të menjëhershme, do të keni një lloj të posaçëm mbrojtjeje nga privilegji (i quajtur privilegj absolut). Në këtë rast, raporti juaj duhet të jetë i drejtë dhe i saktë; nuk ka rëndësi nëse është vepruar apo jo në keqdashje.

Për një gazetë ditore të mëngjesit, një raport i gjykatës është i privilegjuar në këtë mënyrë nëse publikohet në gazetën e mëngjesit pasardhës. Për një gazetë të përditshme të mbrëmjes, lajmi duhet të publikohet brenda të njëjtës ditë, përveç rasteve kur dëgjesa publike përfundon shumë vonë; në atë rast duhet të dalë në botimin e ditës së ardhshme. Për një gazetë javore, duhet të dalë në numrin e ardhshëm. Për radio ose televizion, raporti është i privilegjuar në këtë mënyrë nëse përfshihet në ndonjë buletin deri në fillim të dëgjimit të ditës tjetër. Ai mund të transmetohet në buletin e mbrëmjes, dhe përsëri mëngjesin e ardhshëm, por jo pas këtij të fundit.

Si përfundim:

Gjykatat zakonisht janë të hapura për publikun; gazetarët janë të lirë të raportojnë se çfarë ndodh atje.

Raportimet dhe lajmet mbrohen nga shpifja, përderisa ato janë:

- Të drejta;
- Të sakta;
- Pa keqdashje

b) Udhëzues praktik për raportimin nga gjykata

Në kapitullin e mëparshëm vumë në dukje pse është e rëndësishme që çështjet gjyqësore të raportohen dhe si ta bëjmë atë në mënyrë të sigurt dhe të duhur. Në këtë kapitull shohim se si të shkruajmë raporte që janë të sakta, të drejta dhe interesante.

Puna e raportimit gjyqësor është në thelb e njëjtë për të gjitha mediat - gazetatat, radiot dhe televizioni - por ka disa dallime. Së pari do të shqyrtojmë ato dallime dhe pastaj do të kalojmë në gjërat që ata kanë të përbashkëta.

Gazetat

Për secilën çështje gjyqësore që ju raportoni, secili raport duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Emrat, adresat dhe vendet e origjinës të të gjithë të pandehurve (plus mosha, nëse konsiderohet e rëndësishme).
- Vepra penale ose veprat penale për të cilat akuzohen.
- Pranimi ose jo i fajit nga secili i pandehur për çdo akuzë.
- Gjykata ku shqyrtohet rasti.

Nëse një rast zgjat për pesë ditë, pesë javë ose pesë muaj, këto detaje duhet të përfshihen në raportin tuaj çdo herë. Detajet e sakta të adresave do të ndryshojnë nga një gazetë në tjetrën. Për shembull, disa gazeta zgjedhin të japin adresën e saktë numrin e shtëpisë dhe rrugën, ndërsa të tjera - ndoshta gazetatat kombëtare - mund të përmendin vetëm qytetin ose fshatin.

Përveç kësaj, ju duhet të jepni informacionin e mëposhtëm nëse është e mundur:

- Emri i gjyqtarit ose gjykatësit që e dëgjon çështjen, veçanërisht kur e raporton aktgjykimin ose dënimin.
- Emrat e prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës.

Ju gjithashtu duhet të jepni emrat dhe detajet e tjera personale të të gjithë dëshmitarëve dëshmitë e të cilëve i citoni në raportin tuaj.

Çdo raport duhet të ketë gjithashtu:

- ose vendimin e gjykatës; dënimin, ose informacionin se kur do të shpallet dënimi
- ose, nëse procedura gjyqësore nuk ka përfunduar, fjalët “gjykimi vijon”. Pavarësisht informacionit të mëtejshëm që është hequr nga trupi i lajmit nga redaktorët (dhe shkurtime të tilla duhet të bëhen vetëm me kujdes të jashtëzakonshëm), ky togfjalësh duhet të mbetet gjithmonë si fjalët përfundimtare të raportimit të një rasti të papërfunduar. Pjesa tjetër e raportit do të jetë një llogari e procesit të ditës, duke cituar atë që u tha nga palët - avokatët, gjykatësi, dëshmitarët, specialistët e thirrur nga gjykata etj.

Radio dhe televizioni

Raportimet e gjykatave për radio dhe televizion nuk mund të jenë aq të gjatë sa raportimet e gjykatave në gazeta. Kjo do të thotë se ata duhet të japin më pak detaje, duke u përqendruar kryesisht te historia.

Detajet që do t’ju duhet të jepni janë:

- Emrat e të gjithë të pandehurve dhe shkurtimeve prej nga vijnë.
- Vepra penale ose veprat penale për të cilat janë akuzuar, thjeshtuar sa më shumë që të jetë e mundur.
- Pranimi ose jo i fajit nga secili i pandehur për çdo akuzë.
- Gjykata ku është shqyrtuar çështja.

Ashtu si me gazetatat, është e rëndësishme që dëgjuesit/shikuesit tuaj të dinë nëse rasti nuk ka përfunduar ende. Togfjalëshi “gjykimi vijon” duhet të mbetet gjithmonë si pjesë përmbyllëse e raportimit të një rasti të papërfunduar.

Të gjithë gazetarët

Nëse jeni duke raportuar për një gazetë, stacion radio ose televizion, raporti duhet të jetë i saktë dhe i drejtë, por nuk duhet të jetë i mërzitshëm. Mos e humbni gjykimin tuaj për atë që është lajm. Rastet e gjykatave janë plot me tregime të ngjarjeve dramatike, por gjykatat duan të fshehin dramën. Është detyra juaj për të parë dramën që qëndron prapa proceseve serioze dhe dinjitoze, dhe t’ia përcillni këtë lexuesve ose dëgjuesve/shikuesve tuaj.

Hyrja e lajmit

Hyrja juaj për një çështje që ka mbaruar duhet gjithmonë të përqendrohet te krimi dhe jo te procesi gjyqësor. Nëse një person i cili dikur ka qenë polic dënohet me një vit burgim për mitmarrje, introja juaj duhet të raportojë kundërvajtjen ligjore. Dënimi që i jepet atij mund të jetë pastaj paragrafi i dytë:

Shembull:

Një ish-polic pretendonte të ishte dikush tjetër që të merrte 500 dollarë nga një fond kursimi.

Dje, Gjykata Penale vendosi dënimin e tij me një vit burg.

Shumë gazetarëve të rinj iu duket e çuditshme. Ata mendojnë se vendimi i gjykatës është shumë më i ri se krimi dhe prandaj duhet të përbëjë hyrjen e lajmit. Ata nuk kanë kapur thelbin e lajmit. Në këtë rast risi përbën fakti se ish-polici e kreu krimin. Deri në momentin kur ai u gjet fajtor, ishte vetëm një pretendim. Kjo është mundësia e parë për të thënë se ky njeri bëri këtë gjë të gabuar. Ky është lajmi dhe duhet të jetë hyrja juaj, përveçse kur dënimi i gjykatës është aq i pazakontë sa të jetë më i denjë për lajme sesa vetë krimi.

Ngjyra e lajmit

Disa raste gjyqësore janë më të denjë për lajme sesa të tjerët. Disa do të përfshijnë një figurë publike të shquar; të tjerët do të merren me krimet që janë raportuar gjerësisht në atë kohë - një vrasje e shumëfishtë, për shembull. Gazetarët zakonisht duan të shtojnë disa ngjyra në raportet e tyre për këto sprova të mëdha. Ngjyra në një raport të lajmeve do të thotë detaje shtesë që ndihmojnë lexuesit ose dëgjuesit të përfytyrojnë atë që ndodhi - siç janë përshkrimet e sallës së gjykimit, të njerëzve të përfshirë dhe se si ata flisnin dhe të atmosferës. Kjo është e këshillueshme të bëhet, por duhet bërë me kujdes të madh.

Lexuesit dhe dëgjuesit/shikuesit mund të jenë shumë të interesuar të dinë se çfarë kanë sjellë të pandehurit dhe dëshmitarët, dhe nëse ato dukeshin nervozë ose të sigurt gjatë dhënies së provave. Sidoqoftë, asnjë nga këto informacione nuk është i privilegjuar dhe mund të konsiderohet nga gjyqtari si shkelje e rregullave të sallës së gjykimit.

Duhet të kujdeseni që ngjyrimi i futur në lajm të mos e paragjykojë gjykimin. Ju mund të përshkruani se si i pandehuri ka shtrënguar një shami në gishtat e tij duke dhënë dëshmi, por nëse ju thoni se ai ishte nervoz atëherë mund të nënkuptojë se ai ishte duke gënjyer. Ju mund të thoni se i pandehuri ka qarë ndërkohë që ai ishte duke u shqyrtuar, por mos e raportoni në një mënyrë që projekton te lexuesit ndjenja keqardhjeje për të, objektiviteti në përcjelljen e lajmit është një tipar themelor i raportimit mbi çështjet gjyqësore, sidomos ato me karakter penal.

Ekulibri

Një çështje gjyqësore ka nevojë të shqyrtojë qëndrimet e të dy palëve - prokuroria dhe mbrojtja. Vetëm atëherë gjyqtari mund të vendosë nëse i pandehuri është fajtor apo jo. Nëse presim që të vendoset drejtësisht mbi një çështje, çdo raport mbi të duhet të paraqesë një ekuilibër të drejtë mes pohimeve të të dyja palëve.

Nëse një çështje shqyrtohet e gjitha brenda një dite (ose e gjitha në një javë, në rastin e gazetave javore), raporti duhet të mbajë të dy parashtrimet, atë të prokurorisë dhe të mbrojtjes, me një gjatësi të përafërt. Nëse rasti zgjat për disa ditë, atëherë duhet të jepet hapësirë e përafërt e barabartë në pohimet e mbrojtjes siç i është dhënë në pohimet e prokurorisë. Nuk do të ishte e drejtë të paraqitet një faqe me 400 fjalë mbi dëshminë e dëshmitarëve të akuzës, dhe dy ditë më vonë vetëm 150 fjalë në fund të faqes, me pohime të dëshmitarëve të mbrojtjes. Në mënyrë të ngjashme, do të ishte e padrejtë të jepen 60 sekonda në buletinin e çdo dite, ndërkohë që prokuroria po paraqet rastin e saj, por vetëm 15 sekonda çdo ditë, ndërsa mbrojtja është duke paraqitur parashtrimet përkatëse.

Saktësia

Nëse një raportim nuk është i saktë, nuk është i privilegjuar. Pra, është me rëndësi që të merret një shënim i saktë për pikërisht atë që thuhet nga gjyqtari apo magistratët, avokatët dhe dëshmitarët. Shumica e vendeve nuk lejojnë gazetarët të përdorin regjistruarit kasetë brenda gjykatës (Rast shembullor është Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ku ende janë në fuqi rregulla që ndalojnë përdorimin e regjistruarëve të çfarëdo lloj forme gjatë një procedure shqyrtimi pranë saj). Për këtë arsye, është e

domosdoshme që gazetarët e gjykatave të marrin shënime në jo më pak se 80 fjalë për minutë, mundësisht 100.

Rrethanat e veçanta

Shumica e rasteve gjyqësore janë ashtu siç i kemi përshkruar ato. Megjithatë, ekzistojnë një sërë rrethanash kur gjykatat punojnë me metoda të veçanta, të cilat ndikojnë mbi reporterin e gjykatës.

Masa e Sigurimit

Kur paraqiten akuzat ose ngrihen akuza mbi vepra penale, këto të fundit duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor derisa të zbulohet e vërteta dhe të arrihet një vendim. Por hetimet mund të kërkojnë një kohë të gjatë, duhet të përgatiten dokumentet dhe gjykatat dhe prokuroritë janë vende me vëllim pune të lartë; çështja mund të jetë komplekse; mund të ketë nevojë për marrjen e provave nga vende fqinje; mund të ketë nevojë për akte ekspertimi të veçanta që kërkojnë kohën e duhur për t'u kryer; mund të kërkohet prania e dëshmitarëve të cilët nuk ndodhen në afërsi të gjykatës shqyrtuese etj., kështu që mund të lindë domosdoshmëria që çështja për të akuzuarin mund të ketë nevojë të shtyhet për një datë të mëvonshme. Procesi i shtyrjes ligjore të një çështjeje gjyqësore zakonisht fillon me përcaktimin e masës së sigurimit kundrejt të pandehurit.

Procedura e përcaktimit të masës së sigurimit është një mundësi që personi i akuzuar të paraqitet në publik në gjykatë, kështu që komuniteti mund të shohë se ai është ende i disponueshëm dhe i sigurt. Për ekonomi dhe komoditet, këto procedura normalisht ndodhin në gjykatat më të ulëta në sistem, ose përpara të njëjtës gjykatë që do të shqyrtojë themelin e çështjes.⁸⁷ Masat e sigurimit personal ndahen në masa shtrënguese dhe masa ndaluese.

Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. Këto masa të sigurimit vendosen:

- a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës;

⁸⁷ Nenet 227 e vijues të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

- b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; dhe
- c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.

Vendimi për caktimin e masës së arrestit në burg është masa e sigurimit personal më e rëndë që mund të caktohet ndaj një të pandehuri. Regjimi i paraburgimit zakonisht caktohet nëse magjistratët mendojnë se personi mund të kryejë një vepër tjetër penale, të largohet ose të ndërhyjë në procesin ligjor duke dëmtuar dëshmitarët. Në shumë vende, i akuzuari mbahet në një qendër paraburgimi, qoftë brenda një burgu më të madh ose në një strukturë të veçantë.

Përtej masës së sigurimit personal të arrestit me burg, ekzistojnë dhe një numër masash të tjera që vendosen nga magjistratët, kur shihet se vepra penale e kryer nga i pandehuri, por dhe rrezikshmëria e tij shoqërore është më e ulët. Këto fillojnë me lirim me dorëzani që t'i lejohet të akuzuarit të kthehet në komunitet për të vazhduar jetën normale derisa të dëgjohet çështja kundër tij. Kjo zakonisht zgjidhet për krime të lehta dhe raste me rrezik të ulët. Megjithatë, për të inkurajuar të akuzuarit që të paraqiten për dëgjimin e tyre gjyqësor, magjistratët mund të insistojnë që ata të paguajnë ose të premtojnë të paguajnë një shumë parash, të cilën ata do ta humbasin (heqin dorë) nëse nuk arrijnë të paraqiten pranë gjykatës. Këto para quhen garanci pasurore, edhe pse në shumë vende fjala gjithashtu i referohet personit që vendos paratë e liruara me kusht. Gjyqtari gjithashtu mund të diktojë kushte të tjera, si p.sh. i akuzuari duhet të raportojë rregullisht në polici ose të dorëzojë pasaportën për të parandaluar largimin e tij nga vendi.

Masa të tjera sigurimi janë: ndalimi dhe detyrimi për qëndrimin në një vend të caktuar; arresti në shtëpi; dhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.

Gazetarët zakonisht janë të lirë të raportojnë mbi procedurat e masës së sigurimit, duke përfshirë elementët e lirit me kusht, edhe pse në disa vende nuk mund të lejoheni të raportoni arsyet pse refuzohet lirimi me kusht.

Kur raportoni mbi masën e sigurimit, kini parasysh se personi është ende vetëm i akuzuar - asnjë vendim nuk është marrë ende nëse është fajtor apo i pafajshëm. Në shumicën e sistemeve juridike bashkëkohore, ekziston

një prezumim i pafajësisë, që do të thotë që të gjithë duhet të supozojnë se i pandehuri është i pafajshëm nëse dhe derisa gjykata vendosi ndryshe. Kini kujdes që raportimet tuaja ta bëjnë këtë fakt të qartë dhe të mos nënkuptojnë që personi, i cili po i nënshtrohet procedurës së masës së sigurimit është fajtor.

Procedurat për krimet e rënda

Krime të rënda, të tilla si vrasja, përdhunimi ose vjedhja që përfshijnë shuma të mëdha parash, trafikimi i qenieve njerëzore, narkotikëve dhe organizimi dhe drejtimi i grupeve kriminale gjykohen në një gjykatë të veçantë, atë të krimeve të rënda, tashmë Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar⁸⁸. Krimet më të vogla dhe kundërvajtjet penale gjykohen në gjykatat e zakonshme penale. Të gjithë procedurat gjyqësore fillojnë përmes veprimeve paraprake ku verifikohet prania e palëve, paraqiten kërkesat paraprake, paraqiten provat dhe dëshmitarët e thirrur dhe vijohet me procedurat e mëtejshme gjyqësore.

Në kuadër të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, seanca gjyqësore është publike, përndryshe quhet e pavlefshme.⁸⁹ Pavarësisht ekzistojnë rrethana të veçanta në të cilat një pjesë e publikut mund të ndalohet nga pjesëmarrja në to. Në seancë nuk pranohet të jenë të pranishëm të miturit nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe ata që janë në gjendje dehje, intoksikimi ose çrregullimi mendor.

Duke qenë se këto procedura janë publike, një reporter i gjykatës mund të përfshijë në lajmin e tij:

- Emri i gjykatës dhe emri i gjyqtarit që shqyrton çështjen.
- Emrat, adresat, moshat, vendet e origjinës dhe vendet e punës të të pandehurve dhe dëshmitarëve relevantë.
- Vepra ose veprat penale për të cilat akuzohen të pandehurit (ose një përmbledhje e tyre).
- Emrat e avokatëve ose prokurorëve të policisë të përfshirë.
- Vendimi i gjykatës.
- Nëse një i pandehur është dërguar për gjykim, gjykata me të cilën është dërguar dhe akuzat për të cilat ai është dërguar (i cili mund të jetë i ndryshëm nga vepra origjinale me të cilën është akuzuar).

⁸⁸ Neni 13/3/1 Kodi Procedurës Penale.

⁸⁹ Neni 339 Kodi Procedurës Penale – Publiciteti i Seancës.

- Nëse procesi i marrjes së vendimit shtyhet, data dhe vendi ku janë shtyrë.
- A jepet apo jo dorëzani (nëse jo arsyet pse refuzohet lirimi me kusht).
- Nëse është dhënë ndihma juridike, nëse ekziston një skemë e ndihmës juridike.

Fëmijët në gjykatë

Fëmijët ndonjëherë sillen kaq keq sa duhet të paraqiten para gjykatave. Zakonisht ekzistojnë gjykata të posaçme, të quajtura gjykata për fëmijë apo gjykata për të mitur. Këto gjykata në sistemin shqiptar krijohen si seksione të veçanta me dekret te Presidentit të Republikës.⁹⁰

Në shumicën e vendeve, përpara cilësdo gjykatë të paraqitet një fëmijë, gjithmonë zbatohet i njëjti rregull i artë:

Fëmija nuk mund të identifikohet kurrë në një raportim pa lejen e posaçme të gjyqtarit.

Kodi i Procedurës Penale, në nenin 103 parashikon ndalimin e publikimit të gjeneraliteteve dhe të fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të mitur, të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale. Gjykata mund të lejojë publikimin vetëm kur e kërkojnë interesat e të miturit ose kur i mituri ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç.

Arsyeja për këtë është e thjeshtë. Fëmijët dënohen për t'i bërë ata të sillen më mirë në të ardhmen, jo për hakmarrje. Publikimi i procedurave kundrejt tyre dhe njohja në publik si kundërvajtës penalë ose kriminelë, nuk do t'i ndihmojë ata që në të ardhmen mos të jenë të këqij dhe të bëhen qytetarë që respektojnë ligjin. Mosha në të cilën të miturit ligjërisht konsiderohen si të rritur varion nga vendi në vend. Ndonjëherë ajo është 16, 17 ose 18, ndonjëherë edhe më të rinj, në varësi të veprës penale që ata kanë kryer.

Nuk është thjesht çështja të mos përmendet një fëmijë; është e rëndësishme që të mos jepet asnjë informacion ndihmës në identifikimin e fëmijës. Për shembull, përshkrimi i një fëmijë si “djali nëntëvjeçar i një drejtori të shkollës së komunitetit nga fshati X” e identifikon atë po aq saktësisht sikur

⁹⁰ Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale - Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre.

të qe përdorur emri i tij. Si rregull i përgjithshëm, mund të përdoret vetëm mosha, gjinia dhe zona e përgjithshme e banimit të fëmijës. Për shembull:

Një vajzë dhjetëvjeçare nga Elbasani ...

Ndonjëherë dy anëtarë të së njëjtës familje shfaqen së bashku në gjykatë, të akuzuar për të njëjtin krim. Njëri prej tyre mund të jetë i rritur dhe tjetri i mitur – atë e djalë, për shembull, ose dy vëllezër.

Në një rast të tillë, lejohet të përmendet i rrituri, sigurisht; por nëse informohet publiku se dy të pandehurit kanë lidhje të ngushta familjare, identifikimi i të miturit do të bëhet tejet i thjeshtë, gjë që do të shkelë rregullin e mësipërm, por dhe ligjin. Ka dy mënyra për të raportuar një rast të tillë.

E para nuk është të raportojnë marrëdhëniet, por t'i quajnë “Agim Haxhiu, 28 vjeç, nga Tirana dhe një djalë nëntëvjeçar nga Tirana”. Në këtë mënyrë i mituri nuk është identifikuar. Ndonjëherë, megjithatë, është e pamundur të raportohet çështja pa përmendur marrëdhënien. Në një rast të tillë, është mirë të mos përmenden as personi i rritur dhe as ai i mitur, por të identifikohen si “Një 28-vjeçar nga Tirana dhe djali i tij nëntëvjeçar”.

Kufizimi i dytë në raportimin e rasteve gjyqësore që përfshijnë të miturit, në shumë vende është që nuk mund të bëhen publike faktet apo parashtrirat e avokatëve, apo komentet e magjistratit. Gjithçka që mund të jepet si informacion për publikun e gjerë është një përmbledhje e akuzave dhe vendimit të gjykatës. Për shembull:

Një vajzë dhjetëvjeçare nga Tirana dje është dënuar me vendim penal të pezulluar për një vit për vjedhjen e një regjistruesi video nga shtëpia e një të afërmi.

Duket të kihet parasysh, se pavarësisht që në disa vende raportimi i procedurave gjyqësore ku përfshihen si palë ose dëshmitarë të mitur, mund të lejohet, sistemi shqiptar i ndalon rreptësisht këto veprime.⁹¹

⁹¹ Neni 104 Kodi Procedurës Penale - Shkelja e ndalimit të publikimit

Gjykatat familjare/Seksionet familjare

Martesa është një gjë publike, sepse njerëzit në një shoqëri duhet të dinë se kush është i martuar me kë. Në këtë mënyrë, marrëdhëniet shoqërore mund të vazhdojnë siç duhet. Njëlloj si martesa, edhe divorci duhet të jetë publik. Njerëzit duhet të dinë kur një martesë ka përfunduar, në mënyrë që ata të njohin statusin ligjor të njerëzve të përfshirë, në të njëjtën mënyrë siç duhet të dinë kur ka ndodhur një martesë.

Martesat civile - në krahasim me martesat tradicionale zakonore ose marrëdhëniet *de facto* të njerëzve që bashkëjetojnë - mund të lidhen dhe përfundojnë vetëm me ligj. Gjykatat të cilat vendosin nëse ka arsye për përfundimin e martesës zakonisht quhen Gjykatat e Familjes/Seksionet Familjare. Arsyet e një gjykate për të dhënë një divorc janë zakonisht që njëri nga partnerët ka kryer një shkelje martesore, si shkelja e besimit bashkëshortor, mizoria (fizike ose mendore), dezertimi për një periudhë të caktuar ose sjellje e keqe e vazhdueshme, ose thjesht diferenca në qëndrim ndaj njëri-tjetrit.

Është e dobishme nëse raportohen rezultatet e rasteve të divorcit, në mënyrë që shoqëria të dijë se kush është i martuar dhe kush nuk është. Është gjithashtu një çështje me interes të madh publik kur një figurë e njohur është divorcuar, kështu që është një lajm i madh. Megjithatë, ndoshta nuk do të jeni në gjendje të raportoni ndonjë hollësi për atë që ndodh në gjykatë. Vende të ndryshme kanë parashikime ligjore të ndryshme për sa i përket informacionit i cili mund të bëhet publik mbi procedurat për zgjidhjen martesore të dy bashkëshortëve.

Në disa vende, reporterëve u lejohej të tregojnë se cilët ishin dëshmitarët dhe japin një deklaratë të shkurtër të akuzave, mbrojtjeve dhe kundërakuzave në mbështetje të të cilave janë dhënë dëshmi, plus përmbledhjen e gjyqtarit, vendimin e tij dhe çdo koment që ai mund të bëjë kur jep vendimin e tij. Në vende të tjera, mund të jetë e mundur të raportohet procedura e divorcit pa asnjë kufizim. Gjykatat familjare gjithashtu dëgjojnë rastet që përfshijnë fëmijët - zakonisht urdhrat e kujdestarisë dhe kërkesat për adoptim. Në këto raste, po si në rastet e para më lart, në procedurat penale, zbatohet rregulli i artë për fëmijët: ata normalisht nuk duhet të identifikohen. Në të vërtetë, në shumicën e vendeve, dëgjimet e tilla zhvillohen në seancë të mbyllur për publikun.

Dëshmitë e pahijshme

Disa seanca mund të kenë nevojë që gjyqtari të dëgjojë provat që janë intime dhe mund të jenë të pahijshme për publikun e gjerë. Për shembull, një grua mund të kërkojë një divorc me arsyetimin se kërkesat seksuale të bashkëshortit të saj ishin të egra dhe gjykatësi do të duhet të dëgjojë në detaje se çfarë përbënin ato kërkesa, për të vendosur nëse ishin mizore. Gjithashtu, në rast të përdhunimit ose abuzimit seksual, duhet të dëgjohet provat e një mjeku ligjor, i cili ka ekzaminuar viktimën pas sulmit.

Reporterët e gjykatës normalisht nuk do të publikojnë ndonjë gjë të pahijshme në një raport të gjykatës, edhe nëse është thënë në seancë të hapur për publikun. Nëse jepen dëshmi të pahijshme, mund të raportohet fakti se është dhënë dëshmi, por jo detajet e asaj. Për shembull, informacioni mund të paraqitet në formën e mëposhtme:

Zonja Bajraktari përshkroi kërkesat seksuale të bashkëshortit të saj, të cilat ajo pretendonte se ishin mizore.

Ose mund të formulohet si:

Dr. Aulona Haxhiu dha dëshmi lidhur me gjendjen fizike të viktimës pas përdhunimit të pretenduar. Ajo i përshkroi dëmtimet e viktimës në detaj dhe tha se këto ishin në përputhje me rastet kur ndodhin marrëdhënie të dhunshme seksuale.

In camera/Në Dhomë Këshillimi/Seancë me dyer të mbyllura

Në rrethana të caktuara, gjykata mund të vendosë të dëgjojë provat *in camera*. Kjo është një frazë latine që do të thotë fjalë për fjalë “në dhomë”, dhe në praktikë do të thotë “privatisht”. Asnjë gazetar apo anëtar tjetër i publikut nuk lejohet në sallën e gjyqit, ndërsa këto prova dëgjojnë. Edhe nëse ju arrini disi të kuptoni se çfarë u tha, nuk ju lejohet ta publikoni atë. Një gjykatë normalisht do të dëgjojë *in camera* vetëm provat e mbledhura nëse përfshijnë sigurinë kombëtare, provën ose argumentet ligjore të cilat një gjykatës nuk dëshiron që juria të dëgjojë ose në raste të caktuara që përfshijnë të miturit.⁹² Në sistemin gjyqësor shqiptar, Gjykata e Lartë,⁹³ por

⁹² Nenet 165/a dhe 340/4 të Kodit të Procedurës Penale

⁹³ Neni 14/a i Kodit të Procedurës Penale, Nenet 63 dhe 465/a të Kodit të Procedurës Civile

dhe ajo Administrative e Apelit,⁹⁴ një numër vendimesh i marrin në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, duke u bazuar vetëm në provat shkresore të paraqitura prej këtyre të fundit.

Si përfundim :

Për të siguruar që të pandehurit të kenë një gjykim të drejtë, ka disa kufizime për reporterët e gjykatave:

- Ju nuk duhet të diskutoni mbi sfondin e një çështjeje, ose të komentoni mbi një rast, ndërsa ai është në gjykim.
- Ju nuk mund të identifikoni fëmijët e përfshirë në rastet gjyqësore pa lejen e gjykatës.
- Ju nuk mund të jeni në gjendje të raportoni se çfarë ndodh në rastet e divorcit.
- Ju nuk mund të raportoni asnjë dëgjim që kryhet *in camera*.

Rregulli i përgjithshëm është që kur dikush shpallet fajtor, raportimi duhet të bazohet mbi krimin, jo vendimin; nëse dënimi është shumë i pazakontë, atëherë ky i fundit vihet në qendër të vëmendjes.

Mediat luajnë një rol të rëndësishëm dhe të mbrojtur nga kushtetuta, atë të informimit dhe edukimit të publikut. Mediat gjithashtu i shërbejnë një roli të respektuar nga koha si mbikëqyrës publikë mbi institucionet qeveritare, përfshirë këtu dhe gjykatat. Ky Udhëzues synon të ndihmojë gazetarët që mbulojnë gjykatat e Republikës së Shqipërisë, Institucionet e Vlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Institucionet e reja të krijuara nga Reforma në Drejtësi – proceset gjyqësore, njerëzit dhe standardet më të larta ndërkombëtare të marrëdhënies së medias me drejtësinë.

Udhëzuesi nuk përbën një dokument gjithëpërfshirës, të detyrueshëm dhe të dedikuar për aplikim në gjykata specifike, por përpiqet të ngriejë një panoramë të përgjithshme dhe të informojë profesionistët e medias mbi terminologjinë, bazat ligjore, praktike dhe zakone të marrëdhënies me institucionet gjyqësore dhe më gjerë. Gjykatat individuale kanë qasje të ndryshme në marrëdhëniet me mediat. Gazetarët duhet të njihen me zakonet, praktikatat dhe rregullat e gjykatave që mbulojnë.

⁹⁴ Neni 49, Ligji Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ndryshuar me ligjin nr. 100/2014) - Gjykimi në apel administrativ në dhomë këshillimi

ANEKS I

Instrumente të mëtejshëm për mbrojtjen e të drejtave të medias

- Recommendation No. R (96) 4 of the Committee of Ministers to member states on the protection of journalists in situations of conflict and tension
- Recommendation No. R (2000) 7 of the Committee of Ministers to member states on the right of journalists not to disclose their sources of information
- Recommendation CM/Rec(2011) 7 of the Committee of Ministers to member states on a new notion of media
- Recommendation 1215 (1993) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Ethics of journalism”
- Recommendation 1506 (2001) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Freedom of expression and information in the media in Europe”
- Recommendation 1702 (2005) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Freedom of the press and the working conditions of journalists in conflict zones”
- Recommendation 1706 (2005) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Media and terrorism”
- Recommendation 1783 (2007) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Threats to the lives and freedom of expression of journalists”
- Recommendation 1848 (2008) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Indicators for media in a democracy”
- Recommendation 1916 (2010) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Protection of “whistle-blowers”
- Recommendation 1950 (2011) of the Parliamentary Assembly of the CoE “The protection of journalists’ sources”
- Recommendation 2024 (2013) of the Parliamentary Assembly of the CoE “National security and access to information”

- Recommendation 2062 (2015) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Protection of the safety of journalists and of media freedom in Europe”
- Recommendation 2073 (2015) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Improving the protection of whistle-blowers”
- Recommendation 2075 (2015) of the Parliamentary Assembly of the CoE “Media responsibility and ethics in a changing media environment”

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).



Norwegian Embassy



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM